

**ADEM AVDIA**

# **USHTRIA**

**GJURMË**

**PËRJETIMESH**

**( Grimca jete )**

**Kukës 2020**

***Titulli i librit:***

***USHTRIA – Gjurme përjetimesh***

***Faqosja në kompjuter: Adem Avdia***  
***Redaktor gjuhësor: Besjona Dunga (Avdia)***  
***Kopertina: Besnik Hallaçi***

***Gjithë të drejtat i takojnë autorit***

***Formati : 148 x 210mm.***

***Katalogimi në botim – (CIP)***

***Shtypur në shtypshkronjën “Blendidixhital”***

***Këto shënime ia dedikoj :***

**ARLINDIT !**

Nipit  
që erdhi në jetë si frymëzim motivues i realizimit  
të kësaj dëshire të menduar ka kohë.  
Të njohë më mirë gjyshin dhe jetën e tij  
ushtarake.  
Të pyesë veten, vetëm veten:  
- A dëshiron të jetë një ushtarak i devotshëm?

Po ta mendosh mirë, në këtë botë ka dy lloj njerëzish.

Ka nga ata që flasin dhe ka nga ata që bëjnë.

Shumë njerëz vetëm flasin.

Ata dinë vetëm të flasin.

Por pasi kanë mbaruar fjalët, janë bërësit që e ndryshojnë botën.

Dhe kur ata e bëjnë këtë, na ndryshojnë. Prandaj ne nuk i

harrojmë kurrë.

Nga cili lloj je ti?

Vetëm flet?

Apo ngrihesh e bën diçka?

Sepse, më besoni mua, të gjitha të tjerat janë vetëm gjepura

kafeneje.

Ushtarakët janë ata që dine të bëjnë, janë bërës !

## **PARATHËNIE**

Ish- ushtaraku, shoku e kolegu ynë, Major(R) Adem Avdia vjen para lexuesve dhe dashamirësve të librit me botimin me skica e tregime “USHTRIA – Gjurmë përjetimesh”.

Ndryshe nga dy librat e parë, ai vjen para nesh me profesionalizmin e një ushtaraku me karrierë të kompletuar, duke sjellë ushtrinë dhe ushtarakun pas shumë vitesh midis nesh.

E kam lexuar me shumë vëmendje e kureshtje. Secili nga ne ka kujtimet e veta e kujtimet e një ushtaraku janë të bukura e të veçanta. Bukurinë ia shtojnë edhe vështirësitë e shërbimit.

Një shkrim i tillë, si në këtë libër, nuk është thjesht një çështje kurioziteti për ushtrinë tonë të dikurshme, por edhe një detyrim për t’i pasqyruar ato vlera, të cilat i gjejmë duke shfletuar faqet e këtij libri.

Ashtu si vuri në dispozicion të ushtrisë jetën, karrierën dhe njohuritë e tij ushtarake, në specialitetin e komunikimit, ashtu vuri para nesh një libër mbi jetën dhe karrierën e tij e të mbarë ushtarakëve me të cilët punoi, sakrifikoi dhe iu përkushtuan mbrojtjes së Atdheut tonë të shtrenjtë.

Në të vërtetë Ademi ka shërbyer në detyra të rëndësishme në shtabin e Divizionit, por pak është në libër ai dhe veprimtaria e shtabit. Më ne dukje del oficeri i trupës, nënoficeri dhe ushtari në gjithë veprimtarinë e aktivitetin e përditshëm. Këtu takojmë ushtarin dhe oficerin në stërvitje, në shërbim dhe në kohën e lirë. E gjejmë të përkushtuar në postin luftarak, por edhe të vetmuar në majën e malit.

Atë oficer që sakrifikoi vitet më të bukura të jetës për çështjen për të cilën ishte betuar.

Kur lexojmë librin të gjithëve na kujtohet vetja jonë si ushtarakë. Marrëdhëniet e mira dhe vëllazërore me njëri-tjetrin dhe solidariteti i singertë. Na kalojnë parasysh ditët e stërvitjes me ushtarin, fushimet e panumërta dhe ato kohë që kemi kaluar bashkë, megjithëse larg familjes, por brenda “familjes” sonë të madhe të shumëpërkushtuar, ushtrisë.

Në faqet e librit shfaqet edhe viti i mbrapshtë '97, viti me të vërtetë si thuhet në libër, u “përfshimë në marrëzi”. Këtu nuk ka fajtor e të ndershëm, por ka situatë kaotike, në të cilën u gjendën oficerët, situatë amullie ku më e vështirë ndër të gjitha ishte rrugëdalja nga kaosi. Këtu gjejmë brengën e fajësisë së të pafajshmit.

Ka dhe një dritare ku mund të hedhim një vështrim, “Luftën e Kosovës”. Kontributin që kanë dhënë ushtarakët tanë gjatë dhe pas lufte, për sakrificat që i kanë shoqëruar dhe solidaritetin vëllazëror me oficerët, kolegët shqiptarë të Kosovës, për të ngritur Ushtrinë e Republikës së Kosovës.

Libri mbyllet me humor, me të qeshur, ashtu si kemi kaluar mes gëzimit dhe harmonisë në ushtarakët, në shokët që nuk e harrojmë kurrë njëri-tjetrin, në që edhe sot gëzojmë e qeshim, qeshim e gëzojmë kështu si jemi dhe me këto që kemi.

Urime shokut tonë Ademit! Ta kemi midis nesh, ushtarakëve, kurdoherë me shkrime e kujtime të tilla.

Nënkolonel(R)  
Shyqyri Shabani

## **PËRFSHIRJA NË MARRËZI**

Një rreze drite u fut nga hapësira midis dy perdeve të rënda ngjyrë bezhë. Mbrëmë erdha dhe u shtriva shumë vonë. Më dukej se mbi mua kishin rënë të gjitha hallet e repartit, kur ndoshta në atë moment reparti nuk dinte isha apo nuk ekzistoj fare. Një tollovi e paparë, ku unë nuk po kuptoja asgjë. Mendohesha e mendohesha dhe prapë asgjë. Ishte ndër herët që nuk mbaja krah. Jo se nuk doja, por nuk dija. Vëreja se ishte një situatë “Larg b\*thes sime”, por unë përsëri “atë” timen e afroja afër zjarrit. Akoma edhe sot nuk e shpjegoj. Nuk e kuptoja, apo ashtu mendoja.

12 mars 1997. Ngrihem e dal në ballkon. Mbi Gjallicë një re e madhe, e murrme, pengonte të dukej diellin që po lindte. Një pranverë e vogël po agonte e mundohej të kapej me dimrin që po dorëzohej.

Nga Parku i Ri krisma armësh. “Vullnetarët” ishin kthyer mbrëmë vonë nga Jugu. Këta ishin forcë e armatosur pa emër. Ngjanin me haxhiqamillistë dhe nuk kishin të bënin me strukturat tona. Divizioni në mes meje dhe krismave. Budallallëku më thoshte se unë duhej të isha atje dhe kështu ...

Kapërceva pragun e Grupit të Drejtimit në Divizion. Dëgjoj brenda të qeshura. Gjithçka që ndodhte, më ishte fiksuar e më dukej se shkonte vetëm mbrapsht. Në Imaj të Tropojës disa dhjetëra njerëz kishin sulmuar dhe marrë materialet në depot e rezervave. Ishte njoftuar komandanti dhe pyetja e komandantit se kush po i mbronte depot kishte marrë përgjigje nga Grupi i Drejtimit:

- I gjithë populli, zoti Komandant!

Alegori e paparë. Populli i sulmonte e populli po i mbronte..., pastaj e qeshura, shkak i kësaj përgjigje të nxituar, por të rrënjosur si dogmë e si ideologji. Gjithë populli mbron. Po pastaj kush e kishte rradhën që ta mbronte populli?! Ata, ne, por kur?

Gjithë paraditja me raportime. Atje sulmuan turmat, diku u hapën, shpërtheu... Shifra, emra, vende, armë, depo, municion, makina, njerëz, popull e çdo gjë, vetëm ushtarakë jo, nuk përmendej askund dhe nga askush. Nuk kishte, apo nuk ishin. Jo ne ishim por nuk duhet të ndiheshim. Në buzët e të mëdhenjve dhe veshët e të vegjëlve, si psalmë kishtare pëshpëritej ... “asgjë të mos ndodhë me popullin, asnjë të mos gërvishtet”. Por turmat e dalldisura, të dala nga populli, nuk po “mbronin depot”, ato po i vidhnin, po i dhunonin, po i boshatisnin, po i batërdisnin dhe ne po na përdhosnin. Kush ne? Ishim apo nuk ishim?!

Pasditja filloi ndryshe. Rrethi po ngushtohej. Edhe të njohurit tanë u zgjuan. Turma, si në amfiteatër, filloi të dalë mbi kodrat e qytetit dhe po ngushtonte nga lart poshtë rrethimin tonë. Akoma ishim vetëm ne, por si duket shpejt do bëheshim me shokë. Unaza ngushtohej dhe gjendem në postbllok në kontakt direkt me njerëzit ... Me cilët njerëz? Me njerëzit që i njihja, me ata që takohesha e përshëndeteshja çdo ditë. Megjithatë tani ishin ndryshe. Edhe unë u dukesha ndryshe. Kishin bërë gati thumbin për sulm. “Nuk ka armë këtu, vetëm dokumente”. “Po atje poshtë në Lug?”. “Ka patur, por ... “. Nuk kishte kohë kush të më dëgjonte. Ishin mprehur për aksion. Kishin bërë



vaksinën e ajo tanimë kishte bërë efektin, efektin domino që kishte përfshirë gjithë Shqipërinë. Instikti. Verbërisht ndjekin instiktin e zhatjes, rrëmbimit e të përfitimit.

Nata sterrë. Vidh e merr, thyej e gjuaj, derdh e mblidh, ruaju e sulmo, mbro e mos lufto e popullin mos e ngacmo. “Kujdes asnjë nga populli të mos gërvishtet”. Kjo ishte deviza. “Po ne?” “Kush ju? Ushtarakët! Ju nuk jeni as numra. Jeni hije, jeni askushi”.

13 mars. Mëngjes i kthjellët. Mendja e turbulluar. Qetësi. Ariu turmë kishte zhgërryer gjithë natën dhe tani flinte. Ne ishim ruajtur nga plumbat rikoshetë e tani vëzhgonim, shikonim me bisht të syrit njëri tjetrin e nuk flisnim. Për çfarë të flisnim! Nuk ishim të gjithë. Dikush mungonte. Dikush ishte bashkuar me ata. Dikujt nuk i dihej fati. Shtabi nuk ishte cënuar. Veçse disa xhama të thyer nga plumbat kuturu të natës. Oficerët filluan të vinin, por edhe të iknin. “Mora flamurin e po iki.., mora evidencat e po iki.., mora dokumentat e po iki .., mora .., mora ..., deri sa rrënja “ik” filloi të zgjedhohej e amplifikohej me të madhe pa foljen “mora” pas thirrjes “erdhi serbi...”. Pas këtij momenti kobndjellës nuk dëgjoje tjetër vetëm: “ik, ika, ikje, ku ike, pse s’ike, nga do ikësh, me kë do ikësh, mos ik pa mua, ik... ik... ik...”. Në zoom-in e trurit afroheshin e largoheshin fjalët e parullat e mëdha në mure: “Atdhe, Mbrojtje, Sovranitet, Gatishmëri, Detyrë mbi Detyrat, Sakrificë, Nder, Lavdi, Ushtri, Gjak, Betim ...” e këto silleshin e silleshin, e bashkë me mua u përplasën në stolin më të afërt. Isha i mpirë. Më shumë në tru se në gjymtyrë.

Kisha vite që kisha harruar “udhëheqësin”, kisha vite që nuk isha kujtuar për “atë” dhe ja tani, ndërsa kisha mbajtur një personel në central që të komunikonte me ata që kishin mbetur në ndonjë repart e me ata që ishin në korridoret e Ministrisë së Mbrojtjes, m’u kujtua kur në Rregulloren e Ndërlidhjes shkruhej: “Reparti mund të ketë informata boll, por kur ndërlidhja nuk punon, asgjë nuk vlen”. Enver. Tanimë kështu po më ngjante. Duhej të kisha një personel në central, duhej të ishte dikush të merrte e të jepte të dhëna, të tregonte se jemi akoma, se jemi kështu si jemi, të nderuar apo të .... menderosur, por ama jemi e kemi kurajë të tregojmë se jemi.

Marrëzia kaloi e bashkë me atë kaluan dhe vitet. Por nuk kaloi dhe nuk do të kalojnë njolla që mori dinjiteti ynë, nderi dhe përkushtimi ynë. Njollën që e lan vetëm ndëshkimi. Ndëshkimi nga lart poshtë, pa parë emra e poste.

Unë sot shkruaj, jetoj e gjalloj, por në të vërtetë belbëzoj. Belbëzoj se nuk mund të flas. Jo sot, por në jetë të jetëve. Nuk di si mund të flas për ato ditë, ditët kur na përfshiu marrëzia.

## **“URIM” PËR ENVERIN**

Ishin shokët tanë, por tanimë ishin ndryshe. Ndryshuan ditën që nënshkruan petitionin. Nuk ishin si ne dhe me ne në rresht, në lokal, në stërvitje e kudo. Pak veta u afroreshin, sikur donin të tregonin se unë nuk jam si ata, jam i juaji dhe nuk kam asnjë kërkesë. Unë zbatoj vetëm urdhërat dhe udhëzimet tuaja. Edhe kafen kur e rrufitnin na dukeshin ndryshe. Dukej se ishin “matrikulluar” me të keqen. Disa i quanin mendjelehtë, të papjekur, të papërbajtur, të nxituar dhe të papërshtatshëm me rregullat e pavendosura ushtarakisht e publikisht.

Në fillim peticioni kishte disa pika me karakter ekonomik, pastaj duke “qëndruar në zjarr” u trash dhe u shtuan edhe disa pika të tjera me karakter politik. Kërkuiesit ishin po ata, shokët tanë, shokë që i quanim “oficerët e petitionit”, ose më mirë oficerët e “Shtëpisë së Oficerëve”, pasi pjesa më e madhe e tyre strehoheshin në Shtëpinë e Oficerëve.

Rasti e karriera ime e solli që të mos isha në parti e kështu jeta dhe karriera ushtarake nuk ishin aq të lidhura me atë. Në familjen time nuk kishte asnjë anëtar partie, por kjo nuk më pati penguar që në orët e edukimit me ushtarët, partisë t’i jepja rolin drejtues dhe udhëheqës. Shumë nga ato që u thosha ushtarëve ishin të ngulitura thellë e bindshëm në ndërgjegjen time. Kjo ishte arsyeja që edhe unë fillimisht nuk i kuptoja dhe nuk isha në krahun e kolegëve të mi “petitionistë”.

Orteku i demokracisë tanimë ishte shkëputur dhe po merrte gjithçka me vete. Kush nuk e shikonte nuk kishte as vesh, as sy, ose më mirë të themi i kishte mbyllur vetë ose e kishin indoktrinuar aq shumë sa ishte shurdhuar e verbëruar. Orteku politik nuk ndante kush kishte apo nuk kishte poste apo mustaqe.

Shoqërohesha në të shumtën e kohës me oficerë më të rinj se unë. Kjo ishte ndoshta edhe dëshira ime. I urreja vitet që kalonin dhe më dukej se duke ndenjtur me ata edhe unë mbeteshja i ri. Mbetesha si Goni dhe Adi.

Goni merrej me edukim e politikë, se e tillë ishte detyra. Puna e tij e edukimit lidhej domosdoshmërisht me komisararin dhe organizatën e partisë. Ai dukshëm nuk e përkrahte vijën politike të partisë dhe kishte dëshirë të ishte “petitionist”, por si t’i dilte para komisararit, si mund të rrinte akoma në atë detyrë! Detyrën e donte, e rrjedhimisht duhej të donte edhe komisararin, të cilin duhej ta përkrahte së bashku me vijën politike të Partisë, që kishte mision ta shpërndante komisarari. Kishte para malin që e pengonte të shihte diellin. Gjithsesi ai vazhdonte të ngjitej, të ngjitej në shtegun me dredha për të parë diellin.

Adi ishte tjetër. Edhe ai ishte jabanxhi si Goni, por puna e tij nuk kishte fije ku mund të lidhej politika. Ai ishte teknicien nga detyra e qenien petitionist dhe nuk muntohej ta fshihte. Dukej në pamje të parë si fluturak, por ecte me këmbët në tokë e të gjithë bënin bé për kokën e tij.

Kishte rreth tri ditë që nuk binte dëborë e dëborë e kaluar kishte mbetur në tokë vende vende pa shkrirë, si shpina dhisë së zgjebosur. Liqeni kishte ngrirë në dy metrat

e para e shishet plastike të ngulura mbi akull reflektonin nuancat e dobëta të diellit idhnak. Ishte 20 shkurti i parë i pas rrëzimit të bustit të diktatorit e askujt nuk po i binte ndërmend. “Sa për borën e parvjetme” – tha Ganiu me zë të ulët, kur u shpërndamë nga rreshtimi i mëngjesit.

Duke soditur dallgëzimin e ngurtësuar të liqenit, këmbët na dërguan drejt lokalit, te riti i përditshëm, kafeja e mëngjesit, që ishte kthyer si opium rutinë pas marrjes së informacionit dhe dhënien e detyrave paraprake vartësve. Me Gonin dhe Adin porositem edhe nga një konjak, për t’i dhënë një avull trupit në atë acar të vogël shkurti. Po pinte “macja uthull”.

Ishim ulur afër dritares, që e kishin lënë pak të hapur. Nga jashtë futej një puhizë e hollë, por e acartë, që të përskuqte pak lëkurën e fytyrës e nga brenda dilte si një re tymi e cigareve, që gjarpëronte gjithë lokalin e në fund kishte gjetur këtë të çarë për të dalë, mes kanatave pranë nesh.

Pasi rrufita dy - tri herë kafen turke dhe shija e alkoolit të konjakut nuk më krijonte rrudha në fytyrë, ngrita gotën:

- I paharruar 20 shkurti si dhe vepra e pavdekshme e shokut Enver!

Mbusha gojën me një gllënkë konjak dhe me ngadalësi e rrëshqita poshtë në gurmaz, sikur ula një kovë në fund të pusit. Lashë gotën në tavolinë dhe tërhoqa dorën tek filxhani i kafesë, thua po ma merrte njeri.

Fluturimthi dora e Adit mbërtheu gotën time e po aq fluturimthi gota përfundoi tek cepi i murit. Copat e saj u

përziejnë me mbeturinat e bishtat e cigareve, kurse konjaku u tret me ujin e borës së shkrirë në pllakat e dyshemesë... Në moment dora ime u largua nga filxhani kafesë, mori si vetëtimë gotën e përgjysmuar të Adit, e shkëputi në ajër, e duke u përzier me shtëllungën e tymit të duhanit, e kaloi nëpër hapësirën e ngushtë të dritares duke e përplasur jashtë në gurin gungaç, me cipë të hollë akulli sipër.

Befas vështrimet u kryqëzuan dhe fytyrat u ngurtësuan, a thua se po shiheshim për herë të parë. Dalëngadalë gjaku në fytyrë filloi të shpërndahej e lëkura filloi të shkrij “seriozin”. Nga gurmazi zëri po dilte hopa hopa deri sa u kthye në një të qeshur, e kur e qeshura mbuloi lokalën, bufetieri ndërhyri me qetësi. Vendosi dy gota plot me konjak në tavolinë dhe e bashkoi të qeshurën me ne.

Qeshëm si shokë të mirë. Në të vërtetë nuk po festonim, por padashje, duke nënqeshur, po kujtonim komandantin diktator, atë që ishte bërë pjesë e jetës sonë, atë që e kujtonim si burim i të gjitha të mirave, begative e lumturive tona, atë që edhe në familje kishte zënë vendin më të dukshëm me foton e tij. Nuk po kuptonim. Po qeshnim apo po përqeshnim ...

## **I LIRË SI DEMI**

Shqipëria i ngjante demit. Atij demi që pas shumë vitesh i lidhur i ishte zgjidhur litari në njërin bri. Ulte kokën dhe rrotullohej, rrotullohej dhe nuk merrte parasysh çfarë bënte, vetëm të lirohej, të lirohej e të ikte, larg, larg dhe i lirë, pa litar në qafë. Hidhte shqelma me këmbët e prapme e këmbët e para i hapte sa majtas e djathtas, vetëm të mbetej në këmbë. Tundte kokën e ulte brinjët përtokë duke ngritur pluhur, duke e bërë tokën vija vija, sikur të ishte duke shkruar testamentin e largimit nga ky vend i nëmur.

Pak ditë kishin kaluar nga 2 korriku, dita kur u hapën dyert e ambasadave. Adi, një ndër shefat e rinj të repartit, më dukej si demi gjysmë i zgjidhur. Ai, se e kisha me zyrë ngjitur, sillej vërdallë dhe dukej që edhe punët në repart i bënte me ngut, i bënte sikur nuk kishte kohë pastaj, jo më të nesërmen apo të pasnesërmen që do vinte. Në zyrë nuk qëndronte shumë. Sa hynte, dilte. Edhe kafën e pinte gjysmë i ulur, gjithmonë sikur e priste dikush prapa derës.

Si Adi më ngjanin se silleshin edhe disa nga oficerët beqarë të “Shtëpisë së Oficerëve”, dy apo tre shokë të tij. Vinin bashkë në punë, shpërndaheshin në detyra dhe pastaj si me komandë shkonin në lokal dhe flisnin me zë të ulët dhe u druheshin se edhe era mund të shpërndante fjalët e tyre. Ata ishin të gjithë të rinj dhe të gjithë kishin plane dhe ëndrra për të realizuar.

Ajo ditë ishte si gjithë ditët e tjera. Kisha hapur dosjet për të ndjekur planizimin mujor e për ta detajuar atë në ditë. Ishte fillimi i pranverës dhe punët vinin duke u

ngjeshur. Ishte periudha kur stërvitjet i ktheheshin terrenit dhe forcat rezerviste fillonin stërvitjen në reparte. Në derë ia behu Adi. Unë i afroja oficerët e rinj dhe kisha fituar besimin e tyre. Ata qëndronin me mua veçanërisht në kohën e shërbimit 24 orësh apo në kohën e lirë që na krijohej gjatë ditës. Edhe unë kisha dëshirë dhe qëndroja me ata. Më dukej vetja si i privilegjuar.

- Kisha një muhabet, – filloi menjëherë Adi.

- Mirë, mbylle derën dhe ulu, – i përgjigjem duke mbyllur dosjen, për t'i lënë të kuptonte se tani jam vetëm me atë dhe për atë.

- Kam vendosur të largohem, por nuk di sa do t'ia arrij qëllimit. Nëse nuk arrij të largohem më duhet të vij përsëri në punë, prandaj erdha të të tregoj. Kam për të lënë edhe disa porosi.

- Ku i ke porositë?

- Në zyrë. Eja, po deshe.

Ai doli i pari e unë mbylla zyrën e ndoqa nga pas.

Shikoja shpatullat e tij të bëshme prej djali të ri dhe mendoja a do ta shihja më. Ishte ndër djemtë më të mirë në shtab, ndër më të shkathët dhe pa asnjë djallëzi në shpirtin e tij. Më vinte keq që një djalë aq energjik të vegjetonte në radhët ku kishte filluar të katandisej ushtria. U fut në zyrë e unë pas tij afrova derën.

Hapi kasafortën me kujdes si të kishte thesaret e botës dhe pasi e zbrazti filloi t'i fuste një nga një duke m'i shpjeguar:

- Këto janë tri blloqe të sekretuara. Kur të marrësh



njoftim që arrita m’i dorëzo në sekretari. Kjo është pistoleta dhe fishekët. Pistoletën mbaje, kurse fishekët le të rrinë se nuk është problem edhe po humbën. Edhe këtë dorëzoje kur të jetë koha. Ky zarf është me lek. Janë kursimet e mia. Do ta postosh në adresën e shënuar.

E zgjati zarfin drejt meje duke iu dridhur zëri e dora. Dukej se po dorëzonte testamentin. Në fakt po dorëzonte amanetin e lamtumirës në familje, në familjen që nuk arrinte t’i thoshte as lamtumirë, familjes që kishte muaj pa e parë. Mora zarfin e me një shikim të shpejtë arrita të kap fjalët “Thanas ... 1 Maji ... Fier”. E futa me të shpejtë në xhep dhe pasi sigurova dhe pistoletën në brez, dolëm të dy nga zyra e tij.

Pasdite vonë. Fëmijët po bënë detyrat e shtëpisë e unë po pija një kafe në ballkon. Shikoja malin e Gjallicës dhe kundroja gjelbërimin që kishte filluar të lindte pas shuarjes së oxhakut të uzinës së bakrit. E doja shumë gjelbërimin dhe më gufonte në zemër sa herë që shihja se diçka po rritej a zhvillohej. Më dukej se rritesha dhe unë bashkë me atë. Ndërkohë më thërrasin:

- Të kërkon një shok te dera!
- Hajdeni brenda, – them me të parën. Ishte Adi me një shok nga jeta civile, Sokolin. Sokolin e njihja se e kisha pasur ushtar dhe më respektonte. Ishte për mua djalë i mirë, por nuk e dija që shoqërohej me Adin.
- Jo kisha një llaf, – tha me ngut Adi, – më duhet pistoleta, prandaj erdha ta marr.
- Jo, nuk mundem, – thashë me të prerë, – ti nuk po

shkon për luftë. Ajo ka vetëm të këqija. Sa ka grykën, ka hajrin. Nuk mund të të përcjell me dreqin në gji. Të lutem largohu!

- Ma jep se është e imja – këmbënguli ai.

- Të lutem largohu, të qoftë rruga e mbarë! Jam në familje dhe nuk kam asnjë fjalë tjetër.

U largua mëdyshas e kokë ulur dhe u bashkua me Sokolin, që po e priste një kat më poshtë.

Sapo dolëm nga mbledhja. Ishim të bezdisur nga koha sa zgjati ajo, por Adi ishte më i lehtësuar nga ne. Ishte ndarë vetëm me një vërejtje për largim nga puna 7 ditë. Ai u justifikua mirë dhe shokët e mbrojtën para komandantit. Në fakt asnjëri nuk e dinte kalvarin e tij dhe dështimin e planit. Po të mos dështonte ai nuk do të kishim pasur rast as të mblidhemi e as të diskutojmë për atë.

Kanë kaluar mbi 25 vjet. I shkruajmë njëri-tjetrit në rrjete sociale. E ndjek Adin familjar, Adin po aq vital e të shkathët. E ndjek dhe e ndjej se ai ka gjetur veten atje ku shkoi, atje ku dëshiroi dhe atje ku ëndërroi një jetë të tërë. Ai ishte si ai demi që këputi litarët dhe iku, iku për të qenë i lirë, se kishte lindur i tillë, për të jetuar vetëm i lirë, në një vend të lirë e pa litar në qafë.

## LETA

Supa ishte shumë e ngrohtë dhe nga refleksi e largoi menjëherë lugën nga goja, por edhe këtë radhë nuk shpëtoi. Dy pika lëng i ranë mbi pantallonat ushtarake duke u përhapur si në letërthithëse, mbi ato që dje ia kishte hekurosur dada.

E pa ushtarin kur nga kazani i stërmadh 100 rd, që valonte mbi sobën prej llamarine si llavë vullkani, mbushi një garuzhde plot, një gjysmë dhe pastaj mori nga sipër pak yndyrë e salcë, derisa e plotësoi dhe e zbukuroi pjatën, që atij si komandant t'i dukej më e mirë.

Mendjen nuk e kishte aty, e kishte akoma jashtë, kur postieri më tubën e gazetave në dorë i zgjati letrën e ai arriti të lexojë vetëm dërguesin. Leta. Po, po, ajo ishte dhe postieri nuk shikonte dorën e tij, por sytë. Shikonte dhe ngopej me dridhjen e qepallave të kafta dhe shquante një buzëqeshje të përzier me fundin e ankthit të pritjes së asaj letre. Kishte tri ditë që ishte i interesuar.

Këmbët e dërguan te dhoma e oficerëve beqarë, ku dera ishte gjysmë e hapur. Duhet të kishte qenë Gjergji më përpara. Me siguri ka marrë diçka dhe ka vazhduar stërvitjen. Dukej, pasi krevati i tij ishte gropëzuar e disa letra kishin mbetur të shpërndara si gjethet e vjeshtës nën kumbullën e kapanonit.

Përpiu me sy dhomën e thjeshtë, ku dinte edhe të çarat e pllakave. Dy krevate me sustë hekuri me nga një komo te koka, një tavolinë prej dërrase ku kishte qenë vizatuar një kuti shahu e për ta mbajtur më të pastër ishte

mbuluar me një xham pesësh, nën të cilin ishin renditur foto me ngjyra nga revistat ushtarake. Në cep ndodhej rafti stërmadh që për vite e vite kishte përpirë e përcjellë valixhe beqarësh.

Largoj me dorë mbi tavolinë rregulloret. I dukej sikur ato po i bëheshin pjesë e letrës dhe me gishtat e hollë, fare pa kallo, grisi anën e ngushtë të zarfit. Duke tërhequr letrën nga vetja, për ta shkëputur nga zarfi, iu duk se po nxirrte imazhin e saj dhe do ta ulte në stolin e drunjtë afër vetes. Fryma filloi t'i shpeshtohej e mendja i iku te ndarja me Letën. Te ajo fjala e nënës së saj, se “oficerët janë më rraqe ngarkuar”. Ajo drejt e kishte. Kur i përcolli fjalët e nënës së saj, ai filloi t'i këndoj me zë të ulët “Këngën e Montatorit” sipas versionit të tij “... klasën e parë në Kukës fillova, klasën e dytë..”. Prapë kjo e ngushëllonte, se tani ai nuk kishte “rraqe” fare dhe as fëmijë për në shkollë. Edhe kjo karriga e shtrembër ku ishte ulur ishte e ushtrisë.

Sa herë që kujtonte Letën i vinte inat që mendja nuk i ndahej nga Blerina, infermierja që kalonte rrugës para repartit për në lagjen e fshatit sipër. Ajo kishte qenë e para që i kishte futur mornicat, por nuk arriti ta fitonte. Mundohej ta harronte, por e kishte shumë vështirë. Diku kishte lexuar se dashuria është si gjethet e dushkut. Nuk bien të vjetrat pa dalë gjethet e reja. Unë, - mendoj me vete - duhet të jem në fazën e ndërrimit të gjetheve.

Shikimi përpiu së pari fundin e letrës. “Të përqafoj, e juaja Leta”. Po, po, të përqafoj ... Tani po ma thua! Ku ishe atë ditë? Unë të vështrova, ti i ngule sytë tek unë dhe me gishtat e tua rrëmoje në pëllëmbën time. Deshe të flisje, të

thoje diçka e unë prisja, si priten rrezet e diellit në agimin e acartë nga prapa malit. Një ngjyrë e purpurt të mbuloi mollëzat, faqet dhe mjekrën tënde të gropëzuar. Reja bardhoshe u largua e zbuloi rrezet e diellit. Dielli doli e shpirti i fukarasë u ngroh. U ngroh por ngrohtësia nuk i largoi të dridhurat, nuk i largoi ethet e shpirtit të etur. Po. Po. Dielli doli nga prapa resë. “Të përqafoj...” në letër.

Trokiti dera, ose më shumë ngjau me përplasjet e putrave të maces, kur i kacavirret dorezës së derës. Ushtari, se vetëm ai i bie i ndrojtur, vetëm ai mund të “guxojë”...

- Shefi, në zyrë, zoti komandant, – belbëzoi e dora i mbeti gjysmë e mbledhur lart, si nderim i mbetur pezull.

- Mirë! – u përgjigj pa e parë fare në sy.

Hapat e ushtarit po shuheshin. Letrën e palexuar e futi poshtë jastëkut e duke pëshpëritur “Shefi ... shefi”, veshi këmishën e nguli sytë mbi këpucët e lyera që shkëlqenin. Kopsiti të gjithë uniformën e shpejtoi hapat poshtë në drejtim të ndërtesës së shtabit.

## **SHEFI I ZBULIMIT**

Ora dhe pak do të tregonte mesnatën. Sapo përcolla Basriun, shokun e zyrës, dhe mendja më rrinte tek radiostacioni që patëm në dorë. Atë e kishin sjellë nga Franca. As unë dhe as ai nuk dinim frëngjisht, por të gjithë radiot kanë një parim pune, të gjitha kryenin një funksion. Edhe kjo që solli Betimi, përfaqësuesi UÇK-së në Divizion, e tillë ishte. I përpiluaam instruksionin e përdorimit në shqip, e paketuam, e mbajti Basriu si më i fortë dhe tanimë është gati për front. Gati për betejën e saj të parë.

Sytë ishin fiksuar te uji i fundit që rridhte në shatërvanin para sheshit. Ishte ora që ujësjellësi ndalonte rrjetin. Currila e ujit mbi shatërvan përzihej me ulërimat e avionëve. Veshët sikur ishin ambientuar me zhurmën e avionëve të NATO-s që shponin qiellin. Mbinin nga prapa Gjalllicës e humbnin mbi Pashtrik. Varavingat e tyre natën ngjanin me xixëllonjat e stërmëdha. Këto fluturime ishin kthyer në monotone për veshët tanë, si zhurmat e makinave në rrugën sipër repartit. Kjo po ndodhte prej javësh e ne ishim ambientuar sa nuk e mendonim më as nga vinin e as dhe ku po shkonin. Dinim fillimin, por tanimë duket se po ndienim edhe fundin e fluturimit të tyre. Lufta kishte marrë për mbarë. Atë natë isha oficer i gatshëm.

- Ngrihu shef, të lutem! Merr armatimin dhe në shesh ju kërkon gjenerali! – përcolli mesazhin korrieri e iku.

Nuk ishte momenti për sqarim. Një hop dhe u gjenda në zyrë. Mora automatikun, municionin, çantën e shpinës dhe pajimet e nga larg shquaj gjeneralin me shefin operativ

dhe dy ushtarak të tjerë pranë Chevroletit me dyer të hapura, a thua kërkonte të na kapërdinte me gjithë pajime.

- Ushtarët serb kanë marrë doganën e Morinit dhe kanë sulmuar me artileri lagjen Rexhaj. Banorët e Morinit po vijnë me makina e mjete rasti në qytetin e Kukësit. Nisuni dhe takohemi në vijën e parë – ishte sqarimi paraprak dhe urdhri i gjeneralit.

U futëm dy të parët në zgafellën e prapme e të errët të makinës. I treti desh të futej Ahmeti, por gjenerali e ndali. Fakt ishte se e kishte nga ana e tij.

- Ahmet, qëndro të ikim bashkë pastaj! – i nxori dorën para gjeneralit.

Shefi operativ e tërhoqi me forcë Ahmetin brenda e foli nën zë:

- Po “ikëm” ne dhe ky bashkë me ne.

U ngushtuam pak për të bërë vend e së bashku me shefin e zbulimit makina u shkëput duke ulëritur si kali i pazbutur, me të katër gomat aktive.

Rrugën e njihnim të gjithë e vazhdonim të zhytëshim në errësirën e mesnatës si në galerinë e braktisur të minierës aty afër. Asnjë lëvizje, asnjë zhurmë e asnjë shenjë luftimi. Edhe frymë merrnim pa zhurmë. Ne udhëtonim duke ndriçuar rrugën e zbuluar veten. Po ata që mund të ishin përballë nesh!? E kuptonim se po shkonim drejt një harakiri. Ne ishim oficerë të shtabit të Divizionit e para nesh duhet të kishte ushtarë, skuadra, toga, kompani, batalione, brigada, e ne të vendosur në drejtim në vendkomandë. Zbatimi planit i operacional në atë moment na dukej luks.

Ishim katandisur si “kokoshi një thel”. Kishim përmbysur gjithçka të shkruar e të planizuar.

Para peshores së Morinës na e penguan rrugën disa fshatarë të armatosur me armë automatike, çifte gjahu, sëpata, hunj, etj. Na shpjeguan se ushtarët serb kishin qëlluar, ndoshta kuturu, mbi lagjen Rexhaj dhe ishte përhapur panik në fshat. Në këto fjalë arriti gjenerali dhe ne u parkuam anës rrugës për të ndjekur situatën që ndoshta mund të ndryshonte.

Shefi i zbulimit zbriti me ngadalë nga makina dhe i bërë njësh me errësirën, u zhduk në brendësi të saj. Dallova pak siluetën e tij dhe kur ajo u tret në mjegullnajën e zezë, u bashkova me shokët tek grupi i fshatarëve të stresuar.

Ora shënonte 05.00 e mëngjesit dhe koka më ishte rënduar. Në faqe ishin vijëzuar shenjat e pëllëmbës ku isha mbështetur. Ajri brenda makinës ishte rënduar sa në grykë duhej vendosur një filtër kundërgazi. Stomaku më dukej se do dilte nga poshtë lart. Hapa ngadalë derën e makinës e këmbët prekën tokën. E mbylla po ngadalë, pa e përplasur, dhe zura pak vend mbi një trung të shtrembër. Kur po mbushesha me fryme dalloj një njeri që afrohej duke u ngjitur lart. Sa më shumë afrohej, aq më mirë shquhej qenja e tij ushtarak. Ishte shefi i zbulimit. Pasi nxori frymën, sikur donte të nxirrte dufin e natës së zezë, u ul pranë meje.

- Ku ishe deri tani? – e pyeta me ton të ulët, me pak zë, ndrojtje, me zor dhe me një ndjenjë faji të përzier me justifikimin sepse nuk isha dhe unë atje me atë, por edhe me merakun e hequr që tani ai ishte mes nesh.

- Shkova menjëherë tek dogana. Ajo ishte bosh, fare



pa njeri. Takova komandantin e saj dhe pasi mobilizua policët që ishin strukur në përrua i vendosëm në formacion luftimi në katin e dytë të doganës. Pastaj u hodha në breg të liqenit. Mora varkën e pasi ndoqa matanë vijën e klonit takova ushtarët zbulues të Pogajve. U sigurova për situatën dhe gatishmërinë e tyre e tani jemi bashkë këtu. Kemi ndonjë të re këndej.

- Jo, nuk kemi asgjë, – pëshpërita unë, – po ti pusho pak, - dhe e ndihmova të hiqte dhe të shtronte xhupin në barin e shkurtër të përzier me guralecët e rrugës.

E vështroja atë teksa pushonte dhe më vinte turp të vështroja veten dhe shokët që lëshonin gazra në makinë. Ai po. Ai ishte në mision dhe e kreu me sukses atë. Ai ishte atje, atë natë të trishtuar për veten dhe ne të gjithë. Ai meritoi titullin ushtarak dhe e justifikoi atë ndoshta vetëm me atë natë, vetëm me çfarë arriti të bënte. Ai edhe mund të mos kthehej, por iku para, iku atje ku i rrinte mendja se duhej të ishte, iku atje ku nuk ikëm ne të tjerët.

Kosova u çlirua. Ne fituam, por “fituam në paqe”. Fitoi dhe shefi i zbulimit, por ai “fitoi në luftë”.

Kishte gjithë javën që në korridorin e Divizionit viheshin re lëvizje më të shumta nga persona të jashtëm dhe zyra e komandantit ishte më pak e vizitueshme nga ne, oficerët e shtabit. Me ne kishte filluar të angazhohej shefi i shtabit. Rojet ishin bërë më pak vigjilentë, pasi edhe kufizimet e kontrollet ishin zbehur dhe disa persona nuk i kontrollonin, apo bënë sikur. Porosia ishte marrë. Persona me, pa dhe me gjysmë uniforme të zinte syri më shpesh. Nuk i njihnim, por i përshëndesnim ku me kokë e ku me dorë, vinim buzën në gaz e vazhdonim. Pak nga ne i lidhte puna dhe i takonim. Pak nga ne kishin të bënë me ata. Dinim që ishin ushtarë apo oficerë të UÇK-së, formacion luftarak me efektivë nga Kosova dhe asgjë më tepër.

Një ditë po instalonin një antenë satelitore për komunikime telefonike. Unë isha shefi i komunikimit, por nuk isha pjesë e këtij procesi komunikimi. Më bie ndërmend një histori që e tregonte babai im. Në Bicaj po organizohej “Mbledhja e Dheut”. Ajo po bëhej tek shtëpia e Fetahut. Gjatë drekës pjesëmarrësit e thërrasin dhe Fetahun për bukë, që ta respektonin pasi ishin në shtëpi të tij dhe ai ishte më i moshuari. Ndërkohë vazhdojnë me bisedat e lëna gjysmë. Në bisedë ndërhyjnë pa rradhë e leje edhe Fetahu. Njëri ndër kryesorët i drejtohet:

- Ha pite o daja Fetah e mos u përziej në punët e Dheut.

Ora 10 paradite. Centralisti më njofton se gjenerali të kërkon në zyrë. Mora bllokun dhe pasi trokita, u gjenda në zyrën e tij. Përshëndeta dhe më prezantoi me dy persona

civilë që kuptoheshin që ishin drejtues të UÇK-së. Njëri ishte mbi të 50-tat, i thinjur dhe me autoritet që më vonë mësova që e thërrisnin “Plaku” dhe tjetri më i ri e merrej me problemet operative dhe të stërvitjes së trupave.

- Këta janë miqtë tanë. Duan të të besojnë të stërvitësh disa “djem të tyre” – shpjegoi gjenerali e vazhdoi me vendndodhjen, synimet dhe orarin që ishte natën vonë dhe në fshehtësi edhe të kolegëve tanë oficerë.

Dola nga zyra i ngazëllyer dhe mezi prisja të takoja “djemtë”. U njoha unë dhe dy kolegët pjesëmarrës në stërvitje, me programin dhe me oraret.

Rrugën deri tek ata e bëra fluturimthi. Elektri i dorës më shërbente vetëm që të mos përplaseshin të tjerët me mua, pasi rrugën e dija përmendsh dhe më dukej se dikush më mbante në krah e më dërgonte atje ku më prishte më shumë kureshtja se mësimdhënia.

Oficeri i rojës së repartit më përshëndeti dhe më drejtoi te gryka e tunelit të artilerisë. Futem në zgafellë dhe nën një dritë të dobët, a thua se edhe kjo po ruante fshehtësinë e stërvitjes. Dallova një dhomë të sajuar, ndarë në dy pjesë. Gjysma fjetore me kravate dysh marinari dhe gjysma klasë me gjashtë tavolina dyshe kompensate. Shquaj në mes të kësaj dritëhije 11 djem të rinj.

I përshëndeta me shumë mirësjellje dhe bëra një prezantim sipërfaqësor. Njëri nga ata me tejet respekt më solli një evidencë dhe po më vështronin me kërshtëri të tepruar. Ata ishin si shkretëtira pa ujë dhe unë isha si boti i ujit për të bërë këtë “tokë” pjellore. Të etur për stërvitje dhe njohuri për veprime luftarake.

Largova evidencën pa e hapur dhe i sqarova se nuk doja të dija mbi emrat tuaj, nuk doja të merrja asnjë të dhënë e se për mua do të jeni 11 luftëtarë që përgatiten për front, 11 djem që po përgatiten për të shkuar drejt sakrificës më sublime, e kjo më motivon më shumë.

Zhvilluam stërvitje ditë pas dite e natë pas nate, derisa një ditë ata ikën, ikën si dallëndyshet për të mos i harruar kurrë.

Mars 1999.

- Përsëritje shef!

Kthej kokën dhe vërej njërin nga ushtarët e 11-shes.

- Jam Ramiu, - më drejtohet - Rami Badallaj nga Zhuri. Kemi ardhur nga Cahani pasi përcollëm në varreza një luftëtar që është vrarë në përpjekje me forcat serbe. Nga ne të 11-të ka rënë dëshmor Hyseni, ai nga Hasi i Gjakovës.

Megjithëse nuk e hapa asnjëherë listëvidencën, megjithëse ruajta me fanatizëm emrat e tyre, ata bisedonin me njëri tjetrin dhe unë arrita të fiksoj disa emra të tyre, duke mos arritur kurrë të mësoj nëse janë emra të vërtetë apo emra “luftëtarësh të lirisë”.

Ata ishin 11. 9 nga Prizreni dhe 2 nga Peja. Nuk i kam takuar kurrë më. Nuk kam pasur asnjëherë këtë mundësi, megjithëse dëshira ka qenë e madhe. Ata për mua kanë qenë idhuj, kanë qenë çlirimtarë e fitimtarë, kanë qenë dallëndyshet e para të lirisë së Kosovës, kanë qenë ata që më mundësuan të jap kontributin tim modest për një çështje kaq të madhe, që në jetë nuk mund të ketë kurrë përsëritje.

## **BASHKËPUNIM I SHKËLQYER**

Sapo isha kthyer nga një kualifikim në Gjermani. Malli kishte dalë mbi lëkurë. Doja t'i përpija të gjitha në një ditë. T'i takoja, të bisedoja dhe t'i përqafoja përnjëherësh. Mendoja sikur malli të ishte sfungjer dhe unë të përpija përnjëherësh të gjithë lëngun e jetës e pastaj të ulesha ngadalë e ngadalë, ta thithja e përtytpja, derisa trupi të mbushej e të kthehej në ekuilibrin e mëparshëm.

Këtë po mendoja në zyrë kur një nënoficer shërbimi më njofton se disa persona nga Kosova më kërkojnë takim. Tanimë hesapet tona me Kosovën ishin thjeshtëzuar. Ajo kishte fituar lirinë, lëvizja e lirë mes nesh kishte filluar dhe shteti shqiptar e kishte më lehtë të kontribuonte.

Si i shkëputur nga katapulta, me një ndjenjë gëzimi, malli e kurioziteti dola te porta ku dallova nga larg katër burra të bëshëm, të pjekur dhe me shpirt të mobilizuar. Pas prezantimit ata kërkuan të futeshin brenda dhe të takojnë së bashku me mua dhe ndonjë titullar të divizionit.

Duke biseduar me ata mendja xhironte një film ku kalonin në shirit zyra ime dhe zyrat e shtabit, të cilat nuk përmbushnin asnjë kusht estetik për të pritur këta miq të nderuar dhe asnjë kriter për ruajtjen e fshehtësisë së punës në shtab. Kjo ndërlikonte dhe më shumë vendimmarrjen time për persona që asnjëherë nuk i kisha takuar, nuk kisha folur apo dëgjuar. Funkzioni im nuk lejonte të tillë vendimmarrje.

- “Ahhh, klasa e shtabit!”. Ajo ishte e rregulluar bukur

se ishim në proces seminari. Ishte bosh dhe pa asnjë dokument komprometues në tavolina apo mure.

I ftova të më ndiqnin pas dhe mbajta hapin e njëjtë dhe paralel me ata. U futëm në objektin e shtabit dhe atyre u bëri përshtypje shkrimi në hyrje të elementëve të ndërlidhjes : “Ajo që shikon, ajo që dëgjon dhe ajo që lexon të mbetet brenda kësaj porte”.

Me ne u bashkua dhe shefi operativ ku mbajtëm shënime kërkesat e tyre për sektorin e ndërlidhjes. Ata pogrinin elementet dhe qendrat e ndërlidhjes në Zonën e Dytë Operative Prizren dhe kërkonin me ngulm kontributin tonë. Shtruan kërkesat për literaturë, udhëzime dhe orientime për hapjen e funksionimin e qendrave të ndërlidhjes dhe nevoja për përvojë, dokumentacion, stërvitje praktike, leksione e seminare.

Dita nuk vonoi dhe unë u gjenda para Zonës së Dytë Operative Prizren. Isha i vogël me trup, por isha munduar që në çdo qelizë të kisha vetëm ndërlidhje, ndërlidhje e vetëm ndërlidhje. Të zbrazesha e kur të kthehesha të isha i shkarkuar nga profesionalizmi dhe përvoja ime disavjeçare.

Aty të parin takova Nexhatin, shefin e ndërlidhjes, nënkolonelin me shumë autoritet dhe bashkëpunëtorët e tij. Cacën, komandantin e kompanisë së ndërlidhjes, që bënte një organizim të përsosur pune dhe mendohej të mos i shkonte asnjë fjalë pa kuptuar e shënuar. Para tyre ngjaja me një mizë toke. Ata kishin një të kaluar heroike dhe luftarake. Kishin braktisur perëndimin, kishin rrokur armët, ishin përballur me vdekjen, kishin plagë të rënda në trup dhe tani shërbenin me pasion për të ngritur ushtrinë e

Kosovës, atë ushtri, që do të ishte mburoja përballë okupatorit mizor serb. Unë dija nga lufta, dija si sigurohet ndërlidhja në kushte të ndryshme luftimi, kisha siguruar ndërlidhje nën zhurmën e predhave, por të predhave tona në stërvitje, jo të atyre vrasëse. Këtu ishte ndryshimi e ky ndryshim shtrihej edhe mes nesh, unë si lektori i tyre dhe ata si zbatues të vetëdijshëm të asaj që po u jepej.

Ditë pas dite unë i vizitoja e ata ditë pas dite rrisnin veten si ndërlidhës, përmirësonin treguesit për profesionin dhe formësonin konceptin për funksionimin e qendrave të komunikimit. Ata ishin të pangopur dhe vullneti tyre nuk kishte kufi. Unë nuk arrita t'i ngop. Isha vetëm apo isha i vogël, apo ndoshta ishin ata aq të etur për dije, aq të paduruar për të krijuar dhe forcuar ushtrinë e tyre, Ushtrinë e lavdishme të Kosovës.

Ajo frymë ishte dhe në Shtabin e Përgjithshëm në Prishtinë. Ashtu ishte dhe gjeneral Musa, me të cilin kishim bashkëpunuar në ato kohë të ndritura dhe të lavdishme të luftës, kur ai mbulonte sektorin e ndërlidhjes. Ashtu ishin dhe Hakiu, Fetiu e të gjithë pjesëtarët e ndërlidhjes.

Njeriu në jetë kalon në shumë rrugë, takon shumë njerëz, punon e bashkëpunon me ata, por kur kalon në rrugë të tilla dhe ndan mundin, përpjekjet, sakrificat e djersën me njerëz të tillë është jo vetëm fat, por edhe krenari.

## LETËR MIKUT NGA KOSOVA

Rrugën e miqësisë e mbulojnë ferrat,  
... kur atje nuk kalohet shpesh.

Rivarol

Zotit Flori Bruqi!

Kam menduar gjatë dhe nuk kam arritur të sqaroj veten time, mbi marrëdhëniet e mia dhe vijimësinë e tyre me miqtë e mi kosovarë. (Do t'i quaj kosovarë, për efekt shprehje, të gjithë ata banorë shqiptarë që për momentin jetojnë jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë, në territorin e Republikës së Kosovës).

Kontaktet e mia virtuale me Kosovën kanë lindur që në ëndrrat fëmijërore, për arsye se babai im në vitin 1939, nga nëpunës në Bashkinë e qytetit Kukës, transferohet sekretar Bashkie në qytetin e Prizrenit ku jeton e punon familjarisht deri në vitin 1946, kohë në të cilën zhvendoset përgjithmonë në qytetin e Kukësit.

Tregonte shumë gjëra, e mua më mbetej ëndërr Kosova. Kur isha në ushtri dhe dilnim në vëzhgim pranë vijës së kufirit, kisha një tjetër emocion, me lëvizte diçka në "shpirt", provoja një ndjenjë të panjohur, e kjo deri atëherë....

..... kur në gazeta filloi të flitej për UÇK-në. Komandanti më thirri e me tha që do fillojmë stërvitjen me disa "djelmosha" nga Kosova. Stërvitja do zgjaste 3 muaj e do të zhvillohej natën, në kushte fshehtësie.

Çasti erdhi... ora 23.00... në një ambient disi të ftohtë, u futa në "klase" e para meje 11 djem të moshës 20 - 25 vjeç, të etur për dije, të gatshëm për t'u përballur me makinën luftarake serbe, fillesa e kuadrove luftarakë në terren.



Të shkonte mendja se po përgatiteshin për të sulmuar “kuçedrën” e përrallave. U prezantova. Nuk i pyeta për emrat. Nuk pranova të plotësoj evidencën, ngaqë nuk desha t’i identifikoj e për mua le të mbeteshin anonim. Më vonë mora vesh se 9 ishin nga Prizreni e 2 nga Peja.

I stërvita në specialitetin tim 3 muaj. 3 muaj pa gjumë, në fshehtësi, e të nesërmen e çdo dite vazhdoja punën normal, se detyra organike kërkonte kohën e saj. Pas tre muajsh u ndamë. Më vonë mora vesh se Hyseni ka rënë në përpjekje, 10 të tjerët edhe sot jetojnë e gjallojnë.

Pas Çlirimit të Kosovës nga UÇK-ja dhe NATO më njoftojnë se në Njësinë tonë Ushtarake kanë ardhur vizitorë nga Kosova.

Pasi u takova, kuptova se ishin të sektorit tim. U njoha shkurtimisht me situatën e tyre, gjendjen e nivelin ushtarak, që kuptohet, ishte në shkallë shumë të ulët, pasi ata kishin luftuar e mësuar, por tani duhet të mësonin për të ndërtuar.

Kam marrë urdhër verbal nga komandanti dhe jam zhvendosur dite pas dite në Prizren, në Zonën e 2-të Mbrojtëse. Kam zhvilluar leksione, tema, seminare e biseda me kuadrot ushtarakë.

Mundohesha t’i përgatisja mirë materialet (që më hanin shumë kohë), të arrija synimin që ata të kuptonin atë që u duhej dhe ndjehesha shpirtërisht i kënaqur.

Disa herë kam shkuar edhe në Shtabin e Përgjithshëm në Prishtinë. Atje niveli ishte më i lartë por nevoja për njohuri ndjehej. Unë nuk isha “Mesia”, por dija nga ushtria pak më më tepër se ata... sepse kisha kryer Akademinë Ushtarake në sektorin e komunikimit, një specializim në ushtrinë gjermane në Gjermani, e një jetë përvojë ushtarake.

..... e ja tani ku dua të dal, zoti Flori.

Në atë kohë kur unë bashkëpuvoja, kur shkrija pa kursim energjitë e mia fizike e profesionale, kur punoja pa paragjykime, kur synimi im ishte vetëm të çlirohej Kosova e më vonë të ngrihej Ushtria e Republikës së Kosovës, isha “miku”, “shoku”, “shefi” “komandanti” e “Majori” i tyre i shtrenjtë.

Më dhanë Mirënjohje, foto, ftesa për festa për ditë të shënuara, etj... po më vonë... unë dola në rezervë... askush nuk përmendet..., tentoj të kontaktoj... më kot... heshtje... mospërfillje... mosmirënjohje... as ata 10 të gjallët e fillimit.... as dhjetra të gjallët e fundit.

Kjo është e gjitha, e unë dua të të pyes si mik, pasi vetë me keni thënë “të kam mik” : - Pse ndodh kjo? A duhet të shfrytëzohet tjetri e pastaj të hidhet si limon i shtrydhur? A duhet t’i përgjigjeshin ndonjë telefonate, thirrje në Facebook a MSN?

Apo “kalova lumin, të ..... kalin”! Ndoshta kjo po ndodh me mua. Unë nuk jam dakord që të mbetet “koka prapa”, se nuk dua që askush të ndjehet borxhli, por vetëm pak respekt, ndjesi në kujtim të atyre ditëve të shenjta e në kujtim të atij mundi e kohe të shpenzuar.

Pse me drejtohesh mua? - thua me vete ! E drejte! ... Por nuk kam gjetur pergjigje. Nga ata të rrethit të ngushtë, që kam biseduar, më thonë se kështu janë kosovarët. Janë mësuar me Perëndimin, kanë jetuar në Gjermani e janë bërë si gjermanët, “mbarojnë punë e s’ të njohin”, etj.... Por unë nuk jam dakord, sepse:

Një ditë në Feldafing, Landi i Bavarisë, Gjermani, po shëtisja i vetëm në breg të një liqeni. Aty ishte një çift i moshuar që po ushqenin patat në ujë. U prezantova e biseduam gjëra të rastit. U ndamë. Pas 2 – 3 muajsh, nga ana tjetër e rrugës, një

grua e moshuar në mes të trafikut, kishte nxjerrë trupin nga makina në lëvizje e thërriste : - Ej Major, wir haben in Feldafing gesehen.

Sa u gëzova!... Në të vërtetë ishim parë në Feldafing, pra vetëm parë. Kjo ishte gjermane nga Gjermania, dhe vetëm ishim parë, nuk kishim luftuar, punuar, bashkëpunuar, shkëmbyer dije e përvojë, nuk ishim bashkëkombës, nuk kishim një gjuhë, një identitet, një ide, një ideal, një dëshirë si ajo i të jetuarit bashkë, por megjithatë më tha : Ne jemi parë dikur, pra mbasi jemi parë nuk duhet të harrohemi, se “vetem mali me malin nuk piqen”.

Kjo pra ishte Zoti Flori, një fragment nga jeta ime që ta besova me shpresën se do marr përgjigjen se pse ndodhi kjo. A është normale? Apo të qetesohem me atë se të gjithë kosovarët kështu janë!

Me shumë nderime,  
Adem AVDIA

Kukës, 18 Prill 2012

## **KËSHTU LUFTUAM NE**

(Duke ndjekur në pak rrugë shefin e zbulimit)

Nuk ishte nga Kukësi, por me vite e vite shefi kishte shërbyer në veri, e veçanërisht në Kukës, ku kishte krijuar edhe familjen e tij, familjen së cilës i ishte përkushtuar aq shumë sa mund ta meritonte emërtimin “familjar”.

Forcat e armatosura serbe, sasinë, dislokimin e armatimit e teknikën e tyre i njihte shumë mirë. Kishte vite që punonte në sektorin e zbulimit ushtarak dhe punën e bënte me ndërgjegje dhe pasion. Zbulimin e donte. Kohët e fundit shifrat ishin ngatërruar disi. Kjo vinte ngaqë në muajt e parë të vitit 1998 gjallërimi dhe riorganizimi i trupave paraushtarake të shoqëruara me forca ultranacionaliste ishin shtuar dhe dislokimi i tyre në rajonin e Kosovës kishte ndryshuar me forca e mjete të tilla, sikundër ishte e quajtura “Tigrat e Arkanit”, “Beretat e Kuqe” ose “Djemtë e Frenkit” (Themelues i Forcave të Beretave të Kuqe, Frenki Simatoviç), njësia “Vetëtima”, që veproi në rajonin e Pejës, “Shqiponjat e Bardha” të Voislav Sheshelit etj. Të gjitha këto i vërente nëpërmjet Pikave të Vrojtimit dhe i shënonte me kujdes, duke bërë ndryshimet, duke i njohur komandat përkatëse e duke reflektuar në planëzimin luftarak.

Këto forca nuk qëndronin në pasivitet, por ishin vazhdimisht në lëvizje. Provokonin, shkelnin kufirin dhe ku gjenin rast futeshin në thellësi, deri sa hasnin në kundërveprimin e forcave tona të kufirit dhe të ushtrisë.

Në bllokun e shënimeve të shefit ishte pasqyruar: “Më date 8.10.1998 ushtarë serb të PK-së së Greqinës hapin

zjarr në drejtim të fshatit Dobrunë dhe një skuadër prej 7 deri 8 vetash shkelën kufirin në piramidën D1-6. Me përmasa më të zgjeruara ka qenë edhe incidenti i ndodhur me 17.12.1998 në Tropojë ku një togë komando serbe e veshur me kamuflazh të bardhë futet 60 metra në thellësi të kufirit dhe hap zjarr me breshëri për gati 50 minuta në drejtim të fshatrave Stobërdë dhe Zherkë. Më poshtë shënon dhe veprimet dinamike të forcave tona, që edhe territori të mbrohet me këmbënguljen maksimale dhe mos të bëhemi pre e provokimeve të një konflikti të armatosur frontal, pa një arsye të imponuar.

Në prill të vitit 1999 shefi zbulimit ishte në Tropojë. Sapo ishte ndarë në Kukës nga takimi me përfaqësuesit e forcave ushtarake të NATO-s që vrojtonin dhe raportnin lëvizjen e forcave në të dy anët e kufirit. Ata vëzhgonin si lëvizjen e forcave të UÇK-së, ashtu dhe të forcave ushtarake serbe. Në Tropojë u takua me vëzhgues të Komunitetit Evropian, të kryesuar nga Manfred Majer. Aty ishte dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, shefi i shtabit të Divizionit dhe kuadro të lartë të ushtrisë. Situata jo vetëm ndiqej me vëmendje, por reagimet duhet të ishin shumë të kujdesshme në këtë gjendje tepër të tensionuar.

Zv/shefi Shtabit të Përgjithshëm kërkoi shefin e zbulimit dhe e njohu me situatën në fshatin Kamenicë. Sipas informacioneve forcat serbe ishin futur në thellësi të territorit tonë. Informacionet ishin kontradiktore dhe situata duhej verifikuar në vend. Dihej që ata ishin futur në fshatin Kamenicë dhe kishin djegur disa shtëpi.

Shefi i zbulimit mori menjëherë vendimin. Duhet të shkoj në vend dhe të bëj verifikimet. Me vete përveç shefit të zbulimit të brigades, Kujtimit, mori edhe dy oficerë të tjerë të Brigadës, Aliun dhe Xhemalin. Ky i fundit, një zbulues i vjetër, të cilin e njihte për profesionalizëm, por tani kryente një detyrë tjetër. Ishin një nëngrup i vogël i zbulimit me oficerë dhe kishin marrë tashmë detyrë luftarake për zbulim. Mbasi u armatosën me kompletin e nevojshëm luftarak, u nisën nga Tropoja e Vjetër, nëpër Gegaj, dhe në orën një të natës u futën në fshatin Kamenicë. Në fshat nuk kishte këmbë njeriu përveç shtëpive që digjeshin. Forcat serbe kishin bërë djegien e shtëpive dhe ishin kthyer përsëri në pozicionet e tyre. Kufitarët tanë nuk ndodheshin në postë. Ishin tërhequr më në thellësi. Posta e kufirit ishte goditur nga forcat serbe, por ata nuk ishin futur brenda. Situata tashmë ishte e qartë. Një grup i armatosur banditësh serb ishin futur në fshat duke djegur disa shtëpi dhe hapur zjarr dhe më pas janë larguar pa hasur asnjë rezistencë. Fshatarët kishin mundur të tërhiqen në thellësi e të mbroheshin në tunelet e qendrat e zjarrit të ndërтуara para viteve 90. Rrugës takuan fshatarë të armatosur të cilët u munduan t'i ndalonin, me mendimin se forcat serbe ishin të shumta dhe ata do të vriteshin. Megjithatë vazhduan në drejtim të fshatit Kamenicë për të plotësuar misionin e tyre.

Forcat serbe me sa duket ndiqnin taktikën e njohur nga ne, atë të terrorit, vrasjeve, djegieve, spastrimit të zonave e të daljes në shpinë të kundërshtarit. Ky kishte qenë edhe qëllimi i veprimeve luftarake në Kamenicë, plan i cili u provua edhe nga dokumentet e hartat e ushtrisë serbe

të kapura nga luftëtarët e UÇK-së gjatë veprimeve luftarake në Koshare. Mbase përfunduan misionin dhe raportuam në qendër u nisën për në Bajram Curri. Rrugëkalimi tyre ishte mbjellë me mina të hedhura nga forcat e ushtrisë serbe. Minat ishin hedhur me raketa hedhëse 262 mm (12 rd) M87. Ishte hera e parë që përdoreshin të tilla mina, mina që mund të hidheshin nga një distancë prej 50 km. Këto raketa minahedhëse janë të njohura si Orkan M87 të prodhimit jugosllav. Orkan M87 janë vdekje prurës dhe janë të dorës së parë duke përdorur mina AP (Anti Personel) dhe KT (kundër tanke). Një raketë e tillë mund të mbjellë një fushë të minuar prej 1000 x 1000 m me mina në një interval 3 - 4 m dhe një km fushë e minuar KT shtrihet për 14 deri 25 minuta. Duke ardhur me kujdes mundën t'iu shmangeshin edhe këtyre fushave të minuara e të ktheheshim me mision të plotësuar në brigadë.

Shefi shënonte në hartë dhe ndiqte me vëmendje situatën. 11 maj 1999. Forcat serbe (kryesisht ato të brigadës 125 e këmbësoresë serbe dhe repartet speciale të tyre) sulmuan me qëllim rrethimin dhe asgjësimin e forcave të brigadës 138 të UÇK-së, që komandohej nga Rustem Berisha e që vepronin në Padesh e Koshare, sulm të cilin ato e kryen me forca e artileri në një front katër kilometra me një pykëzim 2.1 km në drejtimin Qafë Morinë – Kamenicë - Padesh për t'i krahëmarrë dhe për t'i dalë në shpinë këtyre forcave. Nga raportimet e PVC-së Padesh, në orën 12 e 25 minuta nga Batusha në rajonin e piramidës C4 Qafë Morinë dhe deri tek piramida C2 në front e në thellësi filluan goditjet me artileri të ushtrisë serbe që përgatiste terrenin

për trupat këmbësore. Në orën 16, përgjatë përroit të Kasajve, nga krahu i djathtë, kuadrat 9934d dhe krahu i majtë 9734d, forcat e ushtrisë serbe mundën të shpërthejnë e të futen në thellësi të tokës sonë deri në 2.1 km në një front 4 km. Kjo situatë u paraqit edhe nga komandanti i brigadës. Situata ishte e ndërlikuar dhe duhej vepruar. Forcat e gatshme të Divizionit së bashku me forcat e Batalionit të Tretë Kufitar, në bashkëveprim me forcat e UÇK-së, thyen sulmin e forcave serbe. Major Muhameti nga vendkomanda e kohës luftës udhëzonte e drejtonte veprimet luftarake. Në hapjen e zjarrit u angazhuan obusët 122 mm me pozicion zjarri në Babinë, forcat e bk-së në Dizdar me Kujtimin, kompania e tankeve me Idrizin. Zjarri i artilerisë që vendimtar dhe u drejtua nga oficeret artiljerë Rakipi, Petriti dhe Saliu. Vendimi dhe urdhri për hapjen e zjarrit në asgjësim të këtyre forcave serbe u mor nga grupi i drejtimit operativ të luftimeve në Shtabin e Divizionit të Kukësit, mbas informimit të situatës nga zbulimi, nën drejtimin e shefit të shtabit kolonel Selimit dhe mbas bisedës me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Andonin. Të gjitha këto raportime e informacione çuan në vendimin për hapjen e një zjarri të fuqishëm ndaj forcave serbe që kishin depërtuar në tokën tonë. Gjeneral Andoni ka qenë sa i komunikueshëm aq dhe i rreptë në detyrat që i vinte shtabit e komandës së Divizionit si dhe i preokupuar e vazhdimisht në koherencë të ngjarjeve që sa vinin e rriteshin dhe nuk mund të kalonin pa mendimin, vlerësimin e vendimin e tij, të një ushtaraku profesionist.



Në orën 20 e 40 minuta ushtarët serbë u tërhoqën nga pozicionet e zëna. Qafa e Morinës, fshati Kasaj dhe mali i Gështenjave u spastruan. Të nesërmen, më 12 maj, forcat tona në Tropojë, nën drejtimin e komandantit të divizionit Gjeneral Brigade Lama, kaluan në kundërveprim duke hapur zjarr me artilerinë e top obusëve 122 mm dhe duke detyruar përfundimisht forcat serbe të tërhiqen e duke lënë në fushën e luftës armatim, aparatura, instrumente, ushqim e materiale të tjera.

Shefi i zbulimit në Qafë Prush. 17 maj 1999. Në drejtim të piramidave C/13,C14/7, në afërsi të Majës së Zezë, pati shkëmbime zjarri midis forcave tona dhe atyre serbe. Forcat serbe mundën të futen 700 - 800 m në tokën tonë, me qëllim kapjen e rrugës Kukës – Tropojë (dalja në majën e Sukës, kapja e malit të Oplasit), një njeje e rëndësishme për komunikimin e furnizimin edhe të UÇK-së. Ushtarët serbë ishin të armatosur edhe me armë KT të tipit „Zola“. Në drejtimin e koordinatorit të artilerisë major Aliut, bna 122 mm dhe obusëve në Golaj, hapën zjarr në rajonin e Majës së Zezë të Hasit dhe në Kalazarit, duke shpartalluar dy toga drejtimi të forcave serbe, si dhe u hap zjarr nga forcat tona tankiste e ato të batalionit të parë të këmbësores së Krumës, duke i detyruar forcat serbe të tërhiqen, rreth orës 17, përsëri në pozicionet e tyre. Shkëmbimet e zjarrit vazhduan deri në orët e vona të natës.

Informacioni për rrëzimin e një avioni pa pilot në afërsi të Stobërdës vuri në lëvizje forcat ushtarake serbe, por edhe zbulimin ushtarak të vendit tonë. Me 16 maj 1999 një grup zbulues i këtij batalioni me në krye shefin e

zbulimit të batalionit, major Maksimin nisën kërkimet për gjetjen e marrjen e pajisjeve elektronike si kamerat, kutinë e zezë, radio etj, të avionit të rrëzuar amerikan, operacion që përfundoi me sukses. Veprimet e këtij batalioni kanë qenë të domosdoshme e të vlerësuara.

Tropojë 18 maj 1999. Goditen me zjarrin e artilerisë dhe të tankeve të gjithë pikat e vëzhgimit, çerdhet e zjarrit të forcave serbe gjatë vijës kufitare nga piramida C- 6 deri në majën e malit të Zymit me kombinimin e zjarrit të artilerisë nga Padeshi në Tropojë.

Java e fundit e majit në Kishaj. 26 - 31 maj 1999. U bënë luftime të vështira e të përgjakshme përballë dy fronteve, atij të UÇK-së vendosur në Cahan – Kishaj - Pogaj dhe atyre serbe të stacionuara në Gorozhup – Plane. Ishin ditët e fundit të muajit maj, kur në operacionin e Pashtrikut, pjesë e operacionit “Shigjeta“, ishte krijuar një situatë e vështirë për forcat e UÇK-së. Luftëtarët e kësaj brigade, të inkuadruar në pesë batalione me rreth 2.000 vetë, po luftonin dhëmbë për dhëmbë për mbajtjen e vijës Pashtrik – Kishaj - Pogaj. Forcat serbe në drejtimin Gorozhup - Plane, në raport me UÇK-në ishin më të armatosur, por terreni nuk i favorizonte të ndjeheshin të sigurtë. Herë pas here jo vetëm buza e kufirit, por edhe në brendësi të kufirit tonë me Kosovën, nga forcat serbe hapej zjarr me artileri e mortaja që e bënte të pamundur përparimin e forcave të UÇK-së në drejtimin Kishaj - Gorozhup.

“Task Force Haëak“ që komandohej nga gjenerallejtnant Jay Hendrixh (gjenerallejtnant në Armatën Amerikane dhe gjeneral komandues në Korpusin e V-t

amerikan në vitet 1997 dhe 1999) duhet t'ua kenë bërë të qarta situatat në të cilat ndodheshin veprimet luftarake udhëheqjes së NATO-s. “Task Force Haëak” ishin forca zbuluese të objektivave e trupave ushtarake në terren. Këto forca së bashku me forca të tjera të Nato-s hynë në Shqipëri si forca ndërkombëtare për të mbrojtur e ndihmuar karvanët e refugjatëve që largoheshin nga fronti i luftës në Kosovë.

Më 30 maj, shefi i zbulimit, së bashku me dy përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, nënkolonel Bashkimin dhe nënkolonel Dashamirin, mes predhave e plumbave të snajperëve të forcave serbe, shkuan në vijën e parë të luftimeve. Situata me të vërtetë ishte e vështirë. Disa luftëtarë të UÇK-së ishin vrarë. Një bateri e mortajave 82 mm të kësaj brigade, që vëzhguan gjatë kalimit në vijën e pare, qëllonte kuturu, pa shënjestër. Në bisedat e shkurtëra doli se ishin të pakompletuar. Qitësit kishin bërë vetëm pak ditë një kurs trajnimi në Burrel. Të tjerë që takuan në pozicionet e para dhe në kullën e vrojtimit (dikur postë e përparuar e kufirit në Postën kufitare Kishaj) dukeshin të lodhur. Njëri nga tre vrojtuesit, luftëtar i UÇK-së, ndërmjet të tjerave, u bëri edhe një pyetje, nëse do ta fitonim betejën që kishim filluar. “Pa diskutim - ishte përgjigja tyre - sepse kishim në krah forcat e NATO-s, në krye të të cilave ishin SHBA”.

Kontaktet me grupin e oficerëve të FA-së amerikane në zyrën e shefit të shtabit të divizionit kolonel Selimit ishin në vazhden e luftimeve që bëheshin në terren. Këtu në hartat e operacioneve precizoheshin shënjestrat goditëse të

aviacionit të NATO-s, siç ishin ato të goditjeve nga Qafa e Prushit, mali i Kralicës, Goden, rajonet Gorozhup, Plane, Zhur.

Zherkë. 2 qershor 1999. Forcat serbe kapin lartësitë mbi fshatin Zherkë duke djegur edhe 2 shtëpi. Informacioni i policisë kufitare përputhej me atë të pikës sonë të vrojtimit. Mbas përpunimit në shtabin e divizionit, me urdhër të shefit të shtabit të divizionit hapet zjarr i saktë me një artileri e një bateri obusësh të vendosur në Babinë. Manovrimi i një nënreparti këmbësorie të mekanizuar me tanke nga Tropoja në Qafë Luzhë detyroi tërheqjen e forcave serbe. Artiljerët tanë të obuzave 122 mm me PZ në Babinë, nën drejtimin e artiljerit të sprovuar kapitenit të parë Petritit, disa herë me zjarrin e tyre të befasishëm kanë detyruar forcat serbe të tërhiqen. Ushtarët tanë asnjëherë nuk e kanë lënë pozicionin bosh.

\* Subjekti dhe materiali është marrë e përpunuar nga libri “Kujtime në vite” të nënkolonel Shyqyri Shabani, shefi i zbulimit të divizionit të këmbësorisë, Kukës.

## **A ISHTE I THYESHËM ATDHEU YNË ?**

Në vitet e para të karrierës ushtarake oficeri është shumë aktiv dhe i sakrificës. Ai është i pari në stërvitje e në shërbim, qëndron larg familjes, në punime e gatishmëri me efektivet e ku ta vlerësonte të nevojshme apo ta dërgonte komanda. Nuk është e veçantë se oficeri i ri këto sakrifica i bën nga dëshira, por e veçanta është se kolegët më në moshë dhe karrierë nuk kanë asnjë mëshirë për atë dhe për sakrificat e tij, pasi ata këtë periudhë “harakiri” e kishin kaluar edhe vetë. Po të ishe oficer jabanxhi, që në veri ishin me dhjetëra, atëherë kjo barrë shumëfishohej e shlyhej me pak leje në familje, ndoshta atëherë kur nuk e kishte të nevojshme as ai.

Një ndër angazhimet më të lodhshme të oficerit të ri ishte dhe stërvitja vetmore me ushtarët, apo si quhej në gjuhën e përditshme “karantina”. Para se të fillonte ajo, ne oficerëve të rinj na dërgonin disa ditë stërvitje në komandën eprore në Pukë. Atje stërviteshim dhe kryenim veprimet e ushtarit. Stërviteshim nga kolegët tanë më të përgatitur dhe që kishin karrierë më të gjatë. Ata nuk na mëshironin gjatë zhvillimit të stërvitjes, por na ushtronin me të gjitha elementët e stërvitjes vetmore të ushtarit, e për ne kjo jo vetëm që ishte e vështirë, por ishte dhe e lodhshme dhe e bezdisshme. Nganjëherë stërvitjet në shkollën ushtarake nuk ishin asgjë krahasuar me atë në shkollën e trupave.

Krahas stërvitjes aktive bënim dhe edukim politik. Atë na e zhvillonte ndonjë kuadër politik, ndër më të

përgatiturit, ose ndonjë kuadër që kishte shumë karrierë ushtarake në sektorin politik.

Një ditë orën e edukimit politik do na e zhvillonte komisarit korpusit. Ai kishte një autoritet të paparë dhe sfidonte hapur edhe komandantin. Ishte shumë aktiv, punëtor, i sakrificës dhe ndiqte problemet duke i parë dhe prekur vetë me dorë. Adresa e tij në gjithë korpusin nuk dihej. Sa ishte në drekë në një repart, në darkë ishte në një repart tjetër. Në gjithë këtë dinamikë, asnjë nuk e mbante mend për të keq. Tema që do na zhvillonte ai ishte: “Pse atdheu ynë është i pathyeshëm?”.

Ai fliste dhe ne shkruanim. Ai argumentonte dhe ne kalonim nëpër mend ato që ai analizonte. Moralit, lufta e drejtë, shpirti luftarak, gatishmëria, organizimi i popullit ushtar, mobilizimi dhe stërvitja e popullsisë civile në SHLU, organizimi i njoftimit të njëkohshëm dhe shkalla e lartë e paraqitjes së të mobilizuarve në reparte, rajonizimi i strukturave rezerviste, stërvitja cilësore e forcave aktive dhe rezerviste, fortifikimi i gjithë territorit të vendit deri në zonat më të thella, studimi i zonave të mbrojtjes dhe zhvillimi i stërvitjeve praktike, rezervat për disa vite lufte dhe administrimi korrekt i tyre, planifikimi i mbrojtjes taktike, operative dhe strategjike në të gjithë hapësirën tokësore, detare dhe ajrore vetëm me forcat tona dhe zhvillimi i stërvitjeve nga shkallët taktike, deri në ato operative, e në fund mbyllej me vijën e drejtë e parimore të Partisë, mësimet e shokut Enver dhe zbatimin e tyre në praktikë e stërvitje. “Partia, – theksonte ai, – është truri dhe

zemra e ushtrisë, forca jetëdhënëse që e bënte atë të pathyeshme”.

Bllokun me shënimet e komisarit nuk e ndava nga dora për shumë kohë në repart. Në orët e edukimit ai ishte udhërrëfyes dhe më shërbente për edukimin politik të ushtarëve. Ai ishte një koncentrim i gjithë materialeve politiko – ushtarake, që kisha kaluar ndër vite nëpër dorë. Ishte një ndër temat më cilësore dhe leksionet më analitike që kisha marrë. E kjo ishte merita e komisarit, merita e atij që mua më kishte mbushur mendjen e shpirtin se atdheu ynë ishte i pathyeshëm. Ai atë detyrë kishte dhe atë e bënte shumë mirë. Ashtu si unë kisha detyrë sigurimin e pandërprerë të ndërlihdjes dhe shefat e tjerë detyrat sipas misionit.

Në fakt, a ishte i pathyeshëm atdheu ynë?

Kjo është pyetja “1 milion dollareshe”!

Është përgjigje që sot vështirë të përfshish në mendim një person të dytë. Dilema qëndron në mes. Unë mendoj akoma se pavarësisht në ishte apo jo “i thyeshëm” atdheu i ynë, por shprehem i bindur se ai nuk mund të thyhej duke mbetur në të gjallë. Nisur nga edukimi ushtarak, atdhetar, patriotik dhe vlerësimi politik, kur atdheu “të thyhej” ne nuk do të ishim, pra ne do të thyheshim bashkë me atdheun.

Po! Atdheu ynë ishte i thyeshëm, por i thyeshëm në një “tokë të djegur”.

Detyra e komisarit, e imja dhe e të gjithë ushtarakëve ishte propagandimi i idesë dhe ideologjisë se “Atdheu ynë është i pathyeshëm” e këtë bindje ta ngulisnim mirë në

mendjen e zemrën e popullit ushtar, jo vetëm me fjalë, por edhe me stërvitje të pandërprerë e intensive.

Kurse nga ana ushtarake ishim të dyzuar. Këtë mendim e krijonim në raportin e forcave të kundërshtarit dhe në sasinë ushtarake të forcave e mjeteve të tij, duke mos menduar asnjëherë për aleanca e koalicion aleancash. Llogarisnim këtu tanket, aviacionin dhe artilerinë e rëndë, të cilat kundërshtarët tanë i dispononin dhe i prodhonin vetë. Nga ana tjetër llogarisnim dhe terrenin ku do të rreshtoheshin këto forca. Terrenin e thyer e me qafa e gryka të ngushta ku nuk të lejon të manvrosh e të sulmosh me sasi të madhe forcash e mjetesh e njëkohësisht, të pengon manovrimin e shpejtë me teknikë të rëndë.

Gjithashtu merrnim në konsideratë bregdetin shqiptar. Pasha Limanin, Karaburunin, kalanë e Turrës, pozicionet e fortifikuara të artilerisë bregdetare e numrin e pamasë të tuneleve e qendrave të zjarrit për llojet e armëve e të teknikës luftarake. Numrin e nëndetëseve, zonën e manovrimit të tyre dhe kujdesin që tregohej për mirëmbajtjen dhe gatishmërinë luftarake të teknikës. Bazën ajrore të Gjadrit apo Kuçovës dhe gatishmërinë e avionëve luftarakë. Studionim dhe krahasonim situatën luftarake dhe zhvillimet në provokacionet e gushtit 1949, në luftë me shovinistët grek, ku forcat tona zmbrapsën kundërshtarin në thellësi të territorit të tyre dhe rivendosën situatën në kufirin shtetëror.

Në popull bëhej një punë e madhe propagandistike, bindëse e sqaruese. Ishte ngulitur se “Mbrotjtja e atdheut detyrë mbi detyrat” e kjo jo thjesht parullë. Ishte zbatim në



praktikë. Këtij populli të varfër i hiqej nga goja e shtëpia një sasi e konsiderueshme shpenzimesh, sasi që investohej në strukturat e mbrojtjes, ndërkohë që populli vuante për bukë. Vuante e besonte dhe e pranonte gjendjen si ishte, e përsëri përgatitej seriozisht për mbrojtjen e vendit.

Pas proceseve demokratike që kaluam situata është përmbysur për mbrapsht. Nuk marr përsipër të bëj analizën, por kujtoj një thirrje “erdhi serbi ... “ më 13 mars 1997 në qytetin e Kukësit dhe masivisht qyteti u zbraz, duke mbetur në dorë të një pakice idealistësh, të cilët ruanin frymën atdhetare e patriotizmin e kahershëm.

Sot rinia nuk përgatitet për mbrojtje. Nuk mëson teknikën dhe armatimin dhe nuk është e aftë të mbrojë atdheun e të përballojë situata luftarake. Mbrojtja e atdheut nuk është e bazuar te populli ushtar dhe as te ushtria aktive. Mbrojtja e atdheut është e “siguruar” nga aleancat, për sa kohë ato të ekzistojnë. Sot njerëzit janë të prirur nga materializmi duke lënë pas idealizmin. Njeriu është i prir të jetë i lidhur më shumë me materien se me idealin, pra jetën e ka të lidhur më shumë me pronën se me atdhetarizmin. Më afër prona se Atdheu. Populli ka lënë shprehjen “larg vetes sime”. Regjimi socialist i kishte njerëzit pa pronë dhe e vetmja pasuri e tyre ishte ideali, kurse sot duke pasur pronën, lidhet aq shumë me atë, sa idealizmat dhe patriotizmat kalojnë në plan të dytë apo nuk ekzistojnë fare. Tanimë fati i atdheut dihet dhe përgjigja se: nëse është i thyeshëm Atdheu ynë është shumë e lehtë. Nuk është më pyetje “1 milion dollareshe”.

## DEMOKRACIA DHE SIMBOLET KOMUNISTE

Ishte viti 1992. Këtë vit pranvera erdhi më herët dhe gjallesat sikur shpejtoheshin të bënin rizgjimimin e shumimin më shpejt se vitet e tjera. Njerëzit dukeshin të hallakatur dhe nuk dinim nga t'ia mbanin. Edhe ata mezi prisnin rizgjimimin e përfitimin. Ai që ishte i guximshëm dhe i patrembur, kuptohet edhe fytyrëpaskuqur, nuk flinte fare. Planifikonte, maste puls, hidhej në sulm e me shpejtësi korigjonte e gjuante gjahun më të mirë. Kështu shumë magazina, dyqane, toka, prona të tundshme e të patundshme firuan nga inventari i shtetit, të atij shteti në shpërbërje e formësim. Pushtetarët e tij po gllabëronin edhe vetë më shumë se të tjerët. “Prona e shtetit, prona e kurrkujt”.

Oficerët, të mbërthyer nga ligji dhe rregullorja, të futur dhe të lidhur në kompleksin e ndërlikuar të rripave, vazhdonin të mbërthenin akoma telin në qafën e ngushtë të xhakëtës model kinez dhe të kryenin detyrën dhe misionin e ngarkuar. Nderi, dinjiteti, betimi, uniforma, rregullorja dhe ligji nuk i lejonte të vepronin. Ata lejoheshin vetëm të shikonin, të dëgjonin, të vërenin si zhdukeshin pronat, qofshin dhe ato ushtarake. Por nuk kishin të drejtën e fjalës. Çfarë dëgjonin e shikonin, çfarë po ndodhte përtej murit imagjinar që ndante ushtrinë nga jeta civile, nga jeta ku bëhej e hahej përsheshi, nuk kishin asnjë të drejtë as ta komentonin publikisht.

Edhe në ushtri filloi zgjimi dhe u morën disa vetiniciativa të guximshme. Pak kolegë menduan dhe

vendosën që në tokën brenda territorit të repartit të mbillnin zarzavate. Në ato mini parcela filloi të dukej jeshili i domates, specit apo kastravecit, jeshil që mbeti vetëm jeshil dhe nuk u bë asnjëherë frutë. Raportime, takime, verifikime, analiza, vërejtje dhe shpejt rikthimi i kopshtit në livadh. Ky ishte përfitimi dhe zaptimi i pronës nga ushtarakët, të asaj prone që nuk vonoi, por fshatari trim, ngjitur me repartin, i vuri telin me gjemba të grabitur në repart dhe e kufizoi si të tijën.

Në të vërtetë uniformat tona nuk ishin të bukura dhe të lakmueshme nga ushtarakët. Kjo nuk ishte aspak një nga arsyet estetike që të mobilizohesh në radhët e ushtrisë. Kur shihnim uniformën tonë pa grada dhe fotot e ushtrive të para viteve 60, jo vetëm i kishim lakmi, por dhe na mërzitej vetja me këtë shkrirje të tejskajshme hierarkie. Ishte bërë praktikë që shumë nënoficerë mbanin në çanta kapele oficeri dhe kur dilnin jashtë repartit, hiqnin kapelën e tyre dhe vendosnin kapelën e oficerit. I vetmi ndryshim në uniformë, kapela. Shpirt i marrëzishëm karriere.

Në kapele dhe në kopsa ishte i formësuar ylli pesëcepësh. Kujdeseshim shumë për këto simbole, të vetmet në uniformë. Kopsat i pastronim mirë deri sa shkëlqenin, kurse yllin mundoheshim ta gjenim sa më të bukur, të kuq me rreze të dukshme dhe të kufizuar nga jashtë. Kishte raste kur hasnim në ndonjë yll të uniformave kineze, që ishin të pazëvendësueshëm. Kuadrot komandues kishin në përgjithësi yje më të mirë dhe më të bukur, sepse kishin edhe mundësi më të mira për t'i siguar.

Filluam të bëhemi të rëndësishëm. Me ne filloi të merrej dhe parlamenti. Nga e majta thonin se “një kapter që ruan këpucët e ushtarëve merr sa një zv/ministër”, kurse të djathtët propozonin “ta bëjmë ushtrinë si Luksemburgu”, i cili kishte 600 ushtarakë dhe këto i mbante në Austri e i thërriste kur kishte nevoja. Përfundimi:

... erdhi një ditë urdhri “Për heqjen nga përdorimi të simboleve komuniste në uniformat ushtarake”. Ky urdhër u kufizua përkohësisht vetëm tek ylli në kapele, pasi po të hiqeshin edhe kopsat me yje, do ngeleshim me pantallona në duar.

Ishin ditët më të vështira për të gjithë ne, urdhërbatuesit e bindur. E shikonim të ndrojtur njëri tjetrin. Kapelat më shumë i mbanim në dorë. Në kapele dallohej ngjyra e pazbardhur nga dielli e vendit të yllit dhe vrimat e pambyllura ku kishte qenë i mbërthyer ai. Na dukej vetja jo vetëm kot, por si “Gjon Karroca”, – punëtor komunaleje që mbante në kokë kapele oficeri pa yll dhe transportonte me karrocë mbeturinat urbane të qytetit. Kishte edhe kolegë të rrallë dhe të veçantë që nuk pranuan të heqin simbolet pa i zëvendësuar me të tjera, por shiheshin si “delja e zezë”, jo vetëm nga eprorët, por edhe nga shokët. Kjo situatë zgjati jo shumë, por lënia në këtë gjendje e ushtarakëve dhe pastaj mosreagimi tyre ishte një pulsmatës i mirë i politikës ndaj çdo padrejtësie apo loje që mund të luhej në kurrizin e ushtarakëve. Dhe këto veprime nuk u ndalën këtu...

Kanë kaluar shumë vite nga koha e simboleve. Kohët e pronat kanë ndryshuar dhe janë përmbysur, por oficeri, tanimë në lirim nuk ka ndryshuar aspak. Ka ngelur ai

urdhërbatuesi korrekt edhe sot pa pronë, me atë të Enverit shtëpi e divan dhe pa asnjë prokopi. Ka ngelur ai njeri i ndershëm, i bindshëm, i kulturuar dhe i edukuar. Ka mbetur me një pension minimal, pension që e bën të hezitojë para derës së lokalit. Pension që nuk garanton ilaçet dhe kafënë. Ka edhe nga ata që janë përfshirë në tregun e madh të kohës, por edhe pse janë pak nuk arritën të përfshijnë pranë vetes atë pjesë kolegësh “jomëkatarë”, që jo vetëm vetë u treguan korrekt e të ndershëm, por dhe fëmijët e tyre i mëkuan me atë edukatë dhe sjellje parimore e idealiste.

## **GJASHTË MUAJ NË SHËRBIM**

Lugu i Zi! Po, po, Lugu i Zi më thanë se quhet.

- Po pse Lugu i Zi? - pyeta.
- Ta tregojnë ata kur të arrish atje, – më thanë.

Nuk kishte nevojë të më thoshte askush se pse quhej Lugu i Zi. Ishte i rrethuar nga të gjitha anët me male dhe nuk dukej asnjë shtëpi banimi. Ishte nënrepart i përparuar i batalionit mitraljer të Tropojës së Vjetër, në mbështetje të postës kufitare të Lugut të Zi. Distanca midis tyre 2 kilometër, kurse largësia nga fshati më i afërt, Vicedoli, ishte rreth 3 kilometër. Reparti ishte vendosur në një luginë të vogël përgjatë përroit, që zbriste nga Qafa e Milisës në drejtim të Zherkës, ku ndodhej batalioni tjetër mitraljer. Nga reparti dukej qielli dhe vetëm majat e maleve të Pëllumbit, malit të Erenicës apo të malit të Zymit. Kufiri shtetëror nga reparti ishte rreth 2.5 kilometra.

Aty shtrihej reparti, maskuar më mirë se një burg i sigurisë së lartë. Kush ishte i burgosuri? Ndoshta unë apo ushtarët që do të marr në dorëzim. Nuk kishte rëndësi. Ishim bashkë. Ishim të dënuar pa vendim gjykate, të dënuar për të qëndruar aty, për të mbrojtur atdheun dhe për të bërë kufirin shtetëror çelik e beton. Unë dhe ushtarët e mi. Unë që kisha mbaruar shkollën ushtarake dhe kisha mësuar se si të hedh në sulm një brigadë, si të stërvit popullin ushtar, si të mbuloj me forca një rajon të tërë mbrojtje, po vija të strukem këtu në këtë humbësirë, në Lugun e Zi. Të paktën të quhej Lugu i Bardhë.

Komandanti dorëzues qëndroi atë natë me mua. Kishte një muaj që nuk kishte shkuar pranë familjes. Sapo kishte marrë njoftim se do të shkoja unë, kishte bërë gati ndërresat e palara dhe diçka që nuk e mora vesh, në një çantë shpine, dhe i kishte paketuar për rrugë. Në darkë na sollën një pjatë fasule, nga ajo që ishte gatuar për mëngjesin që vjen, ku dukej një njollë salce në mes, një kokë qepe e thatë e prerë në dysh, një brokë uji e ciflosur dhe dy tasa alumini me çaj. Ishte një darkë pune ku komandanti më njohu me repartin, vendndodhjen, sasinë e ushtarëve, aktivitetin e tyre, dokumentet e planëzimit e të ruajtjes, dokumentet e drejtimit të luftimit dhe shërbimit, bashkëpunimin me forcat kufitare, dosjet e kompletimit me rezervistë, mënyrën e njoftimit tyre, dokumentet e shërbimit të përditshëm dhe mënyrën e marrjes dhe raportimit të informacionit në komandën eprorë. Para se ushtarët të shtriheshin për gjumë më bëri prezantimin dhe kalova në revistë ambientet e trupprojës dhe ruajtjes së repartit.

- Muaji i parë dhe i dytë.

Përçolla komandantin pasi kisha firmosur marrjen në dorëzim të shërbimit. U ula në karrigen e shtrembër të zyrës dhe po mendoja se nga të nis. Vetmia. Nuk më linte të mendoja. Ajo kishte shtrirë duart drejt meje e gishtat e saj sapo kishin prekur qenien time. Një lot burri e kapërdiva poshtë. Në mendje më kishte mbet... Lugu i Zi, Lugu i Zi. “Mirë, – mendova, – ishalla nuk më shkon zi e më zi”.

Rreshtova ushtarët e shërbimit në trupprojë dhe bëra instruksionin. Ushtarët e tjerë po hanin bukë. Mora masa që

të bënin gati veglat e punës dhe bazën materiale. Vendin e punës dhe volumin e punimeve e dinin më mirë se unë. Ushtarët e vitit të dytë dhe ushtarët që ishin komandantë skuadre ishin specializuar për punime fortifikuese. Një skuadër do mbante zhavorr në kodër me çanta shpine dhe ujë me bidon. Ishte një garnizon qendra zjarri shumë i vështirë.

Ushqimi erdhi me bidonë alumini. Mua më sollën një pjatë ku në anët e saj dukeshin grimca dheu, por nuk ishte vendi për t'i parë. Ishte koha për të ngrënë. Në darkë ushtarët zbritën në repart. Veprimet i kryenin si të kurdisur. Më dukej se ata mund të kryenin çdo veprim edhe symbyllazi. Raportova planin e punimeve. Kontrolllova shërbimin dhe u shtriva në krevat duke ndjerë një therje diagonale në shpinë.

Dita fillonte me zhurmat e ushtarëve në shesh. Mërzi këtu ishte të fillosh ditën edhe nën cicërimat e zogjve.

Procesverbalin e shërbimit e përpiloja çdo ditë në mëngjes. Unë marrësi dhe unë dorëzuesi. Ashtu dhe librat e organizimit e të ruajtjes. Instruksionin me ushtarët roje e bëja vetë. Ushtarët në punime i shoqëroja si në vajtje e në kthim. Në darkë e mëngjes kisha fasule. Nganjëherë shtoja dhe turshi që e sillte nga shtëpia kujdestari. E kisha ndaluar të sillte raki në repart.

- Muaji i tretë dhe i katërt.

Procesverbalin e shërbimit vazhdoja ta përpiloja çdo të hënë. Unë dorëzuesi dhe po unë marrësi në dorëzim. Instruktazhin e shërbimit një ditë e bëja vetë e një ditë komandanti i trupprojës. Dokumentet e shërbimit i firmosja



vetë në lokalin e truprojës dhe armatimin e vulosja me vulën time. Ushtarët shkonin përpara në vendin e punës dhe vazhdonin punimet me qendrat e zjarrit e unë shkoja pastaj e bëja kontrollin e volumit të punimeve.

Kujdestarit i lejova të sillte pak raki në repart dhe në darkë pija një ose dy gota. Raportimet i bëja me vonesë ose kur më thonin se të kërkon operativi për të dhënë shifrat. Ato i jepja të rrumbullakosura.

Të hënën shkoja në sektor të fshatit Viçidol dhe takoja përgjegjës, brigadierin apo kryetarin e këshillit, ku interesohesha për rezervistët dhe pija një kafe me raki. Aty merrja vesh se çfarë bëhej. Të shtunën shkoja për darkë te posta e kufirit dhe kaloja mirë me kuadrot e postës kufitare. Pastaj mbyllesha në Lugun e Zi. Zi e më zi.

- Muaji i pestë dhe i gjashtë.

Ushtarët shkonin në punime dhe unë merrja raportimin nga komandanti togës dhe kujdestari. Dy herë në javë shkoja vetë dhe bëja kontroll, ku ngrija zërin për punimet që nuk kishin përparuar.

Procesverbalin e shërbimit e përpiloja një herë në javë, unë dorëzuesi, po unë marrësi. Instruktazhin e bënte komandanti truprojës dhe dokumentet për firmë m'i sillte në zyrë.

Fillova të dal më shpesh në fshat dhe të bëj vizita më të shumta te posta e kufirit. Vonohesha dhe kur vija në repart më dukej se filloja nga fillimi. Rrallova rruajtjen e fytyrës dhe për t'u qethur qethesha nga kujdestari me makinën qethëse të ushtarëve dhe me gërshërët e kujdestarit.

Ushtarët kishin filluar të ambientoheshin me mua dhe kjo ishte frika ime më e madhe. Një ditë dërgova një ushtar të mbushte ujë me ibrik. Burimi ishte pak larg, por ushtari u kthye shpejt dhe unë dyshova se e kishte mbushur te përroi poshtë repartit. I drejtohem ushtarit:

- Pije ujin!
- Si t'a pi? – u habit ushtari.
- Pije të them! – e ngrihem në këmbë.

Ushtari filloi të pinte e unë vazhdoja pa ndarë: “Pije, pije, pije deri në fund”. Ushtari i piu me fund tre litra ujë dhe e mbante ibrikun bosh në dorë.

- Tani shko mbushe te burimi dhe ma sill, – i bërtita.
- Dita e fundit e muajit të gjashtë.

Më njoftojnë se në repart do të vijë komisari i brigadës. Nisa ushtarët me kujdestarin në punime dhe vetë u mora me sistemimin e rregullimin e ambienteve, zyrave dhe plotësimit të dokumentacionit dhe këndit të emulacionit. Një ushtar i vitit të dytë kishte plotësuar aq sa kishte mundur evidencat dhe format e edukimit. Kryesorja ishte plotësimi i planit të punimeve mbrojtëse.

Komisari arriti me makinë i shoqëruar nga dy oficerë. Me sa kuptova ata ishin oficerë të fortifikimit. Pasi mori informacion për punimet mbrojtëse dhe edukimin politik të ushtarëve, drejtoi pyetjen:

- Me kë je tjetër këtu?
- Vetëm, shoku komisar. Është edhe kujdestari.
- Prej sa kohe nuk ke lëvizur?
- Kam gjashtë muaj këtu.

Komisari bëri të habiturin apo të paditurin dhe pa u kthyer nga tavolina, rrotulloi gjysmë dorezën e telefonit dhe kërkoi shefin operativ:

- Jam në Lug të Zi. Dërgo nesër në mëngjes një oficer për shërbim këtu. Këtij oficerit do i jap pesë ditë leje.

Pesë ditë, pesë ditë ... dhe përsëri ..., më rrotullohej në tru çfarë dëgjova dhe gati sa nuk plaste zemra nga tërbimi. Dy ditë rrugë dhe tre ditë në familje. Pesë ditë pas gjashtë muajsh shërbimi. Po, po, vetëm pesë ditë dhe dy lot më rrodhën poshtë deri në mjekër. Dolën lot që të mos dilte zemra vendit, të mos plaste truri dhe të mos lija nam në Lug të Zi, e Lugu të mos bëhej më zi se ishte, të mos zezohet fare.

Dola me të shpejtë jashtë dhe fshiva lotin. Fshiva mllefin dhe inatin e grumbulluar dhe u ktheva te komisari. U ktheva të jap llogari për gjashtë muaj shërbim, për gjashtë muaj vetmi këtu në Lug të Zi, në “Lugjet” që më lanë mua dhe shokët e mi pa rini.

Shënim:

Këtë tregim ia dedikova me shpirt e ndjenjë shokut tonë të ndjerë e të mirë, Beqir. Atij që dha aq shumë e mori aq pak nga ushtria dhe nga kjo jetë. Atij që kur u largua iu dhimbs edhe gurit e drurit. Në paqe shoku ynë.

## FOTOGRAFIA MBI TELEVIZOR

Makina “Zis” ecte si buall i plagosur përpara dhe mernte kodrat përpjetë duke përshkruar luginat e pasosura. Rruga ishte e pashtruar dhe ajo linte një re stërmadhe pluhuri nga prapa, sa kur era frynte nga jugu, një pjesë e pluhurit kthehej dhe na përvishej edhe ne mbi karroceri. Dy shefat më të moshuar dhe me funksion ishin përpara në kabinë. Ne të “vegjlit” mjafton të shkonim, pastaj se si nuk ishte e rëndësishme.

Kishte kaluar mëngjesi i vonë dhe po i afroheshim drekës. Dielli kishte filluar të ngrihej lart kodrave të zhveshura, ose dukej e zhdukej pas ahishtave të rralla që i kishin shpëtuar sharrës vrastare. Moti ishte i ngrohtë, por kishim marrë xhupat e ishim ulur në to, mbi dërrasën e ngushtë të stolit të makinës operative. Kur hynte dielli, moti ftohej dhe bëhej një vjeshtë e vërtetë. Po të binte shi ngjante me një fillim dimri, megjithëse sapo kishte hyrë shtatori. Ajri ishte i pastër dhe mushkëritë të mbusheshin plot dhe ndjeje se në trup je më i lehtë dhe ecën më shkathët. Në kodrat e zhveshura vije re bagëti të shpërndara në tufa të vogla dhe grupe të rinjsh, dy e nga tre, të cilët qëndronin të përkulur e mblidhnin me shumë vullnet boronicat e fundme, të tejppjekura e të shijshme.

Mes luginave, që formoheshin nga kodra të rrumbullakosura, rridhte një ujë i ftohtë e qelibar. Ai ta mpinte dorën e ta treste në moment ushqimin. Çdo gjë që të zinte syri të dukej e bukur, parajsë, por me gjithë këto perla, përsëri ne mezi prisnim të mbaronim kontrollin e të

iknim. Të iknim akoma pa mbërritur. Mbi të gjitha ishte vetmia, ishte jeta monotone larg jetës urbane, larg asaj me të cilën ishim mësuar.

Arritëm në postën kufitare Kazan. Ishte e treta herë që ne i merrnim dhe i dorëzonim postat kufitare me Degën e Rendit. Asnjëherë këto nuk kanë qenë struktura të ushtrisë, por vareshin nga kufiri dhe ishin të vendosura zakonisht para kompanive tona mitraljere. Edhe kjo postë ishte vendosur para kompanisë së përparuar mitraljere Kazan, kompani e batalionit Turaj. Ishte e vendosur në një pozicion shumë të mirë strategjik, ku as veriu nuk e rrihte dhe nuk ishte direkt nën vëzhgimin e forcave serbe përballë. Ishte pak më e tërhequr se arma roje, e cila ishte në vijë të parë të kufirit. Ndërtesa ishte njëkatësh dhe e pa mirëmbajtur. E kompletuar me xhama ishte vetëm zyra e komandantit, kurse fjetorja, mensa dhe klasa e ushtarëve, më shumë kishin plastmase në dritare se sa xhama. Kjo nuk na bëri përshtypje sepse riparimet kryheshin gjithmonë me afrimin e vjeshtës. Atëherë bëheshin dhe furnizimet dimërore.

Arturi ishte komandanti e ai do të na shoqëronte deri në fund të kontrollit. Nënoficerët zhdukeshin dhe na prisnin para depove, nëse lindte nevoja për kontroll apo verifikim. Ai priu së pari dhe na ftoi të uleshim në ato pak karrige e stola që kishte në zyrën e tij të pakompletuar. U ul i ndrojtur brinjas në anë të tavolinës që të zinte vend sa më pak dhe vuri përpara dokumentacionin që mund t'i kërkohej. Shefi operativ u vendos në krye përballë derës dhe hapi krahët sikur do tregonte se sa të jem këtu, jam unë.

Takimi filloi me gjendjen e gatishmërisë, të efektivit, stërvitjes, shërbimit, bashkëveprimit me batalionin artmitraljer, edukimin e ushtarëve, gjendjen shëndetësore të efektivave, furnizimin dhe nevojat. Këtu nuk përfshihej fare komandanti apo kuadrot e tjerë, hallet dhe problemet e tyre njerëzore, familjare, shëndetësore apo thjesht jetike. Komandanti ishte një djalë i ri dhe kishte shumë ëndrra, ndoshta në ditar, por vetëm aty. Mjafton që ai të ishte në repart dhe gjithçka ishte vaj.

Gjatë raportimit të komandantit, shefi operativ e ndërpreu:

- Çfarë është ajo fotografia mbi televizor?

Komandanti nuk u përgjigj. Me shumë zell u ngrit nga karrigia, e mori foton e artistes, të shkëputur nga revista, me gjoks pak të zbuluar dhe e vendosi përsëri mbi televizor, por tani të përmbysur e me foto nga poshtë. Pa u ndjerë vazhdoi raportimin, duke mos i dhënë shkak shefit të devijonte procesin dhe të merrej me fotografinë. Të gjithë mbetëm të mpirë, por veprimi i qetë dhe dinjitoz i komandantit na shtoi respektin për atë dhe figurën morale të këtij djali të ri.

Vazhduam inspektimin dhe nga e vona u ulëm të shkruajmë përfundimet me konkluzione dhe detyra që do të mbeteshin për zbatim në repart. Gjatë përpilimit të aktit, në mungesë të Komandantit të Postës, e diskutuam me shefin operativ veprimin e tij me foton mbi televizor.

- Ne kemi ardhur këtu në repart të ngopur dhe të plotësuar, si nga pikëpamja familjare, fiziologjike dhe shoqërore. Vijmë nga një jetë urbane me të gjitha nevojat

që të lejon jeta në qytet dhe puna në shtabe. Takojmë çdo ditë miq, shokë dhe farefis dhe i kemi në mbikëqyrje fëmijët e përpiqemi t'i edukojmë me praninë tonë në familje. Kemi prindërit që i vizitojmë sa herë të duam dhe bëjmë atë jetë që na e mundëson privimi i detyrës ushtarake, por ama komandanti Artur atë vajzën në foto, të shkëputur nga revista, e ka motër, shoqe, të dashur, kolege, ëndrrën e nuses së ardhshme. Ai ka vetëm atë dhe ushtarët. Nuk ka prindërit, familjen, miqtë, shokët moshatarët këtu. Nuk ka ku t'i zgjojë ëndrrat e fjetura. Nuk mund të dal prapa malit e nuk mund t'i shmanget postit luftarak. Ai është brenda “vijës së verdhë”, brenda asaj vije ku duhet të kaloj ditën, natën, javën, muajin e ndoshta vitin.

- Është i ri, – u përgjigj menjëherë shefi, – të gjithë kemi qenë të rinj.

- Vërtet që është i ri. Vërtet që edhe ne kemi vuajtur e mbetur pa rini, po kjo nuk do të thotë që edhe Arturin ta përfshijë izolimi si në guaskë, vetmia si shoqëruese e inercisë të karrierës së sapofilluar. Vuajtjet nuk duhet t'i përcjellim në kurriz të njëri tjetrit, por tjetrin ta lehtësojmë sa më shumë, se edhe detyrën do ta kryej më mirë.

Mbaruam kontrollin, hodhëm përfundimet dhe pasi i konsultuam me komandantin u ngritëm të largoheshim. Dolëm në korridor, por shefi u kthye. Menduam se ka harruar diçka. U afrua te televizori, mori foton, a pa me vëmendje, i fshiu pak pluhurin te cepi dhe e vendosi pjerrtas në pozicionin ku kishte qenë. Nuk folëm fare se kishim folur shumë. Tani po vepronte shefi.

Makina ulërinte duke marrë maloret në rrugën e pashtruar dhe me shumë gropa. Ajo po linte re pluhuri prapa. Po linte edhe komandantin. Po e linte së bashku me foton e tij, e cila nuk mund t'ia shuante atë vetmi të madhe që e kishte kapluar. Isha i sigurve se ai po ndiqte me vështrim makinën që largohej, po aq sa isha i sigurve që në syrin e tij kishte një pikë loti e përzier me maraz, inat dhe sharje për fatin e tij, për fatin që e kishte sjellë aty që edhe kur vinin ta kontrollonin, nuk vinin ta inkurajonin, nuk vinin re prezencën e tij si njeri me hallet dhe nevojat imediate. Vinin ta verifikonin si numër. Mbylla sytë me pëllëmbë dhe mendova ditën kur do “liruhej” nga lartësitë Arturi, ditë kur do të “skllavërohej” një Artur tjetër e për të gjithë Arturët urova kuraje, durim, vullnet dhe shpresë e vetëm shpresë.



## **AVNIU PA RINI**

Edhe 100 metra zbritje dhe po arrija te kryqëzimi i “Bërrylit”. Drekë e vapë përvëluese korriku. Asgjë nuk kisha në mendje, vetëm të ndjek hijet dhe të shpëtoj nga dielli që po më jepte goditje në kokë. Tirana më lodhte shumë. Kapele nuk mbaja. Kisha mbajtur 30 vjet kapelën ushtarake, sa edhe sot kur qethem më ka mbetur shenja e rrethit të kapelës në flokë. Edhe unë si shumë të tjerë, vazhdojmë të kujdesemi më shumë për këmbët se sa për kokën. Duke shoqëruar me hapa hijet, në mendje më kaloi kënga shkodrane “Mbeta gjithë ditën hijeve”, këngë që në rininë time hapte emisionin radiofonik “Muzikë popullore sipas kërkesave”. Më pëlqente shumë, sa fillova t’a imitoj me fishkëllimë Eduard Jubanin, por ...

– Adem, – më ndërpreu lëvizjet dhe mendimet një zë i trashur.

Ndalem dhe dalloj që kisha kaluar pa vënë re një burrë moshatar, me mustaqe dhe të ulur në stol prapa një tavoline mbushur me cigare, duhan të grirë dhe pak kancelari. Duke rrotulluar makinën e dredhjes së cigares, përfundoi procesin dhe kur unë u afrova afër tij, me buzën në gaz, më drejtoi cigaren e sapo dredhur.

- Të faleminderit, nuk e pi. Dua të jetoj gjatë – i them me të qeshur dhe prezantohem me shpresë se edhe ai do më prezantohej dhe do më shpëtonte nga sikleti i memories së dobët.

- Kush jam unë? - më dha direkt goditjen.
- Sa gaboj, më mirë ma thuaj vetë.

- Avniu jam. Të kujtohem tani?!

Menjëherë filmi filloi xhirimin mbrapsht e më dolën para gjithë sekuencat e Avniut në shkollë, në Pukë, në Has, Bajram Curri e tani Avniu këtu para meje e prapa tezgës së cigareve. Avniu me një strukturë të formuar si ushtarak, oficer i zoti dhe shumë aktiv në stërvitje, Avniu i kudo gjendur, Avniu që zinte vrimat e reparteve ku kishte nevojë për oficerë të aftë dhe të përgatitur. Gjithmonë flitet për repartet e lartësive, repartet e vetmuara dhe të harruara.

Avniu ishte nga Shqipëria e Mesme, por aty vetëm lindi dhe u formësua si fëmijë. 14 vjeç veshi pantallonat pa xhepa dhe u shtrëngua fort rripash e kaloi në veri të Shqipërisë. Tani ishte bërë burrë, pa qenë asnjëherë i ri. Ai nuk pati rini, ose më mirë pati për aq pak kohë sa nuk e pa, dhe kur deshi ta shijonte e humbi maleve të Veriut.

- Nuk më vjen keq që jam pa rini, – flet ai me shumë mall – se kam jetuar mes njerëzve të mirë që më kanë konsideruar vëlla, shok e më kanë ndihmuar. Më kanë qëndruar afër dhe në gjithë Veriun kam shumë shokë, miq e dashamirë. Jam shumë i plotësuar që është Facebook-u. Ja edhe ty nga ai të kam ndjekur kur shkruan. Të kam parë në foto dhe të njoha menjëherë. Aty shoh dhe komunikoj edhe me shokët e tjerë, megjithëse shumë nga shokët tanë sot janë të vendosur në Tiranë. Dikush nuk jeton, si Beqiri ynë.

Ai përmend me radhë dhe me mall shokët e përbashkët dhe tregon ndonjë episod të shkurtër nga jeta ushtarake.

- Më mbetet një merak! Sapo mbusha të pesëdhjetat,

sapo u formësova si oficer karriere dhe atëherë kur familja kishte më shumë nevojë për mua, më thanë se do dal në rezervë. Unë që isha pa rini, tani jam edhe pa punë, pa shtëpi, pa pasuri e katandi! Po të kishin mundësi do më linin edhe pa pleqëri, por jo! Ajo nuk u duhet atyre e më ka ngecur mua. Kur fillova karrierën isha vetëm “shpirti dhe rripi”, kurse tani edhe “shpirti” është harruar dhe duhet të mbaj familjen me fëmijën e sëmurë. Duhet t’i mbaj se janë të mitë e shteti nuk më është bërë krah asnjëherë. Jam i harruar. Kam shitur gjithçka dhe kam blerë këtu në Tiranë një dhomë e kuzhinë. Tokën që kishim na e kanë shpërndarë me ligjin 7501, se unë asokohe nuk isha banorë i atyshëm, isha banor në repartet e Hasit e Tropojës.

- Po këtu në rrugë kur ke dalë?
- Kam dy vjet që dal këtu çdo ditë. Njerëzit më njohin tani dhe shumëkush ndalon. Kam mësuar të qesh dhe të sillem mirë me klientët. E di që shes helm, por mua nuk më bën dëm, se kam pirë helm më të fortë. Uroj për njerëzit që blejnë duhan të jetë ky helmi më i fortë e të mos kenë telashe të tjera. Por ky është vetëm urim. Realiteti është tjetër. Fitoj pak, lodhem shumë, por më duket vetja kot. Tani jam mësuar edhe me kotësinë dhe ajo më bën shoqëri gjithë ditën. Jam si ventilatori në vakum. Sillem, sillem po ajër të lëviz nuk kam. Dua punë, dua të punoj se dua lek, dua lek për ata që më presin çdo drekë e darkë, për ata që i kam bërë vetë dhe presin vetëm nga unë. E kush kërkon lek? Unë oficeri, që i veshur me çizme çillota, me trup sportisti, lustruar e kapardisur, tërhiqja vëmendjen e kalimtarëve në qytetet e Veriut. Falë paraqitjes sime, tek

ndonjë i ri ka lindur pasioni e ka vazhduar edhe shkollën ushtarake.

Koha po kalonte dhe unë duhej të merrja unazën për tek stacioni autobusit të Kukësit. Duke u përshëndetur me Avniun, ai me shumë përzemërsi më tha:

- Çfarë të të jap unë?

Unë mora një paketë cigare e një çakmak, i dhashë lekët për mallin e blerë duke i thënë:

- Ti tani do më japësh dorën, se unë jam për Kukës.

Të uroj mbarësi dhe të gjitha të mirat. Shëndet për ju dhe familjen tënde të dashur.

U ndamë me mall e unë dallova në syrin e djathtë një të lagur të lehtë. Ai nuk u prek se unë mora një paketë duhan edhe pa e pirë cigaren, por nga inati se ku ka mbërritur, nga inati që ka pasur shumë ëndrra, mendime e shpresa për jetën, e tani të gjitha janë rrëzuar, rrëzuar për të mos u ngritur kurrë, rrëzuar e rënë buzë atij trotuari në atë tezgë të shtrembër të vendosur në katër tulla të kuqe.

Vazhdova të zbres në drejtim të stacionit, por më dukej vetja shumë i ngarkuar, i ngarkuar jo vetëm nga hieja e Aniot, por nga hallet e tij dhe të shumë “Avnive”, oficerë të dalë në rezervë e lirim. Unë largohem e largohem, por një pjesë e imja ngeli aty, aty si kujtim i jetës ushtarake, asaj jete që i kishim kushtuar gjithçka, e si shpërblim Avniu doli prapa tezgës e unë prapa banakut. Si ne ka shumë nëpër Shqipëri.

## **KONSERVA E BATALIONIT**

Pandi ishte oficer aktiv me një pesëvjeçar para meje. Ishin katër pesë të tillë e mua më dukeshin më të afërt se të tjerët. Kur shkruaj të tjerët, kam parasysh ata që ishim titulluar mbi një dekadë më parë oficer aktiv dhe qëndronin me ne të rinjtë më larg dhe më me autoritet. Këta të dytë ishin gati të na dërgonin për t'u mbushur ujë ose për t'u blerë cigare.

Ai ndryshonte shumë edhe nga shokët e tij. Jo se ishte topograf dhe profesioni i tij ngjante me atë të jetës civile, por ishte ndër më të ndrojturit, më të ndershmit, më të urtit dhe më i drejti mes tyre, pa qenë asnjëherë më naivi. Edhe kur i drejtohej ndonjë ushtari aktiv, të cilit në të shumtën e rasteve i drejtoheshim në formë urdhri, ai i drejtohej me shumë kulturë dhe lutje, a thua ushtari do të bënte punën e tij e jo të shërbimit ushtarak.

Oficerët topograf punën më të madhe e bënin në terren. Ata kishin edhe një mundësi, pasi punonin më të pavarur dhe në grup. Punën nuk mund ta bënin të vetëm, kështu që merrnin me vete dy ose tre ushtarë, të cilët ose e kishin kualifikimin si topograf, ose Pandi me përvojën e tij i bënte të tillë.

Më shpesh ai merrte me vete Safetin, ushtar i shërbimit të detyrueshëm, i cili pas shkollës së mesme të përgjithshme kishte kryer një vit kurs specializimi si topograf.

Në mëngjes i vërenim të dy kur nga zyra e topografisë sistemonin materialet, si këmbalecët

trekëndësh, instrumentet, latat e shkallëzuara, hartat dhe blloqet e shënimeve. Pasi kompletoheshin për punë, prisnin makinën operative, e cila nuk vononte, veçanërisht për Pandin korrekt, të pa bezdisshëm e aspak abuzues.

Atë ditë dreka i zuri në fushën e Qinamakës. Ishte një mot i paqëndrueshëm. Sa dilte dielli, trupi fillonte të ngrohej e toka të nxirrte pak avuj të vakët. Menjëherë një re e stërmadhe i dilte diellit përpara e në trup fillonin mornicat e të dridhurat që të pushtonin nga këmbët te kraharori.

Në fund të luginës, aty ku era dhe veriu nuk të zinte, ishte vendosur në fushim për stërvitje me trupa batalioni i këmbësorisë Surroj. Të zinte syri vargun e gjatë të rreshtuar drejt të çadrave të rezervistëve, të formuara me nga tre fletë çadre personale dhe më tej çadrat e komandës, depot dhe kuzhina, ku në kohë dreke lëvizja ishte më e dukshme.

Pandi takoi shefin e logjistikës, bisedoi me atë dhe i tha ushtar Safetit se drekën do ta hanin në fushim së bashku me batalionin rezervistë.

Safeti u ngrit të lante duart. U vonua pak dhe kur erdhi mori pelerinën e Pandit, i cili ishte larguar të lahej, futi diçka nën të dhe u ul të priste rezervistin që do t'u sillte ushqimin. Safeti ishte shumë i shkathët dhe nga natyra bënte edhe humor me të gjithë ata që njihte. Ai rridhte nga një familje me fis të zgjeruar dhe ishin "shtëpi pushke". Nga ushtarët vinte pak më i rritur në moshë dhe në trup. Shërbimin ushtarak e kishte filluar me vonesë për shkak të arsimimit të vonë. Para ushtrisë kishte punuar në ndërmarrje ekonomike dhe dinte të lidhte marrëdhëniet shoqërore me të tjetër. Edhe me Pandin e kalonte mirë. I

shkonte sipas dëshirës e mundohej të ishte korrekt, t'i kryente ndonjë punë ku kërkohet shkathtësi e njohje dhe nuk bënte veprime të tepruara në dijeninë e tij. Në marrëdhënie me atë mundohej të ishte i matur dhe i përpiktë. Kjo ishte mënyra më rezultative.

Erdhi Pandi dhe u ul në bar mbi një gazetë që kishte shtruar Safeti. Gazeta tjetër ishte përpara dhe shërbente si shtrojë buke. Dielli u zu nga një re e ngarkuar ngjyrë hiri e dukej që shiu nuk ishte larg. Pandi afroi pranë vetes pelerinën, që ta kishte gati për çdo rast. Por ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte. Nga pelerina u rrokullis kutia 800 gramshe e konservës së derrit dhe u ndalua të gropa më e afërt.

- Çfarë është kjo Safet? – pyeti Pandi i nervozuar.
- Nuk hahet supa nga kazani 300 racionesh shef. E mora ta konsumojmë bashkë, pasi jemi edhe pa mëngjes.

Pandi nuk ktheu përgjigje. Mori konservën dhe u drejtua nga kuzhina. Kërkoj magazinierin. I dha konservën duke i thënë:

- Merre dhe fute në kazan të supës. Le të hanë të gjithë rezervistët nga kjo konservë.

Magazinieri e mori. Qëndroi i ngrirë me konservën që i mbeti në dorë. Shikonte shefin e topografisë që largohej i lehtësuar e me merak të hequr se nuk kishte përfituar asgjë të tepërt edhe në atë mori rezervistësh ku kishte të hante e të abuzonte jo Pandi, por me dhjetëra e dhjetëra të tjerë. Shoqëronte me sy e mendonte me vete se “... akoma ka njerëz të tillë. Ka, por janë pak dhe të padukshëm në xhunglën e kësaj babëzie”.

## ZHDËMTIMI KONSERVËS

Nënoficer Rrahimi e kishte shumë merak të kryente inventarë dhe kontrole teknike në atë repart, veçanërisht në vjeshtë. Reparti shtrihej buzë një lumi të vogël. Terreni ku shtrihej ai ishte i freskët edhe në verë. Bari ishte i njomë dhe i pashkelur, ku mund të uleshe pa merak dhe më kryesorja, ata bënë dhe pinin raki, pavarësisht se e bënë të butë. Rakinë që pëlqente më shumë ishte ajo e thanës dhe për meze dëshironte dhjamë derri, të prerë në kuadrate, të skuqur dhe të shoqëruar me djathë të ri apo me turshi. Këto po mendonte kur shefi bëri planin e inventarizimit dhe lexoi se emri i tij ishte pikërisht në atë repart ku i kishte thënë edhe shefit. Armatimi kishte shumë artikuj dhe në sasi të mëdha, kështu që edhe inventari do zgjaste disa ditë. Kështu edhe do të çlodhej edhe do hiqte merakun e pijes. Nuk do të kishte nevojën të priste Samiun në mëngjes sa të rripte ndonjë gotë prej tij.

Ishte paradite kur arriti në repart. Roja i hapi derën duke e nderuar me dorën e djathtë, ndërkohë që pushkën e mbante në të majtën. Ai e shikoi me vëmendje e desh t'i tërhiqte vëmendjen për nderimin, por zgjodhi të sillej butë. “Qengji urtë pi dy nëna”, megjithëse më shumë kujdesej që të mos të ishte qengj, pasi nganjëherë “Qengjit të urtë i ... nëna” – thoshte shef Habibi.

Me çantën e mbushur me fletë inventari, shtrënguar nën sqetull sikur dikush do t'ia hiqte nga dora, eci rëndë rëndë mes repartit dhe u drejtua nga zyra e komandantit. Oficeri i rojës e ndoqi nga pas e ai bënte sikur nuk po e vinte



re. Edhe pse ishte nënoficer, donte medoemos të kishte autoritetin e një oficeri të shtabit.

Dita e tretë e inventarizimit po kalonte duke verifikuar arkat e municioneve. Magazinieri, në mënyrë që të shpëtonte nga lëvizja e të gjitha arkave nga vendi po e merrte Rrahimin me të mirë. Në fakt edhe komandanti i kishte thënë të sillej mirë me të. E kishte porositur që në asnjë rast të mos i krijonte domosdoshmëri për të shkuar te lokali sipër repartit për të ngrënë. Atje mund të shkonte vetëm për ndonjë kafe ekspres e një gotë raki, por edhe këto të porosiste lokalin që i kishte të paguara. Po plotësonin fletët e inventarit e ushtari që kishin marrë për të lëvizur ngarkesat, në vend që të rrinte kot, po thyente disa arra dhe i linte mbi një kapak arke. Ai i kishte rreshtuar copat e qëruara në kolonë për tre në dërrasë e ato tani kishin arritur sasinë e ushtarëve të një toge. Rrahimi e pa me inat ushtarin, mori thelbin më të madh dhe me dorën e majtë i përzjeu duke i bërë grumbull. Dukej se po i thoshte dhe ushtarit se të bëj kështu grumbull edhe ty.

Ditën e gjashtë përfundoi inventarin më herët. Atë ditë duhet të kishte më shumë kohë për të shijuar natyrën, pijet dhe ushqimin. Kishin biseduar me një shofer të linjës që pasdite t'i ruante një vend për kthim.

Kur roja në postbllok njoftoi se makina erdhi, ai u ngrit, fërkoji barkun e kërcyer me dorë sikur donte të rrafshonte të ngrënat dhe me çantën e fletët e inventarëve të plotësuar në dorën e djathtë, u dha me mospërfillje atyre që e përcillnin dorën e majtë. Nga prapa e ndiqte një roje e repartit me dy çanta shpine ushtari, të cilat

megjithëse do i merrte me vete, nuk e dinte se çfarë i kishin futur brenda.

Ditë e re pune në shtab. Shtyu derën dhe me përtesë i tregoi rojës fletëhyrjen. Duke futur atë në xhep gishtat i takuan lekët e futur thellë. “Sot do i paguaj unë kafen Samiut. Kam ditë që nuk kam harxhuar asnjë lek” dhe me këto mendime u fut në zyrë. Shefi nuk kishte ardhur akoma. Zyra ishte rrëmujë dhe bishtat e cigareve ishin derdhur nga tavlla në tavolinë. Mori me shpejtësi leckën. Fshiu tavolinën dhe me fshesë po mblidhte mbeturinat e rëna përtokë. Kur erdhi shefi ai po dilte jashtë të derdhte arkën e kartonit të mbushur plot. Lëshoi arkën, nderoi shefin dhe u bë gati të raportonte. “Më vonë, bisedojmë pas komunikatës” – i tha shefi me mospërfillje.

Dita kaloi duke hedhur gjendjen në librin e llogarisë. Për fat të keq shefi nuk po largohej atë ditë dhe kështu i kërrusur mbi letra filloi të ndjente dhimbjen e shpinës. Mori një shishe uji dhe doli ta mbushte. Në fund të korridorit pa komisarin, i cili po shkonte në zyrë. La shishen e ujit, priti sa komisari të rehatohej dhe me të shpejt trokiti në derën e tij. Nga emocionet dhe trokitja i dukej e vogël, por kishte frikë ta përsëriste. U fut brenda dhe u ul në vendin që i tregoi me dorë komisari, duke e shoqëruar me fjalët:

- Çfarë kishe?
- Kam qenë për inventar në repartin “N”.
- E pastaj!
- Erdha të raportoj se atje kishte shumë shpërdorime.

Kam qëndruar plot një javë dhe çdo ditë më kanë dhënë nga një kuti konserve nga ato të rezervës.

- Dhe ti e ke ngrënë?
- Po. Ata ma vinin përpara.

Komisari rrudhi fytyrën. Nuk kuptohej, po qeshte, po zgërdhihej pa zë apo po hakërrehej. Zgjati dorën dhe tërhoqi dorezën e telefonit. Me gishtin tregues bëri gjysmë rrotullimi të saj e menjëherë u dëgjua zëri i centralistit:

- Urdhëro shoku komisar!
- Shefi i prapavijës të vijë menjëherë në zyrën time.

Akoma pa hyrë mirë shefi në zyrë, komisar i drejtua duke gëritur Rrahimin në këmbë:

- Ky nënoficeri ka qenë për inventarë në repartin “N”.

Ka ngrënë atje shtatë konserva. T’i vihen në ngarkim së bashku me nënoficerin e repartit. Financa t’i anuloi urdhërshërbimin këtij dhe komandantit të repartit t’i tërhoqet vëmendja.

Si tha këto, mori një libër nga tavolina e kërkoi diçka nëpër faqe të tij. Shefi e kuptoi se kishin mbaruar dhe tërhoqi pas vetes Rrahimin deri në mesin e korridorit.

Rrahimi ngeli pa lëvizur aty ku e lëshoi shefi. Duke sikur dikush e kishte kapur nga këmbët dhe e mbante të lidhur. Hodhi sytë nga fundi korridorit dhe iu duk shumë i gjatë, i gjatë pambarim, sa rruga deri te reparti “N”.

## REPORTAZHI

Ishte viti i katër apo i pestë që gëzonim demokracinë. Lufta politike ishte shumë e ashpër, veçanërisht në jetën civile. Ato përballeshin me nenin 24/1, kurse ne përballeshim me heshtjen e përluljen. Rrallëkush fliste apo ngrinte zërin në shtab. Të gjithë ulnim kokën dhe bënim punën ashtu si na thonin. Kur ndonjë koleg e largonin se pse “tund” gazetën “Zëri i Popullit” në korridore”, ne vetëm vëzhgonim. Ishim si ata delet që marrin pjesë në therjen e shoqeve të tyre. Ndoshta dhe ato nuk protestonin, por të paktën blegërinin.

Në repart vinin një mori gazetash, së bashku me ato me karakter ushtarak. Në përgjithësi ato shkruanin artikuj për veprimtarinë e qeverisë dhe i bënë elozhe asaj. Elozhe në shtyp është bërë gjithmonë, por kur në gazetën “Luftëtari” numëruam 17 foto të Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, kjo kalonte masën.

Për ne nuk ishte shqetësim numri i gazetave e sasia e tyre. Shqetësim ishte për korrierin që mbante peshë të rëndë deri në repart. Ne kalonim kohën, pasi pjesa më e madhe e gazetave përmbanin nga dy deri në tre fjalëkryqe.

Artani ishte kolegu ynë dhe merrej me problemet e rinisë, shtypit, marrëdhënieve me publikun dhe medien. Detyra e tij ishte të pasqyronte të dhënat e njësisë në komunikata dhe shtypin periodik. Për këtë i duhej të lëvizte në reparte dhe të përshkruante me entuziazëm arritjet dhe treguesit pozitivë të tyre.

Makina e ekspeditës po bëhej gati të nisej sapo shoferi të merrte fletëudhëtimin. Do të shkoja me shërbim në repartet e Hasit. Me këtë rast do dërgonim dhe furnizimet e do të bënim kontrollin teknik. Artani ishte aty pranë dhe shprehu dëshirën të vinte dhe ai për punët e tij. Për ne prania e tij nuk sillte asnjë shqetësim.

Sapo arritëm në Krumë dhe ishim duke udhëtuar në rrugët e ngushta dhe të pashtruara të qytetit, Artani kërkoi të ndalonim. U zuri emrin dy oficerëve të rinj që po kalonin dhe zbriti.

- Unë po filloj punën. Takohemi në orën 12.00 në shtab.

Reparti i fundit që do kontrollonim ishte reparti artilerisë Golaj. Pasi lamë aktin me detyrat sipas planit të kontrollit, na ftuan për kafe tek lokali i fshatit. Në lokal ishin dhe dy oficerë të tjerë që ne nuk i njihnim, por të gjithë ushtarakët zumë vend së bashku dhe pimë kafen ushtarakisht. Gjatë kafes Artani pyet njërin nga oficerët e rinj:

- Ku je me shërbim se nuk të kam parë asnjëherë.
- Unë jam në Flutur, në Grupin e AKA-në në Fierzë, por kam ardhur të takoj këtë shokun tim e të kalojmë një ditë bashkë.
- Në Flutur! Po më shpëtove. Hajde të bëjmë bashkë një bisedë.

Nxori bllokun. I futi krahun oficerit. Ndërroi tavolinë dhe filloi pyetjet si në hetuesi me oficerin e sapo takuar. Ai i ndrojtur përgjigjej duke mos e ndarë shikimin nga blloku dhe nga ne. Mbarimi i kafes ishte dhe shpëtimi i oficerit nga

kthetrat e Artanit, që u nda shumë i kënaqur, jo se mori informacion nga oficeri, por se kurseu një ditë rrugë deri në Fierzë, të cilën do ta shënonte kur të dëshironte ai.

Kishte kaluar një javë dhe Artani tundte gazetën “Ushtria” dhe lexonte me zë të lartë reportazhin: “Në Flutur mes fluturave”.

“Era fryn furishëm dhe gjethet e pemëve shkëputen nga degët mëmë, enden në ajër si flutura dhe i vishen malit të gjelbëruar. Duke parë gjethet që bëjnë harkore në ajër dhe ngjajnë si flutura, edhe emri i kësaj kodrine ka marrë sinonimin e saj. Quhet “Flutur”. Flutura është reparti që mbron hapësirën ajrore të veprës më të madhe energjetike, hidrocentralit të Fierzës. Aty stërviten si luanë ushtarët tanë dhe grykat e zjarrit mbulojnë nga të katër anët horizontet, nga mund të shfaqet ndonjë avion armik.

Së shpejti ushtarët dhe oficerët kanë qitje luftarake në Tale, Lezhë, dhe në qitjet mësimore kanë njohur vetëm notën 10, notë që me siguri do ta marrin dhe në qitjet luftarake.

.....”

Artani ishte shumë i gëzuar dhe krenar. “Krenar” edhe me ne që ishim me atë kur mori informacionin, krenar me trillet që shkruan dhe me imagjinatën e tij të përsosur. Por ne nuk mërzitemi. Marrim gazetën dhe e shfletojmë, e shfletojmë sa arrimë deri te fjalëkryqi e aty ndalojmë. Është e vetmja faqe që na bën të ndalemi, të mendojmë e nganjëherë edhe të diskutojmë për ndonjë fjalë, kombinim apo shprehje.

## KOMISARI

Komisari ishte një kuadër që nuk mund ta vlerësoje nga një këndvështrim. Ishte babaxhan, i sertë, i afrueshëm, i rreptë, i dashur. I diferenconte njerëzit, por dhe i afronte pranë vetes të gjithë ata që i duheshin dhe ishin korrekt. Vetëm se krahët i kishte më “të gjatë” se të tjerët. Në fakt krahët e tij mund të krahasoheshin më të komandantit, se kur krahasohej me ne, mjaftonte një gisht cilido i tij. Krahët, kur themi krahët, kuptojmë sa autoritet hierarkik, moral e material, sa influencë zotëronte ai në hapësirën ushtarake që mbulonte njësia jonë.

Ai ishte jo vetëm i gjithëpushtetshëm, pasi shumë kompetenca kishte lëshuar vetë komandanti, por ishte edhe veshi, syri dhe detektori i të gjithë njësisë. Ishte i vetmi që ua kalonte të gjitha radiove që kisha në ndërlidhje. Diapazoni i valëve të tij ishte shumë i gjerë dhe brezi i frekuencave aq i madh sa kur e takoja isha shumë i dyshimtë se çfarë dinte e mendonte ai në atë moment për mua. Vetëm lusja zotin që informacioni që ai kishte të ishte i padeformuar.

Një ditë shkon në repartin e mbrojtjes kundërajrore. Urdhëron komandantin të rreshtojë ushtarët dhe të ishin të pranishëm të gjithë kuadrot. Vetë ai thërret emrat e tre ushtarëve. I nxjerr para rreshtit dhe i urdhëron të ulin pantallonat në fund të këmbëve. Kuadrot u habitën me këtë komandë, kurse ushtarët hezitonin deri në mosbindje. Skuqeshin e zverdheshin. Ata nuk kishin veshur mbathje.

Kishin bërë banjë dhe kujdestari kishte pasur tre palë mbathje mangut e për pak kohë i kishte lënë ushtarët ashtu.

Ky ishte komisari im. Edhe këtë e kishte mësuar.

Ai ishte shumë i aftë, punëtor dhe kishte energji e mendime krijuese me të cilat i habiste të gjithë. Që kur erdhi ai në repart, reparti ishte më i pastër, më i gjelbër, më i sistemuar dhe më i këndshëm. Më keq ndër të gjithë e kishin punëtorët e investimeve, të cilët nuk kishin fare pushim. Kur e pa se puna e tyre ishte e pamjaftueshme, atëherë punën e tyre të mangët filluan ta plotësojnë nënoficerët dhe oficerët e shtabit. Secili nga ata mori dijeni edhe mbi normën e dushkut që do të dorëzonin. Reparti mori drejtim blegtoral e bujqësor dhe ai tanimë po quhej tinëzisht “Përgjegjësi i ekonomisë”.

Kur të gjithë mendonin se arriti majat, krahët e tij filluan të shkurtohen e bashkë me ato edhe kompetencat. Fryma e demokracisë ishte suferinë. Ajo mernte përpara gjithçka gjente, përveç atij që fshihej pas ledhi e komisari gjeti ledhin. Ai u fsheh pas emrit. Nuk ishte më “komisar”, por “shëf edukimi”. Ishte më i matur dhe më i përmbajtur, por dhe më parashikues e më i kujdesshëm. Respekti, nderi dhe dinjiteti tij ngeli në po ato parametra. Puna, lodhja dhe këmbëngulja e tij kishin vënë “yndyrën” e reciprocitetit e marrëdhënjeve korrekte me të gjithë kuadrot.

Po bëheshin zgjedhjet e dyta pluraliste. Zgjedhje të parakohshme. Ushtria megjithëse ishte “jashtë politikës” ishte e përfshirë në votime. Ushtarët në tërësi votonin djathtas e kuadrot në tërësi majtas, me përjashtime të rralla.



Komisari u mobilizua. O sot, o kurrë.

Me premtime e forcë, me të butë e të fortë, ai nuk la repart pa shkelur. Duhej të votohej majtas. Nuk duhej të humbiste investimi i tij në gjithë këto vite, ideologjia e partisë dhe vija politike e saj edhe këtë herë duhej të spikatnin. Ato ishin dhe duhet të mbeteshin të lidhura pazgjidhshmërisht me kontributin e tij. Ishin jetike.

Pasi mori premtimin e të gjithë ushtarëve të Grupit Mortajave, mori takim me komisionin e votimit dhe pajisi komisionin me stilolapsa me ngjyrë të kuqe për ushtarët. Në mbyllje të votimeve, kureshtarë dhe me vëmendjen më të madhe ndau fletët e votimit me ngjyrë të kuqe: 12 ushtarë, 12 fletë votimi! 100% për opozitën. 100% kundër.

U duk se Gjallica e zuri poshtë. I verbuar dhe i tërbuar shkoi në repart dhe rreshtoi ushtarët. Mori një hu dhe e ngriti lart. E rrotullonte sa majtas djathtas e sa lart poshtë. Mundohej të godiste, të godiste ushtarët pa ndalur. Huri lëkundej sa në një anë në tjetrën derisa rrethi që përshkonte në ajër filloi të ngushtohej, të ngushtohej sa huri u shkëput nga dora komisarit e u përplas përtokë, duke marrë me vete pluhur dhe gjethe dushku.

Komisari u ul në gjunjë dhe shikonte njëherë duart e skuqura, të gërvishtura e gjysmë të mbyllura dhe njëherë hurin e shtrembër përtokë, atë hu që e përdori për herë të fundit, atë hu që tanimë nuk i hynte më në punë.

Dielli po perëndonte dhe në horizont shquante siluetën e tij në formë rrethi të zjarrtë që sa vinte e venitej. Deshi edhe njëherë të shohë atë perëndim, por shquante vetëm kurrizin e ushtarëve që largoheshin, largoheshin duke lënë prapa vetmi e shkretëtirë.

## SHIKOJ NGA LART

Sapo mbarova të përpjetën ritmi i gjoksit po ndiqte ritmin e mushkërive në lojë me oksigjenin. Mezi prita të ulesha në rrasën prej guri gri, me damarë të bardhë, që dilte anës rrugës si stol portativ. Shikimi kishte mbërthyer renë e bardhë. Sa afrohej të merrte formën e zemrës, stërzgjatej e njëra barkushe zhdukej e masa ngatërrohej nga gjitari, te forma e kapelës sime të oficerit.

Kur filluan të më lotojnë sytë, reja e pambuktë mbuloi diellin e dora mbeti e shtrirë tek kapela, që desha të rrasja në kokën e vogël me flokët e paqethura e gjithë dredha.

Unë nuk isha aty kur ato ishin rreshtuar, as kur dhanë komandën apo morën detyrën luftarake, por unë u ndodha kur ato ishin ngritur në kushtrim, po kryenin misionin e ngarkuar dhe vargu i gjatë ishte zgjatur deri në pasosmëri.

Të ngarkuara si mushka dhe rreshtuar nën komandë ecnin bindshëm, me disiplinë dhe me shkathtësi, thua se janë të kurdisur nga një dorë e padukshme dhe motori i tyre nuk ka nevojë për asnjë ndërhyrje, për asnjë lëvizje, që mund ta dëmtoj këtë përsosmëri.

Nuk ka komandë, nuk ka drejtim e nuk ka urdhër, apo i ka të gjitha bashkë dhe unë nuk i shquaj. Po, ndoshta i ka! Por a ka komandant, komisar, shef apo zëvendës të zëvendësve?!

Kapërcejnë një vijë uji. Vargan i pandashëm, ngarkuar mbi kurriz e mbajnë ekuilibrin mbi atë kalim kaq të

hollë, sa thua se do këputet nga ngarkesa dhe nga trupat e tyre të regjura nga stërvitja.

Kolona po afrohet afër meje e unë marr kapelën e më duhet të lëviz. Më duhet të lëviz e të ndërroj dhe rrasën e gurit në të cilin jam ulur e të vazhdoj t'i shoh nga lart, t'i shoh milingonat që po më ngjajnë me ushtarët e mi, me ata që sapo jam ndarë.

I shoh nga lart e mundohem të shquaj komandantin, por më kot. Ata të gjithë janë komandantë, të gjithë janë ushtarë, ushtarë të ushtrisë më demokratike.

## DEMIRI

Mobilizimi i ushtarëve zakonisht bëhej pak ditë pas Vitit të Ri. Nuk e kam vrarë mendjen për arsyen, por mendoja se përfundimi i periudhës 3 – mujore të përgatitjes vetmore të ushtarit përkonte me ardhjen e pranverës, stinës kur fillonte gatishmëria dhe shërbimit i kushtohej një rëndësi më e madhe.

Ushtarët e rinj hiqeshin si naiv, të pafajshëm dhe dukeshin të hutuar. Sapo ishin uniformuar ushtarakisht. Shikonin më shumë veten se njëri tjetrin. Kur kalonin para dritareve nuk linin rast pa parë në xhama shëmbëlltyrën e tyre të mbërthyer me rripin e mesit e kapelën të ngjeshur në kokën e qethur zero. Ecnin grupe grupe e të ndarë sipas shoqërisë së dikurshme, apo asaj të porsakrijuar. Të bindshëm përpara kujtdo, që e mendonin si epror të tyre dhe “garip” para cilido ushtari që qëllonte i urtë dhe i ndrojtur. Me lakmi shikonin ushtarin e vitit të dytë që ecte me gjoksin para, kapelën të ulur pak mbi sy dhe tokëzën e rripit të lirë dhe të lënë pak harkuar përpara.

Me ushtarët e rinj bëheshin edhe punët më të mëdha të repartit. Ishin më të manovrueshëm dhe të bindshëm. Edhe ata që kishin qenë “zevzek” në jetën civile ditët e para i shfrytëzonin si lakmues, si kohë për ambientim apo ndonjë i shkathët për të “gjuajtur” ndonjë komandant. Më shumë i afroheshin oficerëve të rinj, pasi diferenca e vogël në moshë nuk kishte krijuar diferenca të mëdha edhe në karakter.

Demiri ishte një nga këta ushtarë të mobilizuar. Ishte jetim nga babai. Nëna e tij punonte në sektorin e rrugës në afërsi të repartit dhe ai kurrë në sy të ushtarëve nuk shkonte ta takonte. Ishte më i madhi i familjes, shtylla e saj, shtroja dhe mbuloja. Mobilizimi ushtar i kishte krijuar probleme jo vetëm familjare, por më shumë ekonomike. Tanimë mungonte çdo muaj paga e tij, mungonte buka e gojës dhe ai këtë bluante me mend e mundohej që këtë situatë ta harronte me punë e stërvitje.

Të hënën Demiri u fut në repart gati fluturimthi. E pashë nga dritarja e zyrës kur po kthehej nga leja e fundjavës. I bëri rojës në postbllok “qe palla” me dorë dhe u fut brenda. Kur dola më priste në korridor. Më falënderoi duke më thënë se kishte punuar shumë në fundjavë, kishte rregulluar dhe montuar një derë dhe dy dritare dhe me ngurrim, duke i marrë fytyra ngjyrë si në të purpurt, me dorën gjysmë të shtrirë, nxori nga prapa shpinës një ftua. Aty ishte mirënjohja, por dhe kompromentimi, ishte falënderimi, por dhe abuzimi, ishte njerëzorja por dhe mashtrimi. I kapërdiva të gjitha. “E fundit të jetë, Demir!”. E mora, e mbaja me majat e gishtave sikur nuk më përkiste aspak mua. U ktheva dhe në zyrë e ia lashë para Sotirit.

- “Prijeni dhe hajeni me Durimin” dhe i lashë në të tyren, në përgatitjen e planeve metodikë për stërvitjen e ushtarëve të rinj.

Pas borës së rëndë flokëmadhe mëngjesi filloi me një diell të shndritshëm. Ajri i freskët futej në mushkri si kompresor dhe dukej se ato donin vetëm oksigjen. Trupi ishte më i lehtë dhe kur shikoje diellin me retë e stërmëdha,

para syve shfaqej një bardhësi verbuese me nuanca blu në violet. Isha i mbështetur në parvazin e derës së jashtme dhe kundroja ushtarët që kishin dalë nga mensa. Një pjesë fshinin buzët me shpinë të dorës, një pjesë rregullonin rrobat që t’u shkonin pas trupit e ndonjë i paduruar ndizte cigaren. Tanimë ishin miqësuar dhe grupet ishin më të mëdha e më kompakte.

- Demirit i është shembur shtëpia – u afrua pranë meje Faiku, ushtari i vitit të dytë, që dukej se belbëzonte.

- Kush të tha? – e pyeta pa vetëdije.

- Më tregoi babai kur kaloi për të ikur në punë, – u përgjigj ai i pezmatuar.

Ishte pasdita e pestë që punonim së bashku me ushtarët. Demiri bënte murin dhe suvatonte. Kishte zgjedhur dy shokë, ndihmës të mirë. Ushtarët, nëna, vëllai dhe motrat e tij bënin llaçin dhe mbanin gurë e i afronin. Shtëpia ishte njëkatëshe dhe dhoma e miqve nga perëndimi kishte rënë. Pasi hanin drekë, ushtarët kolonë për një e dinin se do shkonim për punë, për të ndihmuar shokun e tyre, Demirin. Ata ishin të kënaqur edhe se dilnin nga reparti, kurse unë isha më i kënaqur se puna po shkonte shumë mirë. Shefi i xhenios më kishte falur dhjetë thasë çimento nga ato të punimeve mbrojtëse, duke më garantuar edhe transportin. Sot ishte ditëpuna e fundit.

Puna dhe dita po shkonin drejt përfundimit. Kisha porositur ushtarët që të mblidhnin veglat e punës e të mos harronim asgjë. Kur po bëja verifikimin e tyre, nga prapa gardhit të shtëpisë dalloj një të ecur të lehtë të motrës së Demirit. Prapa fustanit me pala e me flutura të zeza në

fushë blu, të veshur mbi tuta të kafta, dalloj një bidon të bardhë. Njoha bidonin që na sillte dhallë. Ajo vinte nga shtëpia e kushëririt. Më erdhi keq. Dhalla që kisha pirë para një ore sikur u thartua në stomak, u bë lëmsh dhe u drejtua për nga gryka. Mbylla gojën dhe shtrëngova gjuhën brenda. - Dhallë ... edhe dhalla hua!

Po zbrisnim poshtë drejt repartit. Ushtarët ecnin lirshëm dhe bisedonin me zë të lartë. Njëri foli një fjalë të pamenduar e tjetri e ngacmoi me bërryl. Shikimet u drejtuan nga unë. Tunda kokën që të kuptonin se nuk ka problem, por ... kujdes edhe me njëri tjetrin.

Gjarpëronte dredha dredha mbi borën e bardhë vargu i blertë i ushtarëve. Ngjanin me kecat njomëzakë. Kërcenin e vraponin të gëzuar. Mbillnin gëzim ngado që kalonin e kishin filluar ta mbillnin farën e tij që nga shtëpia e Demirit e deri në folezën e tyre të afërt, ku do të stërviteshin disa muaj, muaj të shkëputur nga rinia e tyre, muaj sa të vështirë por edhe të paharruar.

## FILLROJTËSI

“Ambicia për karrierë është si ai krimbi i drurit. Duhet të kesh bërë shumë përpunime paraprake, që “krimbi” të mos gjej vend të përshtatshëm në trupin e mendjen tënde”. Këtë po mendoja kur skuadra e linjave ajrore po merrej me stazhionimin e shtyllave prej druri, para se ato të nguleshin në tokë. Ushtarët i merrnin me shumë kujdes dhe i zhytnin në bitum, pa lënë asnjë vend të palyer, asnjë vend ku mund të depërtonte krimbi dhe të fillonte kalbëzimin e saj. Ashtu i ruhesh dhe unë karrierës, jo asaj hierarkike, se ajo është krejt normale në ushtri, po asaj të shkëputjes nga bashkëpunëtorët, nga ata që dikur ishe i njëjlojtë, asaj që të burokratizon, të heq nga dora pinca e kaçavida e të jep një çantë me zingjir mbushur me letra, të cilat të pëlqejnë, të pëlqejnë më shumë e të bëjnë rob të tyre.

Kur isha oficer i ri isha i kudofutur dhe i kudogjendur. Mes ushtarëve, mes aparaturave, në mal apo fushë, tek linja telefonike apo në pikë vrojtimi me antenat. Pasi u bëra shef harrova ku lashë veglat e punës, harrova ushtarët dhe nënoficerët, u bëra zyrtar dhe tanimë emri “shef” e bëri më të lehtë dhe më hoqi ngadalë imunitetin të më “hajë krimbi” karrierës.

Mbaj mend kur takoheshim me fillrojtësin Gani në mëngjes. Uleshim në një gur para centralit, bisedonim për fëmijët e tij dhe ëndrrat e mia e pastaj drejtoheshim nga defektet. Kur nuk kishte defekt që “thërriste”, atëherë e mbështesja me ushtarë në drejtimin ku linjat duheshin forcuar apo telat duheshin tërhequr. Bisedonim gju më gju



dhe si shokë. Diferenca në moshë nuk na ndante. Ai ishte “ulur” dhjetë vjet më poshtë dhe unë isha “ngritur” 10 vjet më lart. Ishim bërë “moshatarë”.

Fillim shkurti. Gjithë natën ra borë e imët që ngjitej në tela e forcohej rreth tyre si brumi i makaronave. Dola dy herë natën në ballkon dhe prekja telat e rrobave, duke menduar pasojat e njëjta të telat e linjave ajrore. Në 5.00 të mëngjesit filloi një shi i imët, i ftohtë dhe të gjithë borën në tela e kthej në akull. Telefonova dhe ushtari më raporton gjendjen që prisja. Vishem dhe nisem nëpër errësirë. Ganiu ishte bërë gati me dy ushtarë për në drejtim të Surroit, afro 20 km linjë telefonike ajrore. Pritëm sa zbardhi drita. Ai nguli këmbë që unë të qëndroja, por pasi pa vendosmërinë time nuk kundërshtoi. Mbuluar brenda pelerinës, si kapuçon të blertë, u nisëm. Shiu pushoi, por gurët e bardhë gëlqeror ishin veshur sipër me një cipë akulli që të detyronin të tregoje kujdes. Falë këpucëve ushtarake, me pjesën e poshtme si goma zetori, ia dilnim shumë mirë.

Në Qinamakë, tek shtëpia e Xhevitit, Ganiu më la mua me dy ushtarë të pushonim e vet me një ushtar telefonist iku te lugina poshtë. Xheviti, i zoti shtëpisë, kishte kryer shërbimin ushtarak si telefonist tek ne dhe shtëpia e tij ishte si stacion i ndërmjetëm. Pasi mbaruam së ngrëni nga dy patate të ziera me gjizë pa kripë e koha lëvizte para, ne filluam të shqetësohemi për Ganiuun. Xheviti propozoi të marrë një ushtarë dhe të niset, por në fund vendosëm të shkojmë unë dhe Xheviti. Ushtarët do të qëndronin me fëmijët e tij. Ecëm pas linjës pothuajse me vrap. Kishim bërë afro një kilometër me një vrap pele. Në përrua dëgjojmë një

gulçimë. Ganiu kishte rrëshqitur me një këmbalec nga shtylla dhe kishte mbetur i varur e ushtari trupvogël po mundohej ta lironte. Xhevit u ngjit si dhelprë dhe e zbriti në tokë. Ganiu shikonte pantallonat e grisur dhe ne na vinte për të qeshur me vendin ku ishin hapur. Ai ishte gjithmonë serioz, si “vjeshtë e dytë”, dhe ne bënim sikur nuk ka ndodhur asgjë. Në fakt asgjë nuk kishte ndodhur me situatën që kishte krijuar.

Edhe tani që jam shef “i madh” e takoj Ganiun. Nuk ulemi më në një gur dhe nuk ndajmë përgjysmë punën e hallet e shtëpisë. Ai më sheh nga larg, por unë asnjëherë nuk mundohem ta shoh nga “lart”. Më përshëndet. Më përgjigjet më një “mire, shef” të vogël dhe vazhdon. Vazhdon punën e tij pa iu ankuar askujt dhe pa krijuar asnjë problem në sektorin e tij.

- Alo, po shef! Të dëgjoj shumë mirë. Nuk ka më defekte. Mirë ardhsh në repart!

Ky është refreni përditshëm i centralistit me teknikun e linjave, Ganiun, me fillrojtësin tonë të urtë, të ndershëm, të thjeshtë, të papërtueshëm dhe të pazëvendësueshëm. Me Ganiun e shokët e tij të mirë që më kanë shërbyer gjithmonë si etalon për të matur karakterin, moralin, dinjitetin dhe ambicien për karrierë.

## STËRVITJA

“Br2K-ja, me qëllim që të garantojë terësinë territoriale, të mbrojë të drejtat dhe interesat e shtetasve, të krijojë kushte për një paqe të qëndrueshme, të demonstrojë forcën për të parandaluar një konflikt të mundshëm, t’u pergjigjet në mënyrë ekuivalente veprimeve të mundshme të kundërshtarit dhe në pamundesi të shmangies së konfliktit, duke filluar nga dita “D” ora “O” të planizoj, organizoj e drejtoj mbrojtjen ndaj mësymjes së mundshme të shtetit “A” në brezin Nunja (02 00), Kodra (97 86), Llaxhi (78 91), Topovë (10 83). Duke filluar nga data “D + 17” ora “O”, Br2K të jetë në gatishmëri për të zënë vijën kryesore të mbrojtjes dhe zhvillimin e operacionit”.

Këto arrita të shënoj me shpejtësi në bllokun e sekretuar. Por dora shkruante jashtë mendjes. Mendja ishte në pikën e vrojtimit të shtabit, aty ku duhej të ngrihej qendra e ndërlidhjes.

Nuk kishte shumë që kishim arritur. Kishim lënë paimet dhe po merrnim nga komandanti situatën e orës dhe udhëzimet paraprake. Pjesa dërmuese e shtabit lënë pajimet dhe nxjerrin një ofshamë me frymë: “Oh, arritëm!”, kurse ndërlidhja sapo arrin, nxjerr një thirrje pa konsumuar as frymë: “Tani fillon puna”.

E puna filloi me takimin me komandantin para çadrës së shtabit. Bashkë me dy shefa të tjerë do shkonim në vendkomandë. Binte një shi i hollë i përzier me pak erë. Rrethi i Kasolles. Mjergulla akoma nuk ishte ngritur lart dhe lejonte orjentimin topografik. Dita sapo ishte thyer, por

lartësia 1500 m mbi nivelin e detit, lisat shekullorë të veshur me myshk, shkurret e pashkelura dhe bari i lagësht, jo vetëm bëheshin pengësë për lëvizje të lirë, por t'i ngopnin me ujë këpucët dhe pantallonat ushtarake.

Arritëm në vendkomandë e komandanti bëri orientimin topografik e më pas orientimin taktik. Me njërin sy vështroja komandantin e me tjetrin përpiloja një skemë mbi rajonet ku do të vendoseshin repartet. Mundosha në skemë të përfshija me formën e vijave topografike përrenjtë e vegjël dhe kodrat më të dukshme. Të gjithë repartet donin linjë telefonike fushore, e kjo kërkonte jo vetëm saktësi por nuk pranonte asnjë vonesë e devijim. Ishte gjithçka reale dhe konkrete për ndërlidhjen. Vetëm bisedat që mund të bëheshin në telefon ishin imagjinare.

U ktheva në shtab për të shkuar prapë atje. Mora efektivin e ndërlidhjes dhe u futëm në mision. Pasditja sapo ishte takuar me mbrëmjen e kur arritëm në objekt muzgu kishte zbritur. Temperatura kishte rënë dhe kodrat përballë ishin mbuluar nga mjergulla e dendur. Luginat ishin mbushur si me pambuk deri në grykë. Objektet nuk dalloheshin fare dhe vartësit ishin gjithë sy e veshë dhe gati të fillonin punën. Në këtë rajon ishim për herë të parë. Unë, si shefi i tyre, isha transformuar nga mjegulla në shurdh - memec. Nuk dalloja asgjë. Duke u orientuar nga skema dhe duke vënë në punë imagjinatën u shpjegoja vartësve pikat ku do të dislokoreshin repartet. Ata dëgjonin të përqëndruar dhe mëmërisnin “po, po, kuptuam”, por mua më dukej se thonin “po, po, po ia fut në tym”. Mua më pëlqente po-ja e tyre dhe uroja që të ishte “po” e vërtetë.

Skemën e përpiluar me nxitim ia dhashë komandantit të kompanisë së ndërlidhjes. U ndava me ata dhe ika në shtab për të vazhduar planizimin luftarak në hartë e dokumente. Në ora 5.00 fillonte operacioni mbrojtës.

Ora 3.00. Në tavolinë korrieri vendosi mesazhin e komandantit të kompanisë së ndërlidhjes.

“Zoti shef i ndërlidhjes. Detyra u realizua. U sigurua ndërlidhje me të gjitha repartet e nënrepartet në luftim. Gati për fillimin e operacionit”.

Mora frymë thellë dhe u mbështeta mbi masë në karrigen portative, por ndoshta më rëndë se duhet, se ajo u mënjanua dhe unë rashë në barin e shkëlur dhe të lagur brenda çadrës së shtabit.

- Kujdes se na duhesh për stërvitje, – thumboi shefi i shtabit.

- Mos u bëj merak, stërvitja për mua mbaroi. Ata që janë jashtë kanë përfunduar të gjitha e unë tani jam vetëm për të ngrënë fasulet e mëngjesit.

Plasi e qeshura. Të gjithë qeshnin pa arsye e unë qeshja nga gëzimi, nga gëzimi që u gjenda me fat, se punoja me ata njerëz aq të mirë, aq punëtor dhe aq të sakrificës sa heshtjen e bëjnë me gojë dhe mjegullën me sy. Me ata që do t’u jem mirënjohës për mot e jetë.

## HUMBJA E REPARTIT

Nuk kisha më shumë se tridhjetë ditë stazhier, si oficer i ri, i padiplomuar. Sapo isha shkëputur nga bankat e shkollës. Mora emërimin komandant toge ndërlidhje dhe u paraqita në repart.

Komandanti im, Naili, më prezantoi me ushtarët dhe më tha që ti je komandanti i tyre. Asgjë më tepër. Një ankth i vërtetë u ndje kur mbaroi orari zyrtar dhe të gjithë oficerët filluan të largohen në shtëpi. – Po unë? - pyes veten. Përgjigjja erdhi nga një nënoficer që mbulonte me shërbim ndërlidhjen: - Toga është e jotja dhe ti je komandanti i saj për gjithë periudhën, stërvitje, zgjim – pushim. Ti duhet të ndjekësh të gjithë aktivitetet e saj.

Kjo për mua ishte goditja e parë, që la gjurmë në gjithë karrierën ushtarake. Këtu filluan të shemben ëndrrat e dëshirat dhe të bien nën “efektin domino” të gjitha planet e një djaloshi riosh. Tre kilometra larg qytetit, shokëve dhe familjes e unë duhet të shoh vetëm horizontin që më lejon Kodra e Hazirëve !... Kështu filloi karriera ime ushtarake, por gjatë rrugës u gjetën edhe shtigje ku mund të plotësohet minimumi i dëshirave dhe ëndrrave të imagjinuara. Tanimë qarku ishte ngushtuar dhe kishte shumë pak elementë, unë, reparti dhe ushtari, ushtari, reparti dhe unë.

“Mirë gomari që ngordhi, por nuk të lënë rehat as mizat”. Oficer i ri dhe i padiplomuar. Konsiderohesha një hap larg ushtarit. Ngrihesha para lindjes së diellit e largohesha pasi dilte hëna katër pash. Shefi i shtabit të Brigadës, pas një inspektimi në togë, më jep dorën duke e

shoqëruar me fjalët: - Ke shumë fat se të dha dorën shefi i shtabit të brigadës. Këtë dorë nuk do e lash një muaj dhe do t'ua tregosh të gjithëve, familjes e shokëve. Unë lëviza kokën në shenjë pohimi, por në të vërtetë ndihesha i fyer, i poshtëruar dhe i indinjuar. Mendova se nga të gjitha të sharat më të rënda të botës, cila mund t'i përkiste në këtë rast shefit. Ky mbetej vetëm mendim.

Të hënën fillonte një stërvitje pesditore. Nuk e kisha idenë e stërvitjes me trupa. Komandanti i brigadës më thërret në zyrë e më urdhëron:

- Komandanti dhe shefi xhenios nuk janë në stërvitje. Ti do të zhvillosh pesë ditë stërvitje me kompaninë e xhenios. Janë 100% rezervistë.

- Unë nuk e njoh xhenion, shoku Komandant!
- Rreshto, shpërndaj, rreshto përsëri! Këtë e bën?
- Po, e bëj.
- Në zbatim!

E kuptoja edhe vetë se isha si shalqi i papjekur dhe komandanti brigadës po më ngarkon detyrë pa provë. Nuk kisha përvojë as nga stërvitja e vogël e ushtarit e jo më nga stërvitja me trupa. Ai kurrë nuk e ka menduar, apo ta çojë nëpër mend, se kam qenë kaq i papërvojë dhe për rrjedhojë do të kryeja veprime kaq të papërgjegjshme.

Ika te kompania e xhenios. Më dhanë evidencat dhe rezervistët po mobilizoheshin. Ata i kryenin veprimet ngadalë, si makina e pavajosur, por për mua nuk kishte asnjë shqetësim. Makina të ecte ngadalë, të bënte shumë zhurmë, por të ecte dhe kjo kishte rëndësi. Pasi dolëm në rajonin e stërvitjes, kështu zvarrë e në këmbë kaluan dy

ditë. Nga fundi i ditës së tretë mora njoftim se kompania duhet të zhvendoset bashkë me forcat e tjera në malin e Mollës. I hutuar apo i paorientuar shkoj e pyes komandantin:

- Nuk e di ku bie mali Mollës!
- E dinë rezervistët. Ata para dhe ti prapa. Ju pres atje - dhe mbylli me mospërfillje derën e makinës.

Pasi ecëm rreth tre orë në kolonë mes errësirës së plotë vazhdoja të isha i pa qartësuar për rrugëkalimin. Duke mos ditur fundin e këtij kalvari, diku para se të futeshim në Kukësin e Vjetër, në hyrje të urës mbi Drinin e Zi, ndaloj kolonën me rreth 100 vetë dhe dal para rreshtimit.

- A jeni burra – pyes me zë të lartë.
- Çfarë është kjo pyetje, shoku komandant!
- Nëse jeni burra, nesër në ora 06.00 të gjithë te mali Mollës. Tani shpërndahuni nëpër shtëpi. Natën e mirë!

Mora Brahimin, një komshi timin, dhe shkuam nëpër shtëpitë tona. Të nesërmen Brahimi do më tregonte rrugën dhe të dy do të ishim në malin e Mollës.

Nata ngjan vetëm me natën. Pa dëshmitarë. Duhej ngritur vendkomanda dhe duhej maskuar ajo. Në orën 05.00 fillonte operacioni luftarak. Gjithë natën ishin lëshuar patrullat me makina dhe kërkonin. Ku iku reparti... si u zhduk ai?

Ora 06.00 Po ngjitesha i çlodhur dhe i lehtësuar me Brahimin për tek mali Mollës. Isha i gëzuar që arrita mirë dhe rezervistët kishin shkuar atje përpara meje. Iku edhe një natë nga stërvitja. Ndërkohë që po merrja maloren duke fishkëllyer lehtë, përballë po zbriste një Zis Operativ me



shtabin e brigadës. Komandanti ishte para në kabinë. Sapo u afrua afër meje, zbriti nga makina në tokë duke ecur në drejtimin tim. Nuk i zbërtheja fjalët apo britmat, por dalloja vetëm buzët e tij që lëviznin dhe muskujt e fytyrës që ishin deformuar. Damarët e ballit i ishin fryrë dhe këmba e djathtë ngrinte pluhur nga përplasia përtokë e çizmes së meshinit. Kisha mbetur si guak. Nuk po kuptoja asgjë se çfarë kishte ndodhur, veçse dëgjoja se ato që shqiptonte ai ishin nga të sharat më të rënda që kisha lexuar e dëgjuar, ku mungonin vetëm ato që të kujtonin nënën.

U kthye. U largua. Përplasi derën e makinës dhe iku. Unë mbeta në rrugë pa lëvizur dhe i hutuar, derisa pluhuri i makinës u zhduk bashkë me zhurmën e saj. Brahimi më futi krahun dhe më tërhoqi sipër. Në vendkomandë po më prisnin rezervistët. Ata pasi kishin ngrënë të sharat, kishin bërë punën që duhej dhe kishin hapur çantat për të ngrënë mëngjesin.

Isha i hutuar dhe i çoroditur. Si Shwejkun majë kodre. Dallova konture duarsh të mbushura që më drejtoheshin. Ishin asortimente nga më të ndryshmet. Më ftonin të haja, por unë isha bërë aq pis, sa po të ishin fekale të gjithë ato sharje që më lëshoi komandanti sipër, unë do të isha më i lartë se mali i Mollës.

Brahimi dhe Saiti përgatitën një pjatë, si dinin ata për komandantin e tyre, për komandantin që i dërgoi ata në shtëpi, por ndërkohë humbi vetë e bashkë me veten edhe repartin.

Fillova të ha ushqimin. “Pas një fatkeqësie, e ngrëna është ngushëllimi i parë” – kisha lexuar diku.

## MOTRA

Sapo kishim shkarkuar materialet nga makinat “Zis” dhe kujdestari bënte kujdes në ndarjen paraprake të materialeve dhe sistemimin e përkohshëm të tyre. Fillonim stërvitjen me fushim për përgatitjen e radiotelegrafistëve. Kalova me sy të lirë dhe porosita në veçanti kujdestarin që të ndajë e të sigurojë elektrolitin e akumulatorëve. Ai ishte në bidonë kauçuku pesëlitërshe dhe druhesha mos ushtarët e ngatërronin me bidonët e ujit, megjithëse kishte shënime sqaruese të dukshme me ngjyrë të verdhë. Po ka raste që vepron shejtani para ushtarit. Kur të djeg qumështi i fryn edhe kosit.

Në përgjithësi fushimet organizoheshin nga muaji tetë apo i nëntë. Fshati, njëzet kilometër larg repartit, ishte i qetë dhe jo lart në nivelin e detit. Kishte rrush, arra, mollë, gështenja dhe fruta të stinës. Përveç shtëpive, pemë kishte edhe anës së rrugës, ku ushtarët mund të merrnin pa cenuar asnjë pronë të banorëve.

Në lindje të fushimit ishte hoteli i punëtorëve të fabrikës së minierës së kromit me një bufe e mensë në katin e parë, kurse në perëndim ishin barakat e të internuarve me punë detyruese. Shtëpitë e fshatit ishin larg njëra tjetrës dhe pothuajse nuk komunikojnë fare. Edhe ne ishim vendosur në një vend të veçuar e të mbrojtur nga erërat e vërshimet.

Ushtarët filluan të ngrenë çadrat. Në fillim u ngarkuan ushtarët të bëjnë banjën fushore, sepse nevojat fiziologjike nuk kanë orare dhe pastaj “Rrugën e gjeneralit”.

Banja bëhej në anën e poshtme dhe të pjerrët të fushimit, ku ujërat e saj duhej të humbitnin në përrua. Metrat e para nëntokë e pastaj në të veten. “Rruga e Gjeneralit” ishte një përvojë që na kishte mbetur nga koha kur na e kishte treguar kapter Refati, më i moshuari ndër ne. Ai shpjegonte se dikur, kur ishin gradat dhe gjeneralët kishin një autoritet absolut, në fillim duhej bërë rruga e tij, sepse nëse vinte gjenerali për inspektim në fushim ai donte rrugën e tij, rrugën e shtruar, të orientuar dhe të vizuar me gurë dhe të lyster me gëlqere. Ne tani e bënim në respekt të shefit apo të komandantit epror, ose më mirë mund të themi që ishte kthyer në rutinë. Kufizimet i jepnin fushimit pamje dhe u impononin disiplinë ushtarakëve. Puna vazhdoi pastaj me kuzhinën, fjetoren, klasën, depon dhe pozicionet fushore të radiostacioneve. Krahas këtyre instalimet elektrike dhe mensa fushore.

Mëngjesi i ditës së re ishte i freskët dhe ajri qelibar. Retë në qiell parashikonin një ditë të mirë e gështenja mbi çadër lëshonte në të rrallë nga një kokërr që ndahej nga boça. Pasi ushtarët filluan programin, te hyrja e fushimit u shfaq një punëtor me veshje minatori. Ai përcolli urdhrin e kryeinxhinierit për kafe te lokali. Miniera jepte “urdhra” në ushtri, pasi ishim në territor të saj. Në fakt na ftonte për kafën e mirësearchjes.

Pasi lashë porositë komandantit të togës, mora një nënoficer dhe zbatuam “urdhrin”. Kryeinxhinieri po na priste vetë i dytë. Njiheshim familjarisht, por jo nga afër. Ai na ofroi kafe, na uroi stërvitje të mbarë dhe pastaj na njohu me punën në minierë dhe terrenin ku ishim vendosur, pa

harruar të përmendte dhe të internuarit me punë të detyruar. Ne e falënderuam dhe e qartësuam se jemi të angazhuar intensivisht me stërvitje dhe nuk mund të ftojme asnjë person në fushim. Ajo do të jetë zonë ushtarake, por ndonjëherë mund të pimë kafe bashkë në lokal, pa e bërë praktikë të përditshme.

Ditë pas dite stërvitja intensifikohej e fushimi mernte pamjen e një parku të gjelbëruar. Në mes të tij ndërtoam një yll të madh me pesë cepa të ngjyrosur me pluhur tulle të kuqe. Në vende të dukshme shkruam parulla për Partinë dhe shokun Enver, të cilat kishin një ndriçim të veçantë natën. Nga ky zbulim i fushimit mori shkak dhe na ftoi për kafe Ahmeti, përgjegjësi që i mbikëqyrte të internuarit dhe u bënte apelin dy herë në ditë. Ai na falënderoi që fushimi dukej kaq bukur dhe e lidhi këtë punë tonën me baraspeshën ndaj të dënuarve të regjimit komunist. Në fakt puna jonë nuk kishte lidhje me ata, por më shumë me traditën ushtarake. Këtë e bënim kudo dhe kurdo dhe këtë ia bëmë të qartë Ahmetit. Pasi na qerasi me mjaltë të shtëpisë dhe një gotë raki, kërkoi leje për të shkuar në apel, kurse ne do të vazhdonim stërvitjen.

Çadra ku qëndronim dy oficerët ishte “mobiluar” thjesht. Në dy anët kishte nga një krevat me sustë teli, që qëndronin gjithmonë të rregulluar. Në mes një tavolinë me katër karrige, që shërbente edhe si tavolinë pune dhe si tavolinë buke. Anash dy komodina për libra dhe rroba të vogla. Ndriçimi bëhej me një llambe 100 wat, por ditën qëndronte një dritare beze e çadrës e hapur, nga ku futej drita natyrale. Një pjesë të madhe të kohës e kalonim në atë

zyrë portative. Bënim programe, konspekte, teste për ushtarët dhe korrigjimin e tyre, përgatitnim analiza ditore dhe përpilonim objektivat. Aty përgatitnim gjithçka duhej e tre herë në ditë aty hahej edhe ushqimi. Në tavolinë nuk mungonte asnjëherë një pjatë me fruta të stinës. Për këtë kujdesej kujdestari.

Ja kisha ngulur vështrimin një mize dhe megjithëse e largoja me dorë, ajo përsëri sillej nga sillej e te pjata rrushit vinte. Jashtë kishte rrush në pjergull, por ajo donte vetëm rrushin tonë, vetëm tonin. Unë nuk mërzitesha, si oficer i stazhionuar me shërbim, por ajo kishte mbaruar ndonjë shkollë më të specializuar. Nuk mërzitej që nuk mërzitej e nuk largohet. Në fund vendosa ta zë me dorë dhe ... një hije zuri dritën e derës dhe copa prej beze e çadrës u hap. Ushtari njoftoi se ka ardhur Ahmeti dhe kërkon takim. Dhashë miratimin dhe prita. Ishim të tre. Unë, komandanti i togës dhe kujdestari. Hyri Ahmeti dhe i bëmë vend tek stoli i drurit të kujdestarit. Na përshëndeti me të shpejtë dhe u zbraz:

- Pata një fjalë, komandant!
- Fol Ahmet, po të dëgjoj.
- Është fjalë e rëndë e ndoshta nuk është vendi – e dha të kuptoja se donte bisedë tek e tek.
- Po të jetë për ushtarët dhe oficerët fol pa droje. Po të jetë personale dalim e bisedojmë jashtë.
- Hasimi, ushtari juaj, ka takuar sot në kamp Liljanën.
- Mirë Ahmet. Faleminderit! Do ta vazhdojmë këtë bisedë – u ngrita dhe u drejtova nga dera. Ahmeti më ndoqi pas, megjithëse dëshironte ta tirrte më gjatë.

Në fakt nuk ish aq e lehtë. Ahmeti lëshoi gurin por kush do ta ngrinte tanimë. Asnjëri nga të tre nuk ishim të organizuar në parti. Ne ishim teknikienë dhe edukatorë të mirë, por jo analizues së vijës së devijuar apo jo të partisë. Gjithçka duhej të bazohej aty, te vija e partisë. Edhe stërvitjen me ushtarët, dhe plan metodikët e analizat ditore e javore i fillonim me shënimin “Nën udhëheqjen e organizatës bazë të Partisë”. Si do ta zgjidhnim këtë pa shqetësuar organizatën e partisë në shtab. Vendosëm të thërrasim Hasimin. Ai erdhi. Ishte ushtar i mirë si radist. Kokëfortë, i vendosur dhe nuk kërkonte falje kollaj. Ishte i shoqërueshëm dhe dukej si i pjekur para kohe. Si duket e kishin rritur hallet, pasi prindërit i kishte të moshuar dhe të lodhur. E njihja babain e tij, pasi më kishte takuar disa herë.

- Ke qenë te kampi dhe ke takuar një person.
- Po, kam takuar motrën time – u përgjigj menjëherë, sapo mori transmetimin gojor të pyetjes sime.
- Si! Përsërite të lutem.
- Po pra. E kam motër nga babai.

E ula në stol dhe pasi e qetësova atë dhe veten i kërkova sqarim më të hollësishëm.

- Në rininë e tij babai ka punuar si hekurkthyes, ku është njohur me nënën e Liljanës. Ata janë shoqëruar bashkë. Babai tregon në familje, por familja e saj paska qenë e prekur politikisht. Ai ngul këmbë dhe sqaron edhe “kufirin” që kishin shkelur. Asgjë nuk ndryshon. Ata ndahen. Ajo e mban fëmijën e ky fëmijë është Liljana, që unë e kam takuar. Babai më ka porositur që unë të jem gjithë jetën kujdestari i saj. Unë nuk mund ta shkel këtë porosi.

Pa kaluar mirë Hasimi derën e çadrës, ashtu gjysmë ushtarak, pa kapele, përfundova te shtëpia aty afër e Ahmetit. Ai doli në derë dhe unë pa pritur ftesë fola i pari:

- Ahmet! Na pri në odën e burrave.

I shpjegova çfarë kisha dëgjuar dhe iu luta të kalonte në rolin prindëror. Të linim pak politikën e të bisedonim si prind. Ai dëgjonte, tundte kokën e ndërkohë e shoqja e tij solli dy gota raki dhe një pjatë mjaltë. Ktheva gotën me një shkulum të madh e fytyra u shtrembërua nga shija e alkoolit. Futa pas kësaj në gojë një gjysmë luge mjaltë dhe fillova ta përtyp. Gjuha kapi diçka të njomë e të butë. E nxora jashtë me gisht. Ishte një mizë ... Ndoshta ajo miza që desha të kapja në pjatën e rrushit kur Ahmeti erdhi në çadrën tonë.

Ndoshta.

Por kur do më ndahen këto miza? – mendova me vete. Mendja më rrinte te organizata e partisë. Jo si do ta zgjidhte ajo, se zgjidhja e problemit të Hasimit kishte marrë udhë, por si do ta zgjidhja unë problemin me partinë. Kjo ishte miza më e madhe e kafshimit të saj duhet t'i ruheshe.

Kismet !

## LODHJA E TË NDRSHMIT

Mobilizimi i ushtarëve të rinj ka qenë një ndër aksionet më të mëdha në repart, veçanërisht në repartet si ndërlihdja, ku shërbimi kryesisht bazohej në ushtarët aktiv.

“50% e kuadrove në repart – gatishmëri luftarake.

100% e kuadrove në repart – mobilizimi i ushtarëve”.

Kjo duket absurditet, por kaq shumë vlerësohej ky moment dhe kaq të angazhuar ishim të gjithë kuadrot.

Makina sapo arriti dhe ushtarët hidhen me një kërcim në tokë, duke shkelur dhe rrafshuar borën e rënë një natë më parë. Oficeri i ditës i orienton me zë të lartë për të vendi i rreshtimit e ndonjërin e kap për krahu, ndoshta me pak ngut e forcë. Koha e ngjeshur nuk lejon të zbatohen të gjitha normat e mirësjelljes, pastaj prezantimi parë ka shumë rëndësi, se më vonë “shqyeje macen” kur të duash. Ushtarët e sapoardhur janë shumë të hutuar dhe të paorientuar. Çdo ushtarak u duket komandant. Përplasim këmbët në tokë, si për t’u ngrohur, ashtu dhe për të hequr emocione, që normalisht i kanë mbërthyer. Truri i tyre për momentin nuk arrin të mendojë veprimet që pasojnë dhe janë të bindur ndaj çdo veprimi të radhës, cilido qoftë ai. Në njëfarë mënyre janë si robotë të paprogramuar. Mjafton të jetë i programuar komandanti i tyre.

Kujdestari kishte përgatitur makinën e qethjes e cila bënte një zhurmë të ulët e monotone, zhurmë që zgjatej kur kalonte nga zverku, në majë të kokës e deri mbi ballë. Ai përdridhte dorën dhe kujdesej që të mos e ndërpriste rrugën e saj, kurse ushtari mbyllte sytë, hera herës, nga



dhimbja që i krijonte shkulja e ndonjë qimeje. Pas kësaj direkt në larje ku lakuriqësia e trupave e tyre kishte dalë sheshit e nuk fshiheshin nga njëri tjetri. Turpi kishte mbetur jashtë. Procesi fillonte me veshjen e uniformes mbi ndërresat e bardha dhe provën e disahershme të kapelës në kokë. Parada bëhej para xhamave të dritareve, ku rregullohej rripi, shpatullat e xhaketës dhe në fund lidhëset e këpucëve. Edhe ky çast nuk zgjaste shumë, se ndërpritej në mes nga zëri i komandantit. Ai i donte në rresht, vetëm të rreshtuar në rresht.

Ushtarët e rinj ishin të rritur dhe të pjekur. E kishim parasysh moshën madhore dhe dinjitetin e personalitetin e tyre. Ishin të arsimuar ose jo, të provuar me jetën ose jo, por ishin të rritur dhe të ndërgjegjshëm për veprimet që do të kryenin. Ndonjë ishte i martuar, disa kishin mbaruar shkollën e mesme dhe kishin punuar si mësues, teknikë, ekonomistë, normistë, por edhe ata që nuk kishin mbaruar shkollën e mesme kishin një profesion që e kishin ushtruar për pak kohë. Të pakët ishin ata që nuk ishin rrahur me punën dhe hallet familjare, e me këta “të llastuar” kishim punë më shumë edhe ne komandantët.

Musa ishte një nga ata që kishte mbaruar shkollën e mesme profesionale, kishte punuar në administratë, ishte i martuar dhe kishte dy vjet diferencë me shokët. Me të tillë ushtarë e kishte më të lehtë nëse dije t’i kuptoje e pastaj t’i vije në punët më të kualifikuara dhe që kërkonin më shumë pavarësi. Ata në përgjithësi shfrytëzoheshin edhe për përvojën organizative të fituar dhe caktoheshin si komandant direkt me ushtarët. Edhe Musa u emërua

z/komandant toge. Ai ishte non stop me ushtarët, kryente shërbimin ushtarak e ndërkohë kjo e lehtësonte komandantin direkt, që të ishte më i lirë për përgatitjen individuale, ashtu dhe për të marrë pak frymë.

Kishte mbaruar faza e përgatitjes vetmore të ushtarëve dhe tanimë ata ishin inkuadruar plotësisht në detyra luftarake dhe merrnin pjesë aktive në stërvitje. Ushtarët më të mirë dhe të përgjegjshëm kryenin në stërvitje detyrat më të rëndësishme dhe shërbenin në ato sektorë ku fati i stërvitjes kishte peshën e vet. Musa ishte caktuar me shërbim në qendrën e ndërlidhjes së brigadës, si centralist i saj. Aty varej shpejtësia e komunikimit telefonik të brigadës me eprorin dhe repartet vartëse. Ai ishte personi i parë që komunikonte me të gjithë ata që kontaktonin me repartin tonë, ishte si paradhoma apo kopertina e librit.

Ora 03.15 e natës. Stërvitje në terren. Sapo forcuam bazamentin e antenës me shefin e radios dhe mora raportimin se radiondërlidhja është siguruar. Mendova të bëj një inspektim në elementët e qendrës së ndërlidhjes, pasi dhe koha ishte jo e përshtatshme për shërbim. Edhe pak dhe agu i mëngjesit po jepte shenjë. Është koha kur trupi lëshon të gjitha forcat dhe i dorëzohet gjumit më të afërt. “Ujku duroi deri në agim – thonin – e në të dalë drita ngordhi nga të ftohtit”. Duke kaluar me radhë elementët, përshëndesja efektivin e shërbimit, i “shkundja” me pak humor dhe pasi sigurohesha që ishin mirë vazhdoja. Hap perden prej çadre të centralit. Ai ishte vendosur në një garnizon tresh qendre zjarri dhe dritaret ishin zënë me

plastmasë nga të ftohtit. Një erë vajguri të djegur e përzier me tym më bllokoj frymën. Musa ishte mbështetur dhe nuk lëvizte. Ishte në agoni. – Mos! Mos! – i thërras me të madhe dhe e shkund. Hap bezen e derës, liroi dritaret dhe ajri pastër futet me vërtik. Feneri vajgurit ishte shuar dhe ai kishte mbushur ambientin me karbon. Musa ngrihet, merr veten dhe me pak ndihmë del jashtë e mbushet me frymë. Kolla i pushoi dhe fryma u stabilizua.

09.30 Kolona po plotësohej gradualisht me forca dhe me mjete. Stërviçja do të zhvendosej në rajonin Kroi i Bardhë, ku pranvera të duket dimër. Ushtarët po ngarkonin materialet e ndërlidhjes dhe po kryenin zhvendosjen e elementëve, pa ndërprerë ndërlidhjen. Musa ishte duke pushuar në fjetore, pasi kishte dhimbje koke dhe marrje mendësh.

la behu për kontroll shefi i ndërlidhjes dhe hodhi një vështrim profesional mbi mjetet e ndërlidhjes që po ngarkoheshin e pastaj vështroi ushtarët, sikur donte të bënte apelin.

- Ku është Musa – pyeti menjëherë.
- Është i sëmurë – u përgjigja.
- Me të shpejtë në makinë. Si do ta mbajmë centralin pa atë.

Unë e lajmërova dhe ai erdhi menjëherë. E ktheva mbrapsht që të merrte kostumin dimëror, pasi atje na priste moti i ashpër. Kur ai po largohej mendova që njeriu sa më i zoti, sa më punëtor të jetë, sa më i sakrificës, aq më shumë futet në punë, aq më shumë u nevojitej të tjerëve,

pavarësisht se vlerësimi dhe shpërblimi do të ishte i njëjtë si për të gjithë ushtarët.

Kolona makinave po zbriste nga mali Kolesjanit. Stërvitja kishte përfunduar. Makinat para nesh humbnin nëpër kthesa e prapa tyre linin një shtëllungë të trashë pluhuri, që era ia vishte malit me ah shekullor. Gropat e rrugës me kalldrëm nuk na linin të qëndronim ulur mbi stola e sapo futeshim në kthesë përkuleshim e sa dilnim nga kthesa kërcenim përpjetë. Vështroj Musën. Ai kishte mbyllur sytë dhe shtrëngonte me duar prapa shpine stolin e makinës. Mundohej të shfrytëzonte ato pak momente pushimi. E vështroja dhe më dukej vetja borxhli. Borxhli po si të laj borxhin. Asgjë nuk më kishte mbetur. Vetëm një fletë leje e shkurtër për në familje. Atë me mend e kisha të plotësuar. Makina tani shkeli në asfalt. Nuk ka lëkundje, por vetëm të dridhura. Musa me duar të shtrënguara në stol po fle gjumë. Po fle për t'u ngritur përsëri. Po fle për t'u zgjuar dhe për t'i bërë të gjitha punët më të rëndësishme të repartit.

“Punëtori dhe i ndershmi lodhet më shumë” – mendova, duke mos qenë dakord me realitetin, por duke e pranuar dhe zbatuar disa herë dhe vetë në heshtje.

## **SHEFI NË HUMBËSIRË**

Sapo kapërcej hekurin tub të postbllokut, sytë iu fiksuam tek dera e hapur e lokalit të repartit. Nuk arriti të shquante askënd, por nga hapësira e derës iu duk se po dilte pak avull i përzier me tym duhani. Nga larg nuhati një aromë rakië kumbulle të Marimes dhe suxhuku të skuqur.

Futi dorën në xhepin e majtë të pantallonave ku mbante lekët që konsumonte vetë. Gërmoi me majat e gishtave, por asgjë.

- Sot nuk paskam asnjë çerek leku – i tha vetes.

Hapi zyrën duke tërhequr perin e gjatë nga plastelina e vulosur, sikur po xhironte një film me metrazh të ngadalësuar. Hodhi kapelën me të rrotulluar mbi tavolinë, mori bllokun dhe vështrimi u ngulit mbi kalendër...

- Edhe dy ditë dalin pagesat!

Shikoi uniformën nga këmbët te koka, rregulloi flokët e pakrehura me dorë dhe u drejtua nga zyra e Shefit të Shtabit për komunikatën ditore.

- Mirë mëngjes shef! - u dëgjua një mërmërimë, sikur vinte nga prapa murit. Vetëm atëherë vuri re se nënoficeri i veshmbathjes, me një tufë letrash në dosje, po e priste te dera. Rrinte larg dhe i ndrojtur sikur priste nga shefi një shuplakë të merituar, ose sikur shefit i kishte borxh jetën e tij.

- Kuadrove me llogarinë?
- Po – ktheu përgjigje ai, sikur kishte nënshkruar ekzekutimin e tij.
- Si dole?

- Ti e di !  
- Mirë, mirë! Ulu dhe fillo plotëso procesverbalet. Ose më mirë ik tek zyra e kazermimit. Unë jam këtu për çdo problem.

- Shef! Në orën katër pasdite.  
- Mirë! I thuaj dhe shoferit të transportit. Veseli të jetë atje para nesh. E dua të ngrohtë dhe të pjekur mirë. Nuk dua të pres. Kur të vij të jetë gati. Më vonë shko te lokali e mbyll llogarinë time.

Ai u largua dhe shefi duke fishkëllyer lehtë “Moj fusha e Korabit”, doli nga zyra duke e lënë derën vetëm të afruar. Kaloi nga financa, ushqimi, kazermimi, mori shefin e ushqimit me vete dhe u drejtua nga lokali.

- Ai suxhuku djeshëm kishte shumë spec dhe salcë – iu drejtua banakier Fetahut me këmbët e para.

- Kam disa salsiçe të mira me djathë.

Vuri gotën në buzë dhe e shkarkoi një gllënjke të madhe në grykë, njëlloj si kova kur derdhet në grykën e betonierës për të shuar çimenton e Fushë Krujës. Dy pika devijuan jashtë. Njëra ra në këmishë e tjetrën u desh ta thaj me të shpejtë në mjekër me shpinën e dorës. Një “aahhh” i doli thellë nga shpirti.

- Tani mbylle llogarinë dhe jepja kur të vijë Halili – i foli shefi klubistit me zë të ngjirur, si duke biseduar me veten.

Pastroi gurmazin, u sigurua që kaloi me sukses pragun e hekurit dhe me hapa të kujdesshëm u largua duke nxjerrë çelësat dhe duke i kaluar nga njëra dorë në tjetrën.

Pasdite vonë. Një fllad i lehtë vinte nga gryka e pasi rrotullohej në livadhin e vogël ku ishin shtruar, i vishej faqes

së malit të Sukës. Ishte ulur rehat mbi një batanie ushtari të palosur katërsh. Para, mbi mbulesën e tavolinës prej plastmasi, asgjë nuk mungonte. Nuk dinte sa kishte ngrënë e pirë. Dallonte vetëm rrethin e kuqrremtë të diellit, që po fshihej prapa degëve. Ishte shumë i raskapitur dhe i dërmuar. Rakia dhe mishi me yndyrë e kishin ngarkuar më shumë se duhej. Përveshi këmishën ushtarake, por nuk arriti të dallonte orën. Bisedat me zë të lartë nuk i kuptonte nga vinin. Edhe gotën nuk e dinte se kush ia mbushte, por dora shtrihej e vetiu dhe e gjente atë para gjurit të djathtë. Vështronte grupin e njerëzve që pinin e dukej se ishte përpirë e shtrënguar në një rreth ferri, rreth që lëkundej së bashku me atë dhe të qeshurat kuturu po i dëmtonin membranën e veshit. Mbylli, hapi e përsëri mbylli veshët më pëllëmbë. E provoi me ritëm. E shpejtoi. Pastaj më ngadalë. U shtri pak në ije dhe zhurmat u venitën, u zbutën e ikën. Ikën e u fashitën së bashku me diellin perëndak.

Dalloi që kishte zbardhur dita. Ku ishte ... Fyti i ishte tharë si tubi i pa shkundur i sobës së druve. Koka i rëndonte nga para dhe dukej se donte të tërhiqte dhe trupin. U mundua të hapë sytë, por drita e diellit që po lindte sikur e verboi. Ndjeu se buzët dhe mjekra po i lageshin. Një hije i mbuloi diellin agimtar. Brofi i trembur në këmbë.

- Dhelpra! – dhe preku mjekrën dhe buzët e njomura nga gjuha e saj. Akoma mbi mjekër dhe gjoks kishte thërrmija bukë, djathi dhe njolla yndyre.

- Pse kështu! Ku kështu? Ku janë shokët? – bërtiti i trishtuar, me sy të zgurdulluar, grushte të shtrënguara dhe i penduar për gjendjen ku ishte katandisur. Mallkoi me gjithë

zemër veten. Jo pse ishte katandisur në atë gjendje, por pse kjo pije mallkuar i kishte humbur dinjitetin, autoritetin dhe vlerën si ushtarak dhe epror, vlerën që mbartnin kolegët e tij.

Me grushta shtrënguar në tëmtha u betua. U përбетua në nder e dinjitet se nuk do të pinte më alkool, se nuk do të kishte më asnjë pikë takimi me atë. U betua se e njihte mirë veten. Në kokë i gumëzhinin porositetë e shokëve e hallet e familjes, fjalë që tanimë nuk mund t'i kalonte në heshtje.

Shikoi rrotull. Më shumë i trembur se i hutuar. Njëherë dhelprën e strukur prapa ferrës, njëherë lëkurën me dy batanije ushtari ku kishte kaluar i vetëm natën dhe shikimi u ngulit tek makina e transportit që vinte nga larg. Ajo ngrinte pluhur dhe bënte zhurmë jo për të zgjuar nga gjumi këtë fshat të vogël, por për të marrë e larguar sa më parë shefin nga kjo humbësi.



### **... EDHE DISA THËRMIJA PËRJETIMESH**

I zhytur deri në mes në ujin e kripur të detit hidhja e prisja topin me fëmijët. Më shumë merrnim ujë me duar, se gjuanim topin. Nuk di sa kishim kështu që kënaqeshim. Nuk mbaj mend se kush ishte tjetër, por mbaj mend se lojën na e ndërpreu oshtima e lokomotivës së trenit në kodër, e cila lëshonte një zhurmë shurdhuese e një tym të zi, teksa ecte ngadalë mes gjelbërimit e shkurreve.

- Telefoni! – dëgjoj përgjumur zërin e gruas në krah.

Lashë ëndrrën në të veten e kthehem i tromaksur në realitet. U kujtova se mbrëmë, para se të flinim, u premtova fëmijëve se ndoshta mund të shkojmë me pushime në plazh, sipas dëshirës sime e premtimit të komandantit. Akoma si somnambul marr telefonin, e vendos afër veshit dhe flas kuturu:

- Alo !
- Alarm! Shoku shef! – belbëzon si në faj centralisti.

Nuk kishte nevojë për asnjë sqarim tjetër. Ishte refren i përsëritur me qindra herë, ishte një ndër fjalët e terminologjisë ushtarake që përdorej më shpesh.

- Alarm – përsërita dhe unë si me vete, duke lënë në vendin e saj dorezën e telefonit.

Ashtu gjysmë i zhveshur, pasi u laga me ujë, kërkova uniformën e stërvitjes, xhaketën, pantallonat, rripat, çantën fushore, këpucët e ndërkohë gruaja vazhdonte në të sajat duke plotësuar çantën e shpinës me ndërresa, një vakt ushqim, qafore të pastra e të tjera, që i kishte mësuar përmendësh. Fëmijët kishin ngritur kokat mbi jorgan si

Masha dhe me keqardhje sikur pyesnin: - Do ikësh... të duam shumë!”.

Pas pak këpucët e rënda të ushtarit trokisnin si troku i kalit nëpër shkallët e pallatit e thyenin qetësinë e natës duke shpejtuar ritmin. Komshitë që dëgjonin, në gjumin e tyre të dytë, pëshpëritnin: - Iku Komandanti. Paskan alarm! – dhe ktheheshin në krahun tjetër apo ndonjëri shurronte, me këtë rast zgjimi të pazakontë.

\*\*\*

Komunikatë operative në Divizion. Shtabi dëgjonte pa vëmendje materialin rutinë që lexonte Përgjegjësi i Grupit të Drejtimit. Dy shefa dëgjonin pothuajse në këmbë, shefi logjistikës dhe ai i ndërlidhjes. Ato ishin pothuajse gjysmë të ngritur në këmbë, se në këmbë do ngriheshin patjetër. Nuk kishte ditë që të mos kishte defekt në ndërlidhje dhe mungesa furnizimi në logjistikë.

Edhe kjo ditë si të tjerat... shefi i ndërlidhjes në këmbë duke shpjeguar me detaje se si do të vepronte dhe do të rivendoste në afatin sa më të shkurtër ndërlidhjen e shkëputur, por Komandanti preu shkurt:

- Si mund të punoi ndërlidhja kur shefi vishet civil dhe bredh xhiro pasdite në mes të bulevardit.

Në mendje më shkoi mbrëmja kaluar. Një shok i fëmijërisë kishte ditëlindjen dhe na mblodhi për kafe. Unë u vasha civil dhe ashtu civil bëra dhe një xhiro ku më paska vërejtur Komandanti. Fare mendja se po të isha ushtarak atë mbrëmje ndoshta nuk do kishte ndodhur defekti.

\*\*\*

Kishim dalë dhe qëndronim ulur para grykës së tunelit. Ishte vendkomanda e kohës së luftës së njësisë sonë në skalion të dytë. Ndodhej në lartësitë e malit të Kolshit. Mezi i hapnim sytë nga drita e fortë e agimit të ditës së re. Qielli ishte i pastër dhe frynte një fllad i freskët, që nuk mund ta nënvlerësoje. Ishte dita e gjashtë që po gdhieheshim këtu.

Pasi morëm sinjalin e kushtrimit, erdhëm dhe u futëm në këtë zgafellë, të ndarë në dhoma të vogla, ku një pjesë shërbenin si zyra, me tavolina plastike të ngjitura në ele hekuri dhe një pjesë në fjetore, të kompletuara me krevate dyshe marinari. Gjithë tunelin e përshkonte një korridor i gjatë, veshur me beton dhe me lagështirë mbi masën, sa vende vende vinte era myk.

Këtu morëm detyrën luftarake dhe situatën operative. Mbushnim hartat dhe blloqet me shënime e raportime, mblihdeshim e merrnim vendimin e pastaj të gjithë e zbatonim po në harta dhe blloqe e në të pastajmen merrnim situatën e re të orës.

Për ne nuk ishte bezdi se për këtë kishim dalë e kjo për ne ishte pjesë e detyrës. Për një gjë ishim të shqetësuar sot ... Njësitë që ishin në skalion të parë, në kontakt direkt me armikun kishin 24 orë që kishin përfunduar gatishmërinë, kurse ne vazhdonim !!!

- Ose na kanë harruar, ose kanë frikë se na sulmon Fani nga prapa – u shpreh një shok i yni.

Nuk di kush qëndronte, por ne vazhdonim të qëndronim të gatshëm në këtë zgafelle aspak të këndshme.

\*\*\*

13 mars 1997.

Sapo dola nga centrali dhe mora njoftimin se ishte emëruar komandanti i ri i divizionit dhe do të vinte pas dy orësh me helikopter. Po mendoja si të organizojë punën që t'i dilnin përpara dhe ta sillnin në repart. Këmbët më lëshuan te stoli më i afërt i shatërvanit në shesh.

Nga ndërtesa e logjistikës afrohet me ngadalë një i moshuar. Në dorën e djathtë kishte një antenë filli simetrike radioje, të cilën e kisha hapur dhe inventarizuar kushedi sa herë, kurse në të majtën një palë këpucë ushtari pak të përdorura. Unë i dola ngadalë përpara dhe ai ngadalësoi hapin duke më shikuar me shumë droje. Dukej se kishte kaluar një jetë të ndershme. Nuk ishte vendi t'i merrje materialet, sepse ajo pasdite ishte kulmi batërdisë. Pasi e pyeta për shëndetin i them me ngadalë:

- A mund të ma japësh atë tel të mbështjellë?
- Pse nuk i kërkon këpucët, bre djalë, po më lyp telin?
- Se kur të bëhet ushtria me atë tel unë foli me Tiranën. Këpucët i gëzofsh vetë.
- Mbasi folke me Tiranën edhe unë po ta jap me gjithë qejf, mor djalë – e fare pa ngurrim më dorëzoi antenën simetrike të mbështellur në telin e saj.

Në të vërtetë sapo i ringritën qendrat e para të ndërlihdjes, antena e plakut na siguroj ndërlihdjen me Tiranën. Sa herë që e shikoja atë antenë të ngritur, mendja më shkonte se cilin gardh mund të kishte qarkuar po të mbetej në dorën e të moshuarit.

\*\*\*

15 mars 1997.

Dyshimi se shteti do të bëhej, se tanimë kishte marrë kahe pozitive, të paktën për ne ushtarakët dukej . Kishim filluar të shkonim në punë dhe të organizojmë shërbimin në të shumtën e elementëve të tij.

Dielli sapo kishte filluar të ngrohte dhe ne i ishim afruar rreth një kilometër repartit. Përballë nesh po vinin dy djem të rinj që mezi merrnin frymë nga ngarkesa. Sa na panë ne të veshur me uniforma ushtarake, ngadalësuan hapin dhe kaluan në anën tjetër të rrugës. Ne u dolëm përballë dhe i ndaluam. Njëri kishte një pushkë Mod-56 dhe tjetri një mitraloz të lehtë Mod-53 dhe nga një arkë municioni të mbyllur.

Filluam një debat, që materialet të kthehen në repart, por doli shterpë. Tek ata akoma dyshimi se do bëhej shtet nuk kishte marrë kahe. Kishin bërë një rrugë të gjatë e nuk pranonin të ktheheshin bosh. Njerëzit ishin “lazduar” dhe alternativat mungonin.

Unë nuk merrja vesh shumë nga armët e këmbësorisë dhe nuk u tregova i vëmendshëm, por shoku im konstatoi se njëri kishte mitraloz me fishekët e pushkës dhe tjetri pushkë me fishekët Mod-53 të mitralozit. Ai u bëri kërkesën modeste e të fundit:

- Të paktën ndërroni arkat e fishekëve e mos i mbani kot!
- Atë e dimë vetë. Mirë i kemi kështu. Secili të veten. Dy palët u larguam në drejtime të kundërta.

\*\*\*

Tropojë, 1999 ...

Krisma. Kudo krisma e dukej se edhe bisedat e zakonshme i shoqëronin ato. Si duket donin të tregonin se edhe ne kemi pushkë, edhe ne dimë të shtiem me fishekë, bile ngandonjëherë edhe me bomba.

Sapo kishim përtypur diçka, pothuajse në këmbë, me tre oficerët e shtabit të Divizionit dhe homologët tanë të Brigadës B. Curri në hotel turizmin e dikurshëm dhe ishim ulur tek zyra e komandantit të brigadës për të konkluduar mbi kontrollin e bërë gjatë ditës. Po flisnim me radhë e mendjen e kishim të mbarojmë shpejt, jo nga lodhja, por më shumë të largonim vëmendjen nga problemet ushtarake, të shkonim në ndonjë lokal e në të pastajmen në hotel si shokë e jo si ushtarakë. Anomalia e kudo gjendur na kishin mërzhitur dhe punët nuk po shkonin si duhet apo nuk po merreshin nën zotërimin e forcave ushtarake të gjithë sektorët. Besimi tek ushtria nuk ishte në nivelin që donim. Problemi më i ndërlikuar ishte lëvizja e forcave dhe armatimit të luftëtarëve të UÇK-së. Aty afër ishin dhe forcat “qeveritare” të Bugoshit. Momentalisht ne nuk kishim punë me ata dhe nuk kishim ardhur për këtë qëllim.

Papritur u hap me rrëmbim dera e zyrës ku ishim e refleksi na ktheu me shpejtësi jo vetëm kokat. I gjithi kamufllazh, përfshirë dhe xhupin, mbërthyer nga një duzinë rripash, ku në dy prej tyre mbante granata mësymëse, me automatik në dorë dhe pistoletë në këllëfin krahaqafë, futet ai, vet i tretë. Të gjithë e njihnim, por atë pak e shqetësoi prania jonë. Akoma pa mbërritur te tavolina e komandantit i

tha: - Ngrihu pak! U ul në vendin e tij. Rrotulloi dorezën e telefonit manual, që dukej se nuk e përdorte atë telefon për herën e parë, dhe kërkoj dikë. U ngrit në këmbë dhe i acaruar fliste me zë të lartë e shpejtë “Fierzë..., forcat e Bujar Bugoshit..., me armë nuk kalojnë para meje, kush dha urdhër, nuk pyes kënd... si të veprojmë” e të tilla shprehje që në veshët tanë arrinin të shkëputura. Pasi dëgjoj dhe përgjigjen nga ana tjetër e telefonit, e përplasi atë në tavolinë, i bëri me shenjë shokut të tij, veshur me xhup ushtarak që për momentin ishte shtrirë në divan ta ndiqte pas dhe të tre, pasi u bashkuan me të tjerët në korridor, u larguan plot zhurmë duke na lënë ne të befasuar, të hutuar dhe pa gojë. Shkundëm kokat dhe u kujtuam se jemi në B. Curri.

E nesërmja përsëri në reparte. Së bashku me ne ishte dhe një djalosh me pantallona të bardha dhe me një bluzë bezhë. Ishte shumë i afrueshëm dhe quhej Petrit. E kuptova se komandanti e kishte dërguar të qëndronte me ne gjatë gjithë ditës, në mënyrë që të ishim të sigurtë. Kuptohet, kush kishte punë me ne, kishte punë me Petritin.

Në një ndalesë, ju afrova dhe i propozova për një foto bashkë.

- Pse kërkon të dalësh vetëm me mua? – më pyeti.
- Më duhet, “foto si pasaportë”. Kam pasur një shok në B. Curri, Miriamin, por ai u largua në Tiranë. Më duhet një foto që për çdo rast të them “Jam shok i Petritit”. Ai qeshi dhe realizuam foton, “Foton si pasaportë” që e kam akoma sot. Sot ajo është “Foto si kujtim”, kujtim i atyre ditëve të vështira ku njeriu e kishte të vështirë të ishte njeri.

\*\*\*

Në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, të cilën e kam kryer në fund të viteve '70, të gërshetuara me mësimet teorike kryenim dhe marshime të programuara dhe stërvitje disa javore dimërore ose verore. Stërvitjen katër javore dimërore e zhvillonim në Feken. Para stërvitjes fillonim një marshin disa ditore dhe pas arritjes në Feken fillonim ta zhvillonim atë sipas programit. Marshimi gjithmonë kishte motiv politik dhe përkujtimor. Ai kryhej në gjurmët e marshimit ose të Br15-së në operacionin e dimrit 1944 ose atë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇL.

Më poshtë do të hedh dy përjetime nga këta marshime, jo të lehta, por me mbresa të pashlyera në vite:

OKSHTUN, janar 1977.

Borën e çanim të gjithë me radhë. Trashësia ishte rreth 60 cm. Këmbët ishin lagur dhe ishin bërë dru. Binte një shi i hollë i përzier me dëborë. Na kishin thënë se do na shpërndanin nëpër shtëpi të fshatarëve. Ky ishte lajmi më i mirë e pas çdo kodre shpresonim të dukej shtëpia “jonë” e shumëpritur. Ishim dakordsuar që sonte të mos ndahemi. E gjithë toga do të qëndronte në një shtëpi. Komandanti hezitoi por në fund nuk na e prishi.

Njëri pas tjetrit kaluam pragun dhe po futeshim në një korridor të errët. Nga larg, nëpërmjet derës hapur, dalluam në oxhak zjarrin bubulak. Dy kërcunj të mëdhenj ishin kthyer në prush. Shtresa ishte me dhé të ngjeshur e ne na u hoq meraku i këpucëve. U ulëm në të dy anët e dhomës së gjatë mbi lëkurë dhe hastër. Prapa shpine vendosa çantën e shpinës. Dhoma u mbush me avull që



dilte nga trupat tanë të lagur. I zoti shtëpisë, një i moshuar rreth të 60-ve, i shtoi zjarrit një kërcu të madh dhe përpiquej të na rehatonte. Ne ishim brenda e kjo ishte kryesorja.

Muhabet e bukë. Fasule të ngrohta më domate turshi. Domatja ishte e fortë. Vinte në të thartë pak të hidhur, por na shijonte shumë. Plaku tregonte: “Kam një djalë që punon në minjerën e Bulqizës. Kam këtë nipin e vogël që e dua shumë. Kam ëndërr t’i blej një radio. Jetojmë të izoluar dhe nuk shohim askënd”. Ne u prekëm nga varfëria dhe izolimi total. Në çantat e shpinës kishim bukë dhe ushqim të thatë. I zbrazëm çantat dhe i grumbulluam të gjitha ushqimet pas dere. I zoti shtëpisë u prek shumë, por insistimi ynë nuk kishte kufij.

Kishte filluar të zbardhte dita. Të gjithë ishim shtrirë aty ku qemë ulur. Vetëm kishim zgjatur këmbët dhe ishim mbuluar me kapota dhe pelerina. Plaku ishte ulur në një lëkurë dele përballë oxhakut dhe herë herë ngacmonte me mashë zjarrin. Zjarrin që e mbajti gjithë natën ndezur.

ZABZUN, janar 1978.

Dëgjonim monotoninë e zhurmës së borës që thyhej në kore nën këmbët tona. Ecnim apo zvarriteshim. Lodhja kishte përfshirë të gjitha gjymtyrët. U futëm në një pyll të dendur me pisha të larta. Nuk kishim fuqi të shihnim as token e as qiellin. Urdhri erdhi që ta kalojmë natën këtu. Lëshova pajimet, armën dhe çantën e shpinës mbi njëra tjetrën dhe u ula rrëzë tyre. Odisea nuk kishte mbaruar. Unë, Luani dhe Sokoli do qëndronim bashkë. Pasi morëm pak frymë djersa filloi të thahej dhe mornica na kaluan në

trup. Nata i kishte zënë vendin ditës, por hëna reflektonte dritën e saj në dëborë. Nga pishat pikat e ujit binin në tokë e kur preknin qafën, mornica kalonin në trup.

Mblodhëm degë pishë, por ishte e pamundur të ndizej zjarri. Ne as nuk dinim po as dru nuk kishim. Morëm përsëri pajimet dhe lëvizëm për të gjetur një vend tjetër e njëkohësisht dru për zjarr. Sa kaluam përruan aty afër u përpoqëm me një gardh. Një mendim na erdhi të shkulum disa hunj, por një mendim tjetër ishte më ndjellës – të futemi në shtëpi e të kalojmë natën brenda. Pas zërit tonë doli një mesoburrë, i cili kërkesën tonë e priti pozitivisht. Nga të dy shtëpitë, ai na drejtoi tek ajo që ishte e papërfunduar. Hapi derën dhe u futëm katin e parë, në një dhomë të shtruar me dërrasa. Në mes të saj ishte një stufë cilindrike llamarine dhe nëpër vend ishin shpërndarë dërrasa gjysmë të punuara. Ndezi zjarrin e ne kapëm parajsën. Ai doli duke lënë derën pak të hapur. Nga shtëpia tjetër doli një grua me një dërrasë të rrumbullakët me bisht ku kishte një tas të madh dhe copa buke. Burri i doli para dhe e ktheu mbrapsht. Ne nuk u merakosëm sepse kishim ushqim në çanta. Tanimë kishim strehë. Burri solli dhe një krah me dru të shkurtuara dhe u largua me “natën e mirë”.

Xhamat e dritareve ishin të mbuluara nga dëborë. Si duket kishte rënë gjithë natën. Të tre ishim kërrusur në kapota dhe pelerina e nuk kishim dëshirë të lëviznim as këmbët. Zjarri ishte shuar qëkur. Po shokët ... e me ata në mendje dolëm jashtë. Nga shtëpia tjetër ishte qetësi dhe asnjë lëvizje. Ndoshta na ndiqnin nga dritarja. Ndoshta edhe ajo gruaja e mirë me ushqimin e pangrënë. Ndoshta.

\*\*\*

Qershor 2001. Murnau, Landi i Bavarisë, Gjermani.

Dy fragmente nga veprimtaria e komandantit të njësisë gjermane e pastaj me dhjetëra krahasime nga ne ...

Komandanti më njofton se nesër ora 08.00 do të shkojmë për inspektim në një kompani autonome të ndërlidhjes në kufi me Austrinë. Njoftimin ma dha me shtesën “Wenn sie wollen – në se ju dëshironi”, por në fakt nuk varej shumë nga dëshira ime. Ai shkante për inspektim të thellë apo shterues, si i thonë tani, një herë në vit. Për mua do të ishte një eksperiencë.


Fragmenti i parë :

Makina komandantit ndaloi në postbllok. Ushtari roje mori dokumentet, i kontrolloi, verifikoi dokumentet e targën e makinës dhe vetëm pasi u bind, hapi postbllokun, duke qëndruar si i ngrirë deri sa kaloi makina e komandantit.

Fragmenti i dytë :

Komandanti mbaroi inspektimin, i cili ishte vendimtar për karrierën e komandantit të repartit që po inspektohej. Hëngrëm drekën në mensën e oficerëve të repartit, si të gjithë ushtarakët e tjerë dhe kaluam në kafe. Pasi pimë kafën, apo çfarë kishte porositur secili, komandanti inspektues i njësisë nxori nga xhepi një markë dhe pagoi kafën e tij. Ky ritual u vazhdua nga të gjithë deri sa më erdhi radha dhe mua.

U ktheva në Murnau duke menduar një herë për veten, njëherë për komandantin tim në Shqipëri. A do të bëhemi ndonjëherë të tillë. Sa isha unë aktiv nuk arritëm të bëhemi.



Në vitin 1990 pata filluar të mbaj shënime me “humor” nga jeta me shokët e mi ushtarakë. Nuk kisha mendimin diskriminues për asnjërin, por më pëlqenin disa biseda që përcillnin humor e të qeshura, disa shprehje e veprime aq të singerta e pa hile, sa ia vلente jo vetëm t'i mbaje mend, por t'i shënoje dhe t'i transmetoje tek të gjithë ata që nuk ishin prezent dhe nuk i kishin dëgjuar.

Duke mos dashur të përgoj askënd dhe duke dashur që ky “humor” të mbetet brenda kuadrit ushtarak, ndodhitë do të tregohen si kanë ndodhur me të vërtetë, por personat real do të përmenden me iniciale të emrit dhe mbiemrit.

Ndjesë për të gjithë ata që do të përmenden, por mirëkuptim se do të mbetet vetëm në kuadrin e shakasë.

Ilustrimi sipër është faqja e parë e bllokut të atëhershëm me shënime të momentit.

Qëllimi ishte “Qeshni pak ushtarakisht – e qeshura të zgjat jetën”.

\*\*\*

- Komandanti i divizionit po hipte në makinë pas një “kontrolli” në reparat. Kontrolli ishte shoqëruar edhe me një drekë të bollshme dhe ai mezi po ngjitej në makinë nga rëndesa e barkut.
  - Eh ç’na bëri kjo makina! – i ankohet shoferit për barkun që po e pengonte të hipte në makinë.
  - Po të ishte për makinën, do të më bënte dëm më shumë mua, or komandant – i thotë me shaka shoferi.

\*\*\*

- F.K. nënoficer në SHLU Bicaj. E pyesin shokët :
  - Ti nuk je shumë i vjetër. Pse fytyra t’u ka bë me kaq shumë rrudha?
  - Duke u qesh shefave me zor, – u përgjigjet F.K

\*\*\*

- F.K. rrinte shumë shpesh me shërbim “oficer roje”, megjithëse shtëpinë e kishte afër reparatit.
  - Pse rri kaq shpesh me shërbim? – e pyesin shokët.
  - Bathë, radio e bukë gruni ka plot këtu, e te shtëpia nuk i kam.

\*\*\*

- Vjen në kompani të ndërlidhjes së Rep. Usht. Nr.6600 për kontroll komandanti brigadës S.I. dhe për të metat që konstatoi dha urdhër që gjithë kuadrot të paraqiten në reparat.

I dërgojnë fjalë dhe paraqitet dhe nënoficer R.A. Ai vjen në ora 17.00 dhe kërkon të njoftojë personalisht komandantin për paraqitjen, në mënyrë që pas kësaj komandanti mund t’i jepte leje. Komandanti ishte i

sapoardhur me familje në qytet dhe për momentin nuk kishte telefon. I kërkon kolegut M.M numrin e telefonit të Komandantit dhe ai i jep një numër të formuar kot me mend. I bie dhe nuk ka përgjigje. I jep një numër tjetër, po të formuar kot. I bie dhe sapo del abonenti R.A. flet :

- Zoti komandant, jam kapter A. U paraqita në repart, si të veproj tani?
- Vepro si të duash R, unë jam C. B – përgjigjet nga ana tjetër e telefonit një qytetar i zakonshëm, i cili e njihte mirë R.

\*\*\*

- Në repartin e vjetër në Kolsh, kompania e ndërlidhjes ishte vendosur së bashku me repartin e kufirit. Një person vjen në postbllok dhe kërkon instruktorin e qenit. Ushtari futet në klasën e ndërlidhësve dhe i thotë R. se të kërkojnë në postbllok. R.A. në atë kohë ishte instruktor i përgatitjes së radiotelegrafistëve.

- Kë kërkojnë?– pyet për siguri ushtarin.
- Instruktorin e qenit – përgjigjet drejt ushtari.

Ushtarët radiotelegrafistë filluan të qeshin për emërtimin gabim të R-së si “instruktor të qenit”.

R. i zënë ngushtë para ushtarëve se i thanë “instruktori i qenit”, duke qenë “instruktor i radiotelegrafistëve”, u drejtohet ushtarëve:

- Mos qeshni. Ai kujton se ju jeni qen e unë jam instruktori juaj.

\*\*\*

- R.A kishte qejf të ulej e të pinte raki. Shpesh ulej edhe me nipat e tij nga Mamëzi. Gjatë pijes ai përdorte shprehjen:

- Daxha (daja) qet (nxjerrë) pushkë për nipin e nipi qet raki për daxhën.

\*\*\*

- R.A kishte dal në pension dhe unë isha akoma në ushtri. Po ecnim rrugës së bashku me R.L-në kur trokiti xhami. Ishte në lokal e po pinte me nipin ushtarak Sh.I

U ulën e morëm kafe - raki. Nipi Sh kërkoi leje të largohet. R.A thirri :

- Kamabjer ! (kështu e thërriste kamerierin, me foljen “bjer” - me sjellë). Sh. po largohet, llogaria të mbetet e hapur. Vizën poshtë hiqe kur të ikim ne. Nesër vjen vetë e paguan. Tani Sh. mund të largohesh. Kalofsh mirë e mos harro me kalu nesër kësaj rruge.

\*\*\*

- Aso kohe isha oficer i ri e kisha bërë llafe pune me komisarin e brigadës I.B Isha shumë i mërzhitur. Takoj R.A-në, nënoficer ndërlidhje e kolegë.

- Kështu nuk shtyhet ushtria – i them – duhet me e lënë krejt!

- Unë kam 22 vjet ushtri. – më tha ai – Me “urdhno” “si urdhno” e kam shty, sepse nganjëherë vjen një dallgë e madhe e ti thua se u mbyta, por duro, se pastaj dallga ik e deti bëhet i qetë “voj” e ti kënaqesh duke notu në shpinë në të.

Kështu dhe unë, njëherë në dallgë e njëherë në “voj” e shtyva ushtrinë.

\*\*\*

- R. A, nënoficer, thoshte gjithmonë:  
Të gjithë e dinë që unë pi. Kur futem në lokal asnjë nuk më flet, bëjnë sikur nuk më shohin. Kur dal të gjithë më

përshëndesin e gati ngrihen në këmbë.

\*\*\*

- R.A magazinier, furnizonte kuzhinën e repartit. Një ditë kuzhinieri po furnizohej me fasule. R i hedh fasulet në peshore dhe po vendoste gurët matës në anën tjetër të peshores. Ushtari nga pjesa e peshores ku ishin fasulet largon një gur. R e merr gurin dhe e vendos përsëri bashkë me fasulet.
    - Hiqe gurin, shef! – i thotë ushtari
    - Gurin hiqe ti tek kazani, se mua gurin ma kanë peshuar bashkë me fasulet, – i thotë R.
- \*\*\*
- Po rrinim me A.T. dhe dy shokë të tjerë para shtabit të brigadës. Në postbllok vjen komandanti i divizionit me makinë dhe ne u drejtuam nga Komanda për t'u futur brenda. Shefi i shtabit T.M. doli para nesh e na ndaloi :
    - Ku po shkoni ?
    - Po futemi në zyrë – i thamë ne.
    - Jo, qëndroni këtu në shesh. Kujt do t'i them unë “gatitu” pastaj.
- \*\*\*
- J.M. shef prapavije në Brigadë, po jepte llogari para Komisarit të Brigadës B.V. Pasi bënte sqarimin ai betohej :
    - Shoku Komisar! Të rrimë drejt e të flasim shtrembër, nuk qëndron ashtu problemi.
    - Mirë J. Rri drejt, rri drejt – vazhdonte ironinë Komisari e J. akoma nuk e kuptonte se shprehjen e thoshte gabim.



\*\*\*

- Kiço Mustaçi, në atë kohë Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, kishte marrë përsipër të bënte një repart model, e ky ishte reparti i artilerisë Cahan.

Ditën që përfundoi puna ai kishte mbledhur oficerë nga repartet, që ajo punë që ishte bërë këtu të shtrihej dhe në repartet e tyre. Ndërkohë që po shikonte ambientet e jetesës së ushtarëve, prapa shoqërohej nga gjithë oficerët e reparteve. Menjëherë pas tij vinte Komisari X.Y, si komisar i këtij reparti. Gjatë ecjes pas shefit ai po përdridhte një zinxhir në gisht e kjo i bëri përshtypje shefit të shtabit, i cili me marifet i tërhoqi vëmendjen X.

- E paske të bukur atë zinxhir, o X.
- Ma kanë bërë ushtarët shoku shef, – i përgjigjet X. pa djallëzi.
- Pse me zinxhirë merren ushtarët tuaj?
- Jo, shoku Shef, po i bëjnë në kulturë masive, – justifikohet X.
- Po mirë. I thuaj ushtarëve t’ia bëjnë edhe një F. – i thotë me ironi për komisarin e brigadës, që ishte prezent.
- A tu them tua bëjnë edhe një për Ju, shoku shef – vazhdon më tej X, pa e kuptuar aspak ironinë e Kiço Mustaçit.

\*\*\*

- X.Y, komisar në Cahan. Ai hante shumë mish në repart dhe kishte marrë vesh që po përfolej nga ushtarët dhe oficerët. Për këtë i mbledh në rresht ushtarët dhe oficerët e repartit dhe u drejtohet:
  - Ushtarë, kemi për të prerë një dele, kush do ta hajë atë?

- Komisari! – thanë ushtarët më një gojë, pasi dinin mendimin e tij.
- Tani kemi për të prerë edhe një dele tjetër, kush do ta hajë atë?
- Ushtarët!– thanë ata me një zë.
- Jo o berre (bagëti)! – u tha me ofendim X.Y – ushtarët do të hanë vetëm fizarmonikat (brinjët).

\*\*\*

- Në repartin ushtarak Nr.6600, në magazinë e kazermimit të M.M futen disa oficerë. Në mes tyre dhe Z.Y, i cili shkonte më shpesh. Po mbaronte orari i punës dhe M.M u thotë:
  - Dilni tani se do ta mbylli magazinën.
  - Unë nuk dal pa marrë ndonjë send – thotë Z.YAtëherë M.M mbështjellë diçka në një letër dhe ia jep Z.Y dhe i thotë:
  - Hape vetëm kur të jesh larguar e mos ta shohin të tjerët.Z.Y e hap paketimin kur largohet nga depo. Në letër ishin mbështjellë dy patkonj e dhjetë thumba.

\*\*\*

- Vinçit të fortifikimit i priset timoni në Fushë Dukagjin. Mekaniku E.S shkon dhe e çmonton për ta sjellë për riparim në oficinë të brigadës. Ai kishte hipur përpara në makinën “Zis’ të P.D dhe timonin e mbante përpara në prehër.  
Në rrugë del oficeri L.M dhe ata ndalojnë për ta marrë. L.M drejtohet për të hipur para bashkë me E.S, por sheh timoni në duart e tij. Del nga ana tjetër e sheh timonin

në duart e shoferit P.D dhe drejtohet e hip në karroceri duke thënë:

- Timon andej, timon këndej, më mirë po hipi në karroceri.

\*\*\*

- I.Y ishte oficer roje në repart. Del për kontroll të rojeve dhe sheh një ushtar që po flinte gjumë dhe armën e kishte lënë përtokë. Ai i merr armën ushtarit, e zgjon dhe e thërret në zyrë në truproje për t'i tërhequr vëmendjen. Ulet në karrige përball ushtarit dhe pasi i tërheq vërejtje i thotë:

- Ushtar! Thuaj “ti je babushi, më ke bërë këtë e atë, etj”.

Ushtari i përsërit me përpikëri të gjitha fyerjet dhe të sharat. Pastaj i jep pushkën. Sapo e merr pushkën ushtari, ia drejton oficerit të rojës I.Y dhe i thotë:

- Komandant! Thuaj “ti je babushi, më ke bërë këtë e atë, etj, etj”.

Oficeri rojës i përsërit me përpikëri të gjitha fyerjet. Në fund ushtari shkon e vazhdon shërbimin e tij, ashtu si dhe oficeri.

\*\*\*

- Kur në repartin ushtarak Nr.6600 ishte komisar B.V, ishte ngritur një miniekonomi ndihmëse, e cila u shërbente ushtarëve aktivë. Në shtab më shumë kujdesej efektivit i kompanisë së ndërlidhjes, pasi ishte konsiderueshëm në numër.

Një ditë presin një derr dhe ia dërgojnë për konsum repartit kundërajror. Ushtarët e ndërlidhjes ankohen tek grupi drejtimt, pasi derrat i ruanin ata dhe po i hanin ushtarët e tjerë. Aty përgjegjës ishte H.M, i cili e kishte kaluar pak në alkool. Në atë gjendje urdhëron ushtarët që

të vrasin një derr që vinte vërdallë dhe ta hanin. Krisi pushka. Unë dola jashtë dhe pyeta shef H.

- Çfarë ndodhi?

- Mirë e bëjnë, puno horrat e ha qorrat - u përgjigj H. pasi kishte vrarë derrin, në vend që të thoshte “puno qorrat e ha horrat”.

\*\*\*

- A.K, punëtor civil në repartin ushtarak Nr.6600, duke mbledhur dushk për ekonominë ndihmëse, gërvishtet dhe shkon për t'u mjekuar në infirmieri. Ndihmës mjek ishte D.Q, i cili pasi e mjekon plagën, i jep për t'u tallur edhe disa kokrra për diarre, duke i thënë se janë për të mos e infektuar nga tetanosi.

Akoma pa dalë nga rrethimi i repartit e kap barku. Shkon me vrap në shtëpi, pasi e kishte afër. Mbetet me pantallona në dorë, e ndërkohë i dërgon fjalë shefit të tij J.M:

- Nuk mund të vij te puna, por më sill nja tre katër palë pantallona ushtari se jam lag e koritë prej barkut.

Ata shkuan e vizituan te shtëpia e me vete kishin marrë një pako klorafenikol, për t'i ndaluar diarrenë.

\*\*\*

- Po hante bukë në magazinë M.M e ngjitur me veten kishte një kavanoz vinovil. Vjen A.K, punëtor investimesh e ulet afër tij.

- Të baft mirë, o M.

- Hajde bujrrëm A. Merre një copë bukë.

- Bukë nuk dua, por jam merak me këtë gjizën.

Merr pak bukë dhe pasi e lyen me vinovil e kafshon, por ... nuk i hapeshin nofullat nga vinovili!

\*\*\*

- A.D, punëtor investimesh nga Golloborda, në repartin ushtarak Nr.6600, shkon për mjekim te infermiera ku ishte n/mjeku X.Y.

- Doktor, më ka dal një t 'thatë (çiban) në një vend të keq e dua ta mjekoj.
- Mirë – i thotë X. - Uli pantallonat! – dhe i thotë ushtarit sanitar ta mjekojë.

Ushtari merr një shkop, e lyen me ilaç dhe fillon e mjekon prapanicën e D. Atij i vjen shumë inat që nuk përdorte dorën, por e lyente me shkop e jo me pambuk apo fashë.

Një ditë tjetër ai kalon pranë infermierisë dhe n/mjeku X.Y po vizitonte një ushtar.

- Çfarë ka ushtari, doktor – pyet D.
- I dhëmb koka – i përgjigjet n/mjeku X.
- Mos bre doktor – i thotë D. – ti nuk qe i zoti me shëndosh një bythë e po shëndoshke një kokë – i tha D. për hakmarrje.

-

\*\*\*

- B.R ishte student në Shkollën e Bashkuar. Duke qëndruar para shkollës i afrohet një prind që kishte ardhur për të takuar djalin e tij. Ai i drejtohet B.R dhe i thotë që ta njoftojë.

- A e njeh djalin tim, ... ?
- Po – i thotë B.R – e kam shok dhome.
- Sa veta jeni në dhomë?
- 200 vetë.

Prindi çuditet me përgjigjen. Shok dhome me 200 veta. Por në fakt kapanonet ku flinin aq kapacitet kishin.

\*\*\*

- K.M emërohet shef organizimi brigade në Repartin Ushtarak Nr.6600. Ishte i paarsimuar mirë dhe kishte pak eksperiencë në punën me shtabe. Kur llogariste pjesëmarrjen e rezervistëve në stërvitje haste vështirësi në raportimet me përqindje, pasi e harronte rregullin e treshit. Ia kishin sqaruar shokët disa herë dhe kur i pyeste shumë, ata talleshin me të.

Një ditë ngushtohet shumë dhe i futet komandantit të brigadës, R.H në zyrë dhe i thotë:

- Shoku Komandant! A më tregon si është “rregulli i treshit” !

\*\*\*

- Për të ilustruar më shumë nivelin e ulët profesional të K.M tregojmë një episod tjetër. Një ditë duke plotësuar evidencat e rezervistëve, has në vështirësi, del në dritare dhe pyet shokët:

- Ej, kush e di çfarë është N.SH.T? (Ndërmarrja Shtetërore e Tregtisë).

\*\*\*

- K.M kur takohej me shokë vazhdimisht përsëriste:
  - A dorë Sauku, dorë Sauku! Shoqëri me 6 gishta, pesë në shpatull e një në b...Kishte vazhdimisht problem me sinqeritetin e munguar të shokëve dhe kolegëve të tij.

\*\*\*

- Oficerët beqarë kalonin kohën me shaka. Në shtëpinë e ushtarakëve në Kukës, oficeri A.K, shef xhenio

brigade, veshur me bluzë jeshile, kishte dal në ballkon. Afër kishte një legen jeshil. A.M, një shok i tij pyet:

- I kujt është ai “legen jeshil” në ballkon?

A.K futet në dhomë, ndërron bluzën, e vesh të kuqe dhe del përsëri në ballkon.

- I kujt është ai legen i kuq? – pyet përsëri A.M, A.K pasi i kishte dhe flokët e kuqe.

\*\*\*

- H.M, shef teknike në Brigadë, njeri i njohur që përdorte alkool për hesap të tij. Merr shërbimin në orën 14.00 plotësisht i alkoolizuar dhe menjëherë shkon e shtrihet te krevati në zyrë. I del gjumi nga e vona dhe drejtohet nga klubi i repartit, i cili ishte i mbyllur.

- Ku është ky Muharremi që nuk ka hapur klubin – dhe i jep një të sharë si i dinte vetëm ai.

Një shok i tij që i kupton hallin, i drejtohet:

- Hajde shef H. shkojmë e pimë një kafe?
- Po Muharremi nuk e ka hapur lokalin?
- Shkojmë te Ura, te privati.
- Po është vonë, pas 10 minuta rreshtohemi për te flamuri.

Të gjithë filluan të qeshin. Ora ishte 19.50 e ai kujtonte se ishte 7.50. Dielli po perëndonte e ai kujtonte se ishte lindja e tij.

\*\*\*

- Kur filloi të ndërrohet sistemi edhe ushtria filloi të dobësohej e të binte dukshëm disiplina e të mos respektohej hierarkia ushtarake.

Shefi i shtabit të brigadës, T.M interesohet për një problem e ndërkohë ndërhyt ushtari aktiv i shërbimit të detyrueshëm:

- Nuk është ashtu shoku shef, e vëmë me bast!

Ne i thamë shefit të shtabit se pse e lejon ushtarin të flasë ashtu e ai tha:

- Shyqyr që nuk më thotë ndonjë fjalë me sharje e ju thoni për këtë.

\*\*\*

- Kur flet shumë edhe bën gabime.

Dy aspekte nga V.C

Po diskutojmë në analizë për normat e ushqimit dhe llojshmërinë e tij:

- Ta bëjmë ushqimin me ilaritet, – tha V.C, në vend që të thoshte – ta bëjmë ushqimin të larmishëm (në gatim).

Po diskutohej problemi i përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje e gatim tek ushtarët aktiv:

- Ta futim elektronikën në kazan, – tha V.C.

-

\*\*\*

- V.C, shef logjistike në brigadë, ishte me shërbim dhe po hante bukë në kuzhinë. Kuzhinieri për t'i bërë qefin i thotë:

- O shef V, nuk ka asnjë oficer më punëtor e më të zot se sa ti!

- Mos më thuaj mua – i përgjigjet V. – ja thuaj komandantit brigadës.



\*\*\*

- Rreshter T.I ishte përgjegjës roje në truprojen e divizionit. Kishte marrë urdhër që në mëngjes të kontrollonte personelin për fletë hyrje.

Ndërkohë që po kontrollonte fletë hyrjet kalon nënoficer A.C, që nuk ishte shumë i rregullt. Atij nuk ia kërkon fare fletëhyrjen.

- Pse nuk ia kontrollon fletë hyrjen A? - i thotë oficeri i rojës.
- Po ndoshta nuk e ka fare me vete, – i përgjigjet T.I

\*\*\*

- Kur ishim në Shkollë të Bashkuar të Oficerëve flisnim me familjet në telefon me “lajmthirrje”. Për ata që nuk e kanë jetuar atë kohë – njoftoje me dokument, të cilën e plotësoje në postë e quhej “lajmthirrje” dhe flisje tre minuta të nesërmen në orarin e përcaktuar. Ne këtë e aplikonim shpesh, si të vetmen mundësi komunikimi me familjen.

D.M, me banim në Lezhë dhe student për oficer, bën një fletëthirrje me familjen e tij. Të nesërmen kur shkon të flasë linja nuk punon. Familja e tij shqetësohet, pasi kontaktet i kishte më të shpeshta dhe nuk aplikonin asnjëherë lajmthirrje. Ata mundësonin të shkonin në shtëpi çdo fundjavë, pasi ishte hekurudha. Të shqetësuar menjëherë nisen për Tiranë dhe vijnë në shkollë, e takojnë D.M dhe e pyesin:

- Çfarë halli ke që bëre lajmthirrje?
- Hiç, vetëm desha me e provu njëherë si flasin këta që e kanë shtëpinë larg.

\*\*\*

- Xh.P, shef teknike në repartin ushtarak Nr. 6600, kur bënte shërbim oficer roje, dallohej shumë në të ngrënë. Kuzhinieri i mbushte pjatën me fasule, mundësisht me kokrra fasule, dhe ai fillonte të hante. Pasi e mbaronte pjatën i thoshte kuzhinierit:
  - Ushtar, më jep pak bukë se më kanë tepru fasulet.  
Pasi vazhdonte duke ngrënë i drejtohej përsëri kuzhinierit:
  - Ushtar, më hidh pak fasule se më ka tepruar buka!  
E kështu vazhdonte historia deri sa e mbushte barkun plot...

\*\*\*

- R.B, shef i inspektimit e kontrollit në divizion ushtronte kontrole të shpeshta te përgjegjësit material dhe nuk u linte atyre hapësirë që të bënin veprime jo ligjore.  
U takua një ditë me përgjegjësin material B.Z dhe i thotë:
  - A ka dalë ndonjë gjë nga magazina?
  - Jo, o shef – i përgjigjet B.Z – Nuk gjuhet me zagar lidhëm.  
Pra nuk vidhet duke na pasur çdo ditë në vëzhgim e kontroll...

\*\*\*

- Magazinieri B.Z dërgon një ushtar te kolegu i repartit 9656 për t'i dërguar një sasi preshësh, pa dokumente shoqërues, pasi i duheshin për gatim në kuzhinë. Rrugës ushtari takon një ekip kontrolli të Ministrisë, të cilët e konstatojnë si shkelje dhe B.Z i shkojnë për kontroll dhe i vënë në ngarkim preshtë.

B pyet ushtarin si ndodhi e ushtari me sinqeritet i thotë:

- Më kapën me presh në dorë, shef !  
Në të vërtetë atë e kishin kap “me presh në dorë”.

\*\*\*

- Alfred Moisiu, në atë kohë zv/ministër i Mbrojtjes, kishte dal në reparte për inspektim. Vjen në kompani të ndërlidhjes ku unë isha komandant toge dhe K.N komandant kompanie. Kërkon të inspektojë depon e përdorimit të ushtarëve aktivë. Pasi futet në depo kërkon librin e kontrolleve. Magazinieri F.V ia jep. Ai vëzhgon se në disa kontrolle rresht komandanti kompanisë kishte shënuar “të fshihen pluhurat”, ku ky ishte shënimi më i padëmshëm për përgjegjësit material.

- Magazinieri të shkarkohet nga detyra për moszbatim urdhri – urdhëron ai. - Si mundet që është urdhëruar disa herë “fshi pluhurat” dhe ai nuk e zbaton.

U desh shumë kohë të bindej që magazinieri ishte ndër më të mirët e ai të mbetej përsëri në punë.

\*\*\*

- Në ceremoninë mortore të major A.C po mbante fjalën e rastit Gjeneral N. M.

Diku në anë, ndërkohë, po bënin muhabet B.R dhe S.F

SH.V u tërheq vëmendjen dhe u thotë:

- Pushoni e burra! Ka vdekë A.C. e po flet një gjeneral. Kur të vdisni ju do të pallin magjarët (gomarët) e Gostilit.

\*\*\*

- Në trazirat e vitit 1997 ushtarët aktivë braktisën repartet dhe u larguan për në shtëpi të tyre. Përkohësisht shërbimi roje organizohej me nënoficerë aktiv. Ata nuk ishin shumë korrekt dhe nuk qëndronin mirë në vendroje.

Në shtabin e divizionit, tek ndërtesa e logjistikës, po bënte shërbim roje natën F.R. komandanti i divizionit K.L del jashtë në mesnatë për punë të tija dhe me këtë rast kontrollon edhe rojat.

F.R në këtë kohë nuk ishte në vendroje dhe komandanti nuk e gjen. I jep urdhër oficerit rojës që ta gjejnë dhe ta largojnë nga detyra.

Ai e ndjeu rrezikun e daljes në lirim dhe u paraqit tek komandanti, i cili e pyeti:

- Ku ishe kur dola unë për kontroll?
- Aty isha komandant, të pashë kur erdhe dhe kontrollove.
- Po pse nuk më ndalove?
- Nuk leh qeni në t 'zotin e shtëpisë, Komandant !

Kjo shprehje e shpëtoi F. që të vazhdonte përsëri detyrën.

\*\*\*

- Kishte mbaruar në brigadë mbledhja mësimore me nënoficerët dhe ata po ktheheshin në qytet, në familje. Të gjithë po ecnin turmë. Pasi u ngjiten malores së Turizmit të Ri, G.C. u ndal në kodër dhe u ul për të pushuar, pasi vuante nga zemra. Nga grupi u nda dhe M.M, i cili u ul në bar me G.C dhe interesohet se si ndjehet.

G.C i bën përshtypje interesi i M.M dhe e pyet:

- Ti gjithmonë je tallur me mua. Si të erdhi sot që u ndalove dhe po interesohesh kaq shumë.

- Jo, nuk po interesohem për ty – i përgjigjet MM – por ndalova se po futemi në qytet e të mos futemi kështu grumbull me turmën e nënoficerëve.

\*\*\*

- Në repart kishim dy hyrje, një nga ofiçina dhe një nga shtabi. Shumë kur vinin me vonesë shfrytëzonin derën nga ofiçina e për të shmangur këtë u vendos që të futeshin të gjithë vetëm nga dera e shtabit.

Një ditë marrin mungesat e Garipi vjen 5 minuta me vonesë. Përgjegjësi i ofiçinës e pyeti:

- Pse me vonesë Garip?
- M'i ka ngrënë pesë minuta kthesa.

Punëtorëve të ofiçinës u duhej të merrnin rrugën rrotull të futeshin nga dera e shtabit. Nga ajo ditë asaj

kthese

i thonin “Kthesa e Garipit”.

\*\*\*

- Kontrolli punëtor – ushtar kishte shkuar në ofiçinë për të parë efektivitetin në punë. Kalojnë tek një mekanik që ishte në gropë, që po montonte një kamje dhe i drejtohen:
  - Të lutem planin e punës ditor.
  - Nuk kam plan pune, – u thotë mekaniku.
  - Si nuk paske plan pune.
  - Po unë po punoj e kur punoj nuk kam nevojë të bëj plan pune, – përgjigjet ai.

\*\*\*

- Garipi ishte shofer me fortifikimin dhe lëviznin shpesh jashtë rrethit, aty ku kishim punime fortifikuese. Një natë i

bie të flejë në Pukë. Shkon te hoteli e sportelisi i thotë që nuk kam vend.

- Ti ke për mua se unë jam “Garipi”. (Garip – djalë i shkathët për kohën).
- Nuk të kuptoj! Si je “garip”? – ia kthen sportelisi
- Unë jam “garip” me pasaportë – dhe ia tregon pasaportën.

Sportelisi pasi e verifikon, i pëlqen humori dhe i gjen një vend për atë natë.

\*\*\*

- Jemi në vitet '70.

R.GJ ishte shef prapavije në repartin Nr.6600. ai transferohet dhe pas disa kohësh vjen për vizitë në Kukës. G.C, nënoficer vartës i tij kishte dëshirë ta takonte dhe t'i jepte edhe një drekë, por mundësitë financiare nuk i kishte të mira, prandaj i dërgon fjalë I.C, edhe ai nënoficer:

- Idriz, ka ardhë R.GJ. Hajde ta ndajmë përgjysmë!

PËRMBAJTJA

- Parathënie	5
- Përfshirja në marrëzi	7
- “Urim” për Enverin	11
- I lirë si demi	15
- Leta	19
- Shefi i zbulimit	22
- 11	26
- Bashkëpunim i shkëlqyer	29
- Letër mikut nga Kosova	32
- Kështu luftuam ne	36
- A ishte i thyeshëm atdheu ynë ?	45
- Demokracia dhe simbolet komuniste	50
- Gjashtë muaj në shërbim	54
- Fotografia mbi televizor	60
- Aliu pa rini	65
- Konserva e batalionit	69
- Zhdëmtimi i konservës	72
- Reportazhi	76
- Komisari	79
- Shikoj nga lart	82
- Demiri	84
- Fillrojtësi	88
- Stërvitja	91
- Humbja e repartit	94
- Motra	98
- Lodhja e të ndershmit	104
- Shefi në humbësirë	109
- Përjetime	113
- Qeshim pak ushtarakisht	124
- Përmbajtja	143